



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 157

Tiranë – E enjte, 21 nëntor 2019

## PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 6.11.2019	Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik dhe të zhvilluesit të zonës, me vendndodhje në Elbasan.....	12689
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 13.11.2019	Për miratimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe planit të veprimit të tij.....	12691
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 735, datë 15.11.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 231, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i segmentit rrugor ‘Pallati me Shigjeta – rrethrotullimi ‘Shqiponja’”, të ndryshuar.....	12794
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Drejtësisë nr. 650, datë 13.9.2019	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal.....	12796

**VENDIM**

Nr. 729, datë 13.11.2019

**PËR MIRATIMIN E PLANIT  
KOMBËTAR TË KËRKIM-SHPËTIMIT  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE  
PLANIT TË VEPRIMIT TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 10435, datë 23.6.2011, “Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, ministrit të Brendshëm, ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe planit të veprimit të tij, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe**

**PLANI KOMBËTAR I KËRKIM-  
SHPËTIMIT NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË DHE PLANI I VEPRIMIT  
TË TIJ**

Përmbajtja

SHPJEGIME/PËRKUFIZIME

SHKURTESA

PJESA E PARË

1. HYRJE

2. LEGJISLACIONI

3. QËLLIM

4. SYNIMET

5. OBJEKTIVAT
6. FUSHËVEPRIMI
7. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/  
ZBATUESE
8. LIDHJA ME PLANET E TJERA  
PJESA E DYTË
  1. RAJONI I KËRKIM-SHPËTIMIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
  2. KAPACITETET KOMBËTARE SAR NË RSH
  3. KONCEPTI I PËRDORIMIT TË ASETEVE SAR
  4. KOMUNIKIMI
  5. MBËSHTETJA LOGJISTIKE E OPERACIONEVE SAR
  6. STËRVITJA DHE TRAJNIMI - NDËRTIMI I PROFESIONALIZMIT
  7. GRUPET VULLNETARE
  8. MARRËDHËNIET ME MEDIEN
  9. DISPOZITA TË FUNDIT
    - SHTOJCA A RAJONI I KËRKIM-SHPËTIMIT TË RSH-së
    - SHTOJCA B: KATEGORIZIMI I ASETEVE SAR
    - SHTOJCA C: KAPACITETET PËR KËRKIM-SHPËTIMIT
    - SHTOJCA D: KOMUNIKIMI NË OPERACIONET E KËRKIM-SHPËTIMIT
    - SHTOJCA E: GRUPET VULLNETARE
    - SHTOJCA F: MESAZHET OPERACIONALE
    - SHTOJCA G
    - SHTOJCA H
    - SHTOJCA I
    - SHTOJCA J
- PJESA E TRETË
  1. PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E SHËRBIMIT TË KËRKIM-SHPËTIMIT
    1. PLAN I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR



## SHPJEGIME/PËRKUFIZIME

TERMI	PËRKUFIZIMI
Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit	Kryerja e monitorimit të fatkeqësisë, komunikimit, koordinimit dhe funksioneve të kërkim-shpëtimit, duke përfshirë edhe dhënien e këshillave, ndihmën e parë mjekësore ose evakuimin mjekësor, nëpërmjet mjeteve publike dhe private, përfshirë bashkëveprimin e infrastrukturave e mjeteve tokësore, detare e ajrore.
Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit (SAR)	“SAR” është Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit, që nënkupton strukturat, sistemet e vrojtimit, personelin dhe mjetet për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.
Kërkim	Një operacion, zakonisht i koordinuar nga një qendër e koordinimit të shpëtimit, duke përdorur personelin dhe mjetet në dispozicion për të gjetur personat në rrezik.
Shpëtim	Operacioni i zhvendosjes/i marrjes së personave në rrezik, mbështetja e tyre me nevojat bazë mjekësore ose nevoja të tjera, si dhe dërgimi i tyre në një vend të sigurt.
Rast kërkim-shpëtimi	Çdo fatkeqësi e mundshme apo që ka ndodhur për të cilën një strukturë SAR ka krijuar një dosje dokumentesh, megjithëse burimet SAR nuk janë aktivizuar.
Incident kërkim- shpëtimi	Çdo situatë që kërkon informimin dhe njoftimin e sistemit SAR dhe që mund të kërkojë operacionet SAR.
Kërkim-shpëtimi luftarak	Një detyrë specifike e kryer nga forcat e shpëtimit për rikthimin e personelit ushtarak të rrezikuar gjatë operacioneve luftarake apo joluftarake.
Qendra e koordinimit të shpëtimit	Qendra nga e cila një incident SAR kontrollohet dhe koordinohet. Kjo qendër njihet me terma të ndryshëm të tillë, si Qendra e Koordinimit të Shpëtimit, Zyra e Incidenteve Madhore, Zyra e Operacioneve. Për qëllimet e këtij plani, këto qendra do të quhen në përgjithësi Qendra Koordinim-Shpëtimi (QKSH) ose RCC.
Qendra e Parë e Koordinim-Shpëtimit	RCC-ja që merr e para njoftimin për një rrezik dhe që do të pranojë përgjegjësinë për të gjitha koordinimet SAR në vijim, deri në momentin e transferimit të koordinimit te një tjetër RCC.
Qendra e koordinimit të përbashkët të shpëtimit	Një qendër e koordinimit të shpëtimit, përgjegjëse për të dyja incidentet e kërkimit dhe të shpëtimit, ajror dhe detar.
Qendra e kontrollit të misionit	Pjesë e sistemit <i>Cospas-Sarsat</i> (qendër satelitore) që merr mesazhet e alarmeve nga terminali/et lokal/e dhe qendra të tjera të kontrollit të misionit për ta shpërndarë atë te qendrat e duhura koordinuese të shpëtimit apo pikat e kontaktit të kërkim-shpëtimit.
Njësia e kërkim-shpëtimit	Njësia brenda një administrate me përgjegjësinë e përgjithshme për ngritjen dhe sigurimin e shërbimeve SAR dhe që kujdeset që planifikimi dhe koordinimi i këtyre shërbimeve të realizohet siç duhet.
Njësi shpëtimi	“Njësi shpëtimi” janë njësitë e përbëra nga personel i stërvitur e i kompletuar me mjetet dhe pajisjet e përshtatshme për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.
Njësia e kërkimit dhe e shpëtimit	Një njësi e përbërë nga personeli i trajnuar mirë dhe i pajisur me pajisje të përshtatshme për kryerjen e shpejtë të operacioneve të kërkim-shpëtimit.



Strukturë e kërkimit dhe të shpëtimit	Çdo burim i lëvizshëm, duke përfshirë njësitë e përcaktuara të kërkim-shpëtimit, të përdorura për të kryer operacione të kërkim-shpëtimit. Termat, si njësia dhe asete SAR, zëvendësojnë njëri-tjetrin.
Mjet detar SAR	“Mjet detar SAR” është mjeti detar i destinuar për operacione SAR, me pajisje dhe personel të nevojshëm për operacionet detare SAR.
Mjet ajror SAR	“Mjet ajror SAR” është mjeti ajror i konfiguruar për misione kërkim-shpëtimi.
Subjekte private	“Subjekte private” janë individët dhe subjektet e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
Faza e emergjencës	Fazat e emergjencës janë të bazuara në nivelin e paraqitur për sigurinë e personave apo të anijeve që mund të jenë në rrezik. Të tria nivelet e emergjencave janë klasifikuar, si: e paqartësisë, e alarmit dhe e rrezikut.
Faza e alarmit	“Faza e alarmit” është situata kur mendohet se mjeti ajror/anija ose njësia tokësore janë të pasigurta.
Faza e lajmërimit	Një situatë ku ekziston frika për sigurinë e një avioni, ose anijeje detare dhe të personave në bord.
Faza e paqartësisë	Situata në të cilën ekzistojnë dyshimet për sigurinë e një mjeti ajror, detar ose personave në bord.
Faza e lajmërimit	Një periudhë gjatë së cilës sistemi SAR bëhet i vetëdijshëm për një incident aktual ose të mundshëm.
Faza e mbylljes	Periudha në një incident SAR, kur mjetet SAR kthehen në vendndodhjen e përhershme të tyre dhe përgatiten për një tjetër mision.
Faza e rrezikut	Një situatë ku ka arsye të logjikshme se një anije ose mjete të tjera, përfshirë avionë ose persona, ndodhen përpara një rreziku të madh për të vuajtur ose që do të kenë nevojë për ndihmë të menjëhershme.
Alarm i rremë	Është çdo alarm fatkeqësie nëpërmjet mjeteve të komunikimit, ku në fakt nuk ekziston ndonjë fatkeqësi reale, përjashtuar rastet e testimi të pajisjeve.
Faza e planifikimit	Periudha gjatë një incidenti SAR, kur hartohet një plan efektiv operacional.
Rajoni i kërkimit dhe i shpëtimit	Një zonë me përmasa të përcaktuara që i përket një qendre koordinim-shpëtimi, brenda së cilës kjo qendër siguron kryerjen e operacioneve SAR.
Vendngjarje	Zonë kërkimi ose vendi aktual i rrezikut.
Pozicion	Një vendndodhje gjeografike shprehur normalisht në gradë dhe minuta në gjerësi dhe gjatësi.
Pozicionimi	Procesi i përcaktimit të një pozicioni që mund të shërbejë si një referencë gjeografike për kryerjen e një kërkimi.
Koordinimi	Bashkimi i strukturave dhe elementeve SAR, për të siguruar përgjigje efikase të kërkim-shpëtimit. Një njësi SAR duhet gjithmonë të ketë përgjegjësinë e përgjithshme të koordinimit dhe strukturat e tjera duhet të bashkëpunojnë me këtë njësi për të dhënë përgjigjen më të mirë të mundshme me burimet që kanë dispozicion.
Koordinimi i përgjithshëm	Përgjegjësia e njësisë SAR për të kryer një operacion kërkim-shpëtimi për një objekt të caktuar.



Koordinator misioni për kërkim-shpëtimin	Një person i trajnuar në mënyrë të përshtatshme apo i kualifikuar dhe i caktuar përkohësisht për të kryer koordinimet në përgjigje të një situatë fatkeqësie që ka ndodhur ose pritet të ndodhë.
Koordinator avioni	Një person, i cili koordinon përfshirjen e mjeteve ajrore në operacionet e kërkim-shpëtimin (SAR).
Koordinator në vendngjarje	Një person i caktuar për të koordinuar operacionet e kërkimit dhe të shpëtimin brenda një zone të specifikuar.
Koordinator i kërkimit në terren	Përdoret për koordinatorët e misionit SAR vetëm për kërkimin në tokë.
Komunikimet koordinuese të kërkim-shpëtimin	Komunikimet e nevojshme për koordinimin e strukturave që marrin pjesë në një operacion të kërkimit dhe të shpëtimin.
Sinjal ndërkombëtar fatkeqësie	Sinjali radiotelefonik ndërkombëtar i rrezikut që përsëritet tri herë.
Sinjal ndërkombëtar fatkeqësie	Sinjal radiotelefonik ndërkombëtar për urgjencë. Kur përsëritet tri herë tregon paqartësi ose alarm dhe vijon me natyrën e urgjencës.
Sistemi satelitor ndërkombëtar	Sistemi satelitor ndërkombëtar i projektuar për të kapur dhe për të transmetuar sinjalet dhe të dhënat e mjeteve në fatkeqësi nëpërmjet pajisjes sinjalizuese të regjistruar në 406 MHz.
Organizata Ndërkombëtare detare Satelitore	Një sistem i satelitëve gjeostacionarë për shërbimet e komunikimit të lëvizshëm në mbarë botën që mbështet Sistemin Global të Rrezikut dhe Sigurisë Detare dhe sistemet e tjera të komunikimit emergjent.
Pika e kontaktit të kërkim-shpëtimin	Qendrat e Koordinim-Shpëtimin dhe pika të tjera kontakti kombëtare, të caktuara me përgjegjësinë për të marrë alarmet e dërguara nga COSPAS-SARSAT për të mundësuar shpëtimin e personave në fatkeqësi.
Plani i kërkim-shpëtimin	Një term i përgjithshëm që përdoret për të përshkruar dokumentet që ekzistojnë në të gjitha nivelet e strukturave kombëtare e ndërkombëtare që përshkruajnë synimet, rregullat dhe procedurat që mbështesin zhvillimin e shërbimit të kërkim-shpëtimin.
Operacion ndërhyrjeje	Operacion ndërhyrjeje janë veprimet për shpëtimin e jetës së njerëzve, në një territor të prekur nga fatkeqësia.
Plani i kryerjes së kërkimit	Mesazhi, i zhvilluar normalisht nga Koordinatorin e Misionit SAR, për dërgimin e udhëzimeve për njësitë dhe strukturat SAR dhe agjencitë që marrin pjesë në një mision SAR.
Hapat e kërkim-shpëtimin	Hapa bazë sipas progresit të rregullt të misioneve SAR. Kryesisht përfshijnë paralajmërimin, veprimin fillestar, planifikimin, operacionet dhe përfundimin e operacioneve.
Skenar	Një set i vazhdueshëm faktesh të njohura dhe supozimesh që përshkruajnë se çfarë mund të ketë ndodhur me të mbijetuarit dhe/ose mjetet.
Rajoni i kërkim-shpëtimin	“Rajoni i kërkim-shpëtimin” është një zonë e përcaktuar brenda së cilës sigurohen shërbimet e kërkim-shpëtimin.
Evakuimi mjekësor	Evakuimi i një personi për arsye mjekësore.
Zona e kërkimit	Zona e përcaktuar nga planëzuesi i kërkimit për të bërë kërkimin.
Objekt kërkimi	Një anije, ose mjet tjetër i humbur ose në fatkeqësi, të mbijetuar ose objekte kërkimi apo elemente, për të cilat është bërë kërkimi.
Metoda e kërkimit	Një procedurë që i dërgohet një njësie kërkim-shpëtimin për të kryer kërkimin në një zonë të caktuar.



Raport i situatës	Raportet nga koordinatori në vendngjarje drejtuar Koordinatorit të Misionit SAR ose nga ky i fundit për te agjencitë e interesuara, për t'i mbajtur ato të informuara në lidhje me kushtet në vendngjarje dhe zhvillimin e misionit.
-------------------	--

## SHKURTESA

SHKURTESA	KUPTIMI
A	Një zonë ose zonat e kërkimit (A1, B, B1 ... etj.)
A/C	Mjet ajror
AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AAF	Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë
ACFT	Avion
AFTN	Rrjeti i Telekomunikacionit Aeronautik Fiks
AIP	Publikimi i Informacionit të Aeronautikës
AIS	Sistemi i Automatizuar i Identifikimit
AM	Modulimi në Amplitudë
AMVER	Asistenca e Automatizuar e Shpëtimit të Anijeve
ARCC	Qendra Ajrore e Koordinim-Shpëtimit
ATA	Koha aktuale e mbërritjes
ATC	Kontrolli i trafikut ajror
ATD	Koha aktuale e nisjes
ATS	Shërbimet e trafikut ajror
bk	Batalioni i këmbësisë
bfs	Batalioni i Forcave Speciale
bk	Batalioni “Komando”
bmr	Batalioni i Mbështetjes Rajonale
btr	Batalioni i Transportit
bxh	Batalioni i Xhenios
C	Faktori i mbulimit
C/S	Shenja e thirrjes r/stacionit ( <i>call sign</i> )
CAO	Rendi i Aviacionit Civil
CASEVAC	Evakuim i të dëmtuarve
CASR	Rregulloret e Sigurisë së Aviacionit Civil
CIRM	Qendër Ndërkombëtare Radiomjekësore
COSPAS	Sistem satelitor për kërkim mjeteve në fatkeqësi
CRS	Radiostacion Bregdetar
CSAR	Kërkim-Shpëtimi Luftarak
CSS	Koordinator kërkimi në sipërfaqe (detare)
D	E dhënë/karakteristikë
De	Gabim i përgjithshëm i shmangies
DF	Gjetja e drejtimit
DME	Pajisje për matjen e distancës
DPD	Drejtoria e Përgjithshme Detare
DSC	Selektues i thirrjeve digjitale
DTG	Grup-datë, orë, muaj, vit (ZULU)
E	Gjatësi lindore
ELR	Avion me rreze të gjatë veprimi
ELT	Transmetues i vendndodhjes së emergjencës (për mjetet ajrore)
EPIRB	Radiosinjalesi i tregimit të vendndodhjes (për mjetet detare)



ETA	Koha e parashikuar e arritjes
ETD	Koha e parashikuar e nisjes
F/V	Anije peshkimi
FA	Forcat e armatosura
FAj	Forca ajrore
FARSH	Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë
FD	Forca Detare
FIC	Qendër e Informimit Ajror
Fig	Figurë
FIR	Rajoni i Informacionit të Fluturimit (zonë përgjegjësie SAR)
FM	Modulimi i Frekuencave
FT	Forca Tokësore
GHz	Gigahertz
GMDSS	Sistemi Botëror Detar i Rrezikut dhe Sigurisë
GPS	Sistemi Global i Pozicionit
GS	Shpejtësia në Terren
Gt	Ton bruto
H	Orë
HEL-H	Helikopter i rëndë
HEL-L	Helikopter i lehtë
HEL-M	Helikopter i mesëm
HF	Frekuencë e lartë
IAMSAR	Manual ndërkombëtar i kërkim-shpëtimit ajror dhe detar
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
IFR	Instrumenti i Rregullave të Fluturimit
IMO	Organizata Ndërkombëtare Detare
IMOC(QNOD)	Qendra Ndërinstitucionale e Operacioneve Detare
INMARSAT	Organizata Ndërkombëtare Detare Satelitore
INTERCO	Kodi Ndërkombëtar i sinjaleve
JRCC	Qendra e Bashkuar për Koordinim-Shpëtimin
KHz	Kilohertz
KKKSH	Koordinatori Kombëtar i KSH-së
KM	Këshilli i Ministrave
KSH	Kërkim-Shpëtim
LCRS	Radiostacion i Kufizuar Bregdetar
Leeway	Lëvizje e lirë e mjetit detar (për shkak të erës, dallgëve etj.)
LKP	Pozicioni i fundit i njohur (LKP)
LRG	Me rreze të gjatë veprimi
LUT	Terminal i përdoruesve lokalë
m	Metër
M/V	Anije tregtare
MAREC	Kodi Detar i Njohjes së Kërkim-Shpëtimit
MAX	Maksimal
MB	Ministria e Brendshme
MCC	Qendra e Kontrollit të Misionit (qendër satelitore)
MCS	Stacioni për Komunikimin Detar
MEDEVAC	Evakuimin mjekësor
MEDICO	Këshilla mjekësore
MF	Frekuenca të mesme
MHz	Megahertz



MIN	Minimum
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPD	Milje në ditë
MPP	Pozicioni më i mundshëm
MRCC	Qendra Detare e Koordinim-Shpëtimit
MRU	Njësi shpëtimi malore
MSC	Koordinator i misionit SAR
MSI	Informacioni i Sigurisë Detare
MZSH	Shërbimi i Mbrojtjes dhe i Shpëtimit
N	Gjerësia veriore
NAVAREA	Zona e lundrimit detar
NJMU	Njësia Mjekësore Ushtarake
NM	Milje detare
NOTAM	Njoftim për pilotët (për kohën, sigurinë etj.)
NSARC	Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit
NVG	Syze për vrojtimit natën
OKIA	Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve Ajrore
OSC	Koordinator në vendngjarje (misioni SAR)
P/C	Anije private (jahte etj.)
PIW	Person në ujë
PLB	Sinjalizues personal i vendndodhjes
PMK	Policia Kufitare dhe e Migracionit
POB	Persona në bord (anije, helikopter, avion, makinë)
POD	Mundësia e zbulimit
PR	Marrëdhëniet me publikun
PRT	Postat Radioteknike
PU	Policia Ushtarake
QBO	Qendra e Bashkuar Operacionale
QKAKSH	Qendra Kombëtare Ajrore e Kërkim-Shpëtimit
QKDKSH	Qendra Kombëtare Detare e Kërkim-Shpëtimit
QKEC	Qendra Kombëtare e Emergjencave Civile
QKKSJH	Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit
QKR	Qendra e Kontroll-Raportimit
QVA	Qendra e Vëzhgimit Ajror
R	Rreze
RADAR	Radari
RANP	Plani rajonal i fluturimeve dhe i lundrimeve
RB	Varkë shpëtimi
RC	Rrymat e lumenjve
RCC	Qendra e Koordinim-Shpëtimit
RISHM	Reparti i Inspektim-Shpëtim-Minierave
RSH	Republika e Shqipërisë
S/V	Anije me vela
SAR	Kërkim-Shpëtimi
SARIR	Raport i Incidentit SAR
SARPs	Procedura e kërkim-shpëtimit
SARSAT	Stacion satelitor për shpëtimin e mjeteve në fatkeqësi
SART	Transponderi i kërkim-shpëtimit
SC	Koordinator SAR
SDP	Sigurues i të dhënave për SAR





SHPFA	Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura
SHSHPFA	Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura
SITREP	Raporti i situatës
SIVD	Sistemi i Integruar i Vëzhgimit Detar
SMC	Koordinatori i misionit të kërkim-shpëtimit
SMRCC	Nënqendër Detare për Koordinim-Shpëtimin
SOLAS	Konventa Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det
SOPs	Procedura standarde operimi/veprimi
SP	Pika e përplasjes (në det)
SPOC	Pika e kontaktit të kërkim-shpëtimit
SRR	Rajon i Kërkim-Shpëtimit
SRS	Nënrajon kërkim-shpëtimi
SRU	Njësia e kërkim-shpëtimit
SU	Njësi kërkimi
T	Orë kërkimi në dispozicion
TACAN	Navigim Taktik Ajror
TAS	Shpejtësia ajrore e vërtetë
TC	Rryma e baticës
TCA	Koha e afrimit më të afërt
TELEX	Teleshkrues
TWC	Rryma totale e ujit
u	Shpejtësia e erës
UHF	Frekuenca ultra e lartë/ZULU
USAR	Kërkim-shpëtimi urban
UTC	Ora universale e koordinuar
V	Shpejtësia e objektit të kërkimit
VFR	Rregullat vizuale të fluturimit
VHF	Frekuencë shumë e lartë
VLR	Gjatësi shumë e madhe
VMC	Kushtet vizuale (pamore) meteorologjike
W/C	Rryma e erës
W/V	Shpejtësia e erës
WMO	Organizata Ndërkombëtare Meteorologjike
Wu	Gjerësia e pakorrigjuar e pastrimit



## PJESA E PARË

## 1. HYRJJE

1.1 Ngritja dhe funksionimi i një sistemi efektiv të kërkim-shpëtimit (SAR), me një përcaktim të qartë të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësi të të gjitha palëve të përfshira në ofrimin e shërbimeve SAR është sfiduese dhe me përparësi të lartë për të gjitha shtetet e, në veçanti, për Republikën e Shqipërisë, e cila pavarësisht nga madhësia e saj territoriale ka një fushë të madhe përgjegjësie kombëtare, për sigurimin në kohë dhe me efektivitet të shërbimeve SAR, brenda zonës së përgjegjësisë, sipas Tirana FIR.

1.2 Zhvillimi i Planit Kombëtar të Kërkimit-Shpëtimit lind si domosdoshmëri për të zhvilluar kapacitetet kombëtare për përballimin e situatave kritike që mund të krijohen, si pasojë e aksidenteve ajrore dhe detare dhe aksidenteve sportive e turistike në terren malor e në ujërat e brendshme.

1.3 Plani Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit është përgatitur në bazë të konventave ndërkombëtare, në lidhje me kërkimin dhe shpëtimin, të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të akteve të tjera ndërkombëtare në fushën e kërkim-shpëtimit, të ratifikuara ose të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

1.4 Plani Kombëtar i kërkimit dhe i shpëtimit është i ndërtuar në tri pjesë:

*Pjesa e parë* ka informacion të përgjithshëm për bazën ligjore, qëllimin, synimet, objektivat, fushëveprimin, institucionet përgjegjëse/zbatuese dhe lidhjen me planet e tjera.

*Pjesa e dytë* përbën bazën teorike të planit dhe përfshin rajonin e përgjegjësisë së Republikës së Shqipërisë për kërkim-shpëtimin (SAR), kapacitetet kombëtare SAR dhe konceptin e përdorimit të tyre. Në këtë pjesë trajtohen dhe koncepte për komunikimin SAR, mbështetjen logjistike të operacioneve SAR, stërvitjen dhe trajnimin e personelit SAR, marrëdhëniet me median dhe disa dispozita të fundit. Njëpërmjet shtojcave dhe lidhjeve të ndryshme, jepen të dhëna të detajuara, të cilat plotësojnë pjesën teorike të planit.

*Pjesa e tretë* përfshin disa kërkesa ndërkombëtare në formatin e një pyetësori për shërbimin e kërkim-shpëtimit, mbi bazën e të cilit është hartuar dhe plani i veprimit/programi i masave, ku përcaktohen masat që do të merren, afatet kur do të realizohen

këto masa, strukturat përgjegjëse për realizimin e tyre dhe strukturat bashkëpunuese.

1.5 Asnjë përcaktim i këtij plani nuk duhet të interpretohet në një mënyrë që është në kundërshtim me përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo pale të përfshirë, pasi ato përcaktohen nga legjislacioni, dispozitat e brendshme ose marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi ose me detyrimet e njohura të shërbimeve dhe organizatave të tjera, të cilat u ofrojnë ndihmë personave dhe pronave në rrezik, si pasojë e aksidentit detar ose aeronautik.

## 2. LEGJISLACIONI

2.1 Organizimi i shërbimit të kërkim-shpëtimit dhe detyrimet e Republikës së Shqipërisë për këtë shërbim përcaktohen nga konventat ndërkombëtare dhe aktet ligjore e nënligjore të ratifikuara e miratuara nga autoritetet e vendit tonë.

2.1.1 Konventa Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO), *Annex 12 "Search and Rescue"*, 1944, pranuar ligjërisht nga Republika e Shqipërisë, Dekret i Presidentit nr. 7438, datë 1.12.1990, "Për aderimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në Konventën për Aviacionin Civil Ndërkombëtar (ICAO) dhe në protokollin për tekstin autentik tregjuhësh të kësaj konvente. Në bazë të kësaj konvente, shtetet firmuese duhet të mendojnë për krijimin dhe organizimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit, brenda territorit të tyre dhe këto shërbime duhet të jenë me sistem turni 24 orësh, si dhe të ngrenë një Qendër Koordinim-Shpëtimi në një Rajon Kërkim-Shpëtimi.

2.1.2 Konventa Ndërkombëtare (IMO) mbi Kërkimin dhe Shpëtimin Detar, (Hamburg 1979), ratifikuar me ligjin nr. 9056, datë 24.4.2003 (SAR 1979). Në bazë të kësaj konvente, vendet anëtare duhet të organizojnë shërbimin e tyre të kërkim-shpëtimit, në mënyrë të tillë që t'i përgjigjen menjëherë thirrjes së fatkeqësisë dhe të themelojnë një mekanizëm kombëtar për koordinimin e përgjithshëm të shërbimeve të kërkim-shpëtimit në det.

2.1.3 Ligji 10435, datë 23.6.2011, "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë". Ky ligj bën përcaktimin e autoriteteve, rregullave dhe procedurave për organizimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit, me qëllim shpëtimin e jetës njerëzore, duke përdorur me efektivitet të gjitha burimet e mundshme në kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit, në raste



fatkeqësish të ndryshme, duke ndërhyrë, kërkuar, gjetur dhe shpëtuar persona të humbur ose të zhdukur.

2.1.4 Ligji nr. 8905, datë 6.6.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, i ndryshuar. Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të Republikës së Shqipërisë nga ndotjet e dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det e në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë burimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis.

2.1.5 VKM-ja nr. 742, datë 16.10.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.” Ky vendim përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, bashkëpunimin me institucionet dhe strukturat e tjera shtetërore, mënyrën dhe procedurat e operimit, duke përfshirë edhe linjën e komandimit e kontrollit me koordinatorët kombëtarë të ajrit e detit për ofrimin e shërbimit të kërkimit e shpëtimit.

2.1.6 Urdhri i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë nr. 158, datë 26.10.2016, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së QKKSH-së”; urdhri i ministrit të Mbrojtjes nr. 1161, datë 24.11.2016, “Për organizimin e QKKSH-së” dhe urdhri i ministrit të Mbrojtjes nr. 1258, datë 19.12.2016. “Për miratimin e tabelës së organizimit dhe pajisjeve të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit”. Mbi bazën e këtyre urdhrave përcaktohet struktura, përgjegjësitë dhe detyrat kryesore të QKKSH-së. Urdhrrat mund të rishikohen në çdo kohë dhe sa herë kërkohet.

2.2 Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë mbahen parasysh edhe detyrimet që rrjedhin, nga:

2.2.1 Konventa mbi Organizatën Ndërkombëtare Detare (IMO), 1948, ratifikuar me ligjin nr. 9294, datë 21.10.2004. (IMO 1948).

2.2.2 Konventa e OKB-së mbi të Drejtën Detare (*Montego Bay 1982*), ratifikuar me ligjin nr. 9055, datë 24.4.2003 (UNCLOS 1982).

2.2.3 Konventa e IMO-së mbi Shpëtimin e Jetës, 1989, ratifikuar me ligjin nr. 9213, datë 1.4.2004 (SALVAGE 1989).

2.2.4 Konventa e IMO-së mbi Shpëtimin e Jetës së Njeriut në Det, 1978, ratifikuar me ligjin nr. 9213, datë 1.4.2004 (SOLAS 1974).

2.2.5 Ligji nr. 10040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2.2.6 Ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i RSH-së”, i ndryshuar.

2.2.7 Ligji nr. 8875, datë 4.4.2002, i ndryshuar me ligjin nr. 9788, datë 19.7.2007, “Për rojën bregdetare shqiptare”.

2.2.8 Ligji nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”.

2.2.9 VKM-ja nr. 965, datë 2.12.2015, “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave”.

2.2.10 VKM-ja nr. 671, datë 7.12.2001, “Marrëveshja e bashkëpunimit për veprimet e kërkim-shpëtimit në detin Adriatik ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Italisë”.

2.2.11 VKM-ja nr. 439, datë 13.5.2011, “Për miratimin e dokumentit “Politikat dhe Procedurat e Funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare(QNOD)”, i ndryshuar.

2.2.12 LAMSAAR (ICAO/IMO), “*International Aeronautical and Maritime Search and Rescue*”.

2.2.13 ATP-10 (3.3.9.2) NATO STANAG 3552, “*Search and Rescue Manual*”.

2.2.14 Manuali i Shërbimit të Kërkim-Shpëtimit në FARSH MP3-3-2 (SAR), miratuar me urdhër të SHSHP-së së FA-së, nr. 614, datë 9.6.2016;

2.2.15 Manuali i Kërkim-Shpëtimit në Det (SAR), miratuar me urdhër të SHSHP-së së FA-së, nr. 749, datë 22.9.2009.

### 3. QËLLIMI

Ky plan krijon një proces dhe strukturë të plotë për shpërndarjen sistematike, të koordinuar dhe efektive, të përgjigjeve ndaj ngjarjeve të kërkim-shpëtimit në nivel kombëtar, në rastet e aksidenteve ajrore dhe detare në zonën e përgjegjësisë së Republikës së Shqipërisë. Ai përshkruan supozimet e planifikimit, konceptet operacionale, reagimet dhe veprimet që kërkohen në rast të një incidenti ajror ose detar, duke përshkruar proceset dhe metodologjinë për zbatimin dhe menaxhimin e përpjekjeve kombëtare të përgjigjeve ndaj aksidenteve ajrore dhe detare.



Ky plan plotësohet me marrëveshje ndërinstitucionale për përdorimin efektiv të të gjitha kapaciteteve në dispozicion në të gjitha llojet e misioneve të kërkim-shpëtimit.

#### 4. SYNIMET

Ky plan synon:

të ndihmojë shtetin shqiptar të përmbushë detyrimet humanitare, kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me shërbimin SAR;

të ofrojë udhëzime kombëtare për zhvillimin e sistemeve të lidhura me shërbimin SAR;

të përshkruajë pjesëmarrësit dhe rolet e tyre në një kontekst të mbrojtjes së jetës;

të bëjë të njohura institucionet e strukturat, respektive, për llojet e operacioneve të mbuluara nga ky plan dhe të përshkruajë, sipas rastit, rajonet gjeografike të përgjegjësive SAR;

të llogarisë, për të gjitha operacionet, deri në dhënien e asistencës fillestare (ushqim, veshmbathje, asistencë mjekësore etj.) për mbijetuesit dhe dërgimin e tyre në një vend sigurie;

të ketë parësor bashkëpunimin për zhvillim të përgjithshëm dhe të vazhdueshëm, koordinim dhe përmirësim të shërbimeve SAR.

#### 5. OBJEKTIVAT

Objektivat e këtij plani do të jenë:

të mbështeten dispozitat e Konventës Ndërkombëtare për Kërkimin dhe Shpëtimin Detar të IMO-së, Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar të ICAO-së, disa marrëveshje ndërkombëtare të cilat Republika e Shqipërisë i ka ratifikuar;

të ofrohet një plan i përgjithshëm për koordinimin e operacioneve të SAR-së, përdorimin efektiv të të gjitha burimeve në dispozicion dhe ndihmën e ndërsjellë;

të sigurohet një koordinimin i shërbimeve të SAR-së për të plotësuar nevojat e brendshme dhe angazhimet ndërkombëtare dhe për të dokumentuar politikat bazë kombëtare;

të sigurohet integrimi i burimeve të disponueshme që mund të përdoren për SAR-së në një rrjet bashkëpunues për mbrojtjen e jetës dhe një efikasitet më i madh në operacionet e kërkim-shpëtimit.

Strukturat pjesëmarrëse në këtë plan të njohin nevojën për bashkëpunim dhe bashkërendim të aktiviteteve, në lidhje me sigurinë dhe dëshirën për përdorimin efektiv të të gjitha burimeve të disponueshme dhe ndihmën e ndërsjellë.

#### 6. FUSHËVEPRIMI

Ky plan nuk bie në konflikt me përgjegjësitë e shërbimit të kërkim-shpëtimit (SAR-së), të dakordësuara nga shtetet firmuese të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, Konventës Ndërkombëtare për Kërkimin dhe Shpëtimin Detar ose instrumente të tjera ndërkombëtare të përshtatshme, për të cilat Shqipëria është ose mund të bëhet palë.

Ky plan ofron vetëm udhëzime të brendshme për të gjitha agjencitë nënshkruese. Asnjë dispozitë e këtij plani ose e ndonjë plani mbështetës nuk duhet të interpretohet, në asnjë mënyrë, për të cenuar përgjegjësitë dhe autoritetet e cilitdo pjesëmarrës të përcaktuara me statut, urdhëresa ekzekutive ose marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe përgjegjësitë e agjencive dhe e organizatave të tjera, për të ndihmuar personat në rrezik për jetën. Anëtarët pjesëmarrës, duke nënshkruar këtë plan kombëtar, janë të detyruar të zgjerojnë të gjithë mbështetjen dhe bashkëpunimin e mundshëm për kryerjen efektive të operacioneve SAR.

#### 7. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ZBATUESE

Institucionet/strukturat shtetërore dhe private përgjegjëse/zbatuese për Planin Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë janë:

##### 7. Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit

7.1 Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit (QKSSH), si person juridik publik, në vartësi të ministrit të Mbrojtjes, përgjigjet për planëzimin, organizimin, koordinimin dhe kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë. Ajo siguron koordinimin e përgjithshëm të operacioneve të shërbimit të kërkim-shpëtimit dhe në rolin e RCC-së, mban kontakte të drejtpërdrejta me shërbimet homologe të shteteve të tjera.

##### 7.1 Qendra Ndërinstitucionale e Operacioneve Detare (QNOD)

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) funksionon edhe si Qendër Kombëtare Detare për operacionet e kërkim-shpëtimit në det dhe përfaqëson një strukturë ndërinstitucionale bashkërenduese, me detyrë organizimin, planëzimin dhe drejtimin e operacioneve detare, përfshi edhe ato të kërkim-shpëtimit në të gjithë hapësirën detare, në përputhje me legjislacionin detar vendës e ndërkombëtar.



QNOD-ja është Qendër Kombëtare e Operacioneve të Kërkim-Shpëtimit në Det dhe ka përgjegjësi për organizimin efikas të këtyre operacioneve, brenda hapësirës detare shqiptare, si edhe jashtë kësaj hapësire, në bashkëpunim me institucionet homologe të rajonit. QNOD-ja vë në shfrytëzim sensorët e vrojtimit bregdetar për të kryer vrojtimin mbi sigurinë e anijeve në rajonin e caktuar dhe njësitë e shpëtimit në det, për kryerjen e shpejtë të operacioneve të kërkim-shpëtimit.

## 7.2 Ministria e Mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse për administrimin e përgjithshëm të shërbimit të kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe zbatimin e politikave në këtë fushë.

Ajo nënshkruan marrëveshje, në përputhje me konventat ndërkombëtare në fushën e kërkim-shpëtimit, në të cilat aderon Republika e Shqipërisë; nënshkruan marrëveshje me vendet fqinje për kushtet e hyrjes së njërive të kërkim-shpëtimit në hapësirën ajrore, detare, ujërat territoriale dhe territorin e vendeve respektive, si dhe ndjek zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara me institucionet shtetërore dhe subjektet private në fushën e shërbimit të kërkim-shpëtimit.

Ministria e Mbrojtjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi, angazhon Forcat e Armatosura në operacionet e kërkim-shpëtimit në rastet e aksidenteve ajrore, detare dhe tokësore në zonën e përgjegjësisë SAR të Republikës së Shqipërisë.

### 7.2.1 Forcat e Armatosura

Asetet e Forcave të Armatosura janë asetet kryesore në operacionet e kërkim-shpëtimit. Këto asetet do të përdoren në bazë të legjislacionit në fuqi, planeve, urdhrave, udhëzimeve dhe marrëveshjeve të nënshkruara për këtë qëllim.

### 7.2.2 Qendra e Bashkuar Operacionale

Qendra e Bashkuar Operacionale e Forcave të Armatosura, kur autorizohet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, angazhon, në interes të QKSSH-së, kapacitetet e saj dhe kapacitetet e deleguara për angazhim prej saj.

### 7.2.3 Forca tokësore

Forca tokësore zotëron kapacitete operacionale për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit, luftarake dhe joluftarake, në terrene malore, pyjore, zona të thepisura, ujëra të brendshme territoriale, në zona urbane, në zona armiqësore etj., si dhe luan

rolin e Qendrës Kombëtare Tokësore për Kërkim-Shpëtimit (LRCC). Kapacitetet e FT-së për operacione kërkim-shpëtimit do të aktivizohen në varësi të situatave.

Batalioni i Forcave Speciale është kapacitet i specializuar i forcës tokësore për të kryer edhe operacione kërkim-shpëtimit luftarak në zona të kontrolluara nga kundërshtari.

Batalioni “Komando” dhe batalionet e këmbësonisë së FT-së zotërojnë kapacitete operacionale SAR, për të kryer misione kërkimi dhe shpëtimit në kushte ekstreme të motit dhe terrenit në RSH.

### 7.2.4 Forca detare/roja bregdetare

Forca detare/roja bregdetare, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Detare për Kërkim-Shpëtimit (MRCC), planëzon, organizon dhe drejton operacionet e kërkim-shpëtimit në hapësirën detare të RSH-së.

Forca detare/roja bregdetare është njësi kryesore për realizimin e operacioneve në det dhe zotëron kapacitetet e nevojshme për planëzimin, organizimin dhe zhvillimin e operacioneve për kërkim-shpëtimit dhe dhënien e ndihmës në det.

Forca detare/roja bregdetare zotëron kapacitete operacionale për gjithë shtrirjen e bregdetit shqiptar, nëpërmjet vendbazimeve të përhershme dhe të përkohshme, ka në dispozicion anije të gatshme për përgjigje të menjëhershme ndaj situatave të fatkeqësisë, si dhe ka aftësinë për t’iu përgjigjur këtyre situatave, në kohën më të shkurtër të mundshme.

Në varësi të situatës konkrete, kërkon bashkëpunim e bashkëveprim me të gjitha institucionet pjesëmarrëse në QNOD dhe, sipas rastit, kërkon mbështetje me anije të tjera ose bashkëpunimin me institucionet ndihmëse për mbështetjen e operacionit në bregdet.

Forca detare/roja bregdetare zhvillon, krijon, mirëmban dhe përdor kapacitetet e saj për promovimin e sigurisë në, nën dhe mbi ujërat territoriale dhe ujërat ndërkombëtare nën juridiksionin e RSH-së për operacionet e kërkim-shpëtimit në det.

### 7.2.5 Forca ajrore (FAj)

Forca ajrore (FAj) është një nga asetet kryesore të FARSH për shërbimin SAR dhe nëpërmjet Qendrës Kombëtare Ajrore për Kërkim-Shpëtimit (ARCC), planëzon, organizon dhe kryen



operacione kërkim-shpëtimi në hapësirën tokësore dhe mbi ujërat detare të RSH-së.

Është njësi kryesore dhe zotëron kapacitetet e nevojshme për planëzimin, organizimin dhe zhvillimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe evakuimit (MEDEVAC).

Forca ajrore zotëron kapacitete operationale në gjithë shtetin e territorit shqiptar, nëpërmjet vendbanimeve të përhershme dhe të përkohshme. Ajo ka në dispozicion helikopterë të gatshëm e me konfigurim SAR, për reagim të menjëhershëm ndaj situatave të fatkeqësisë, Qendrën e Kontroll-Raportimit, Shërbimin Meteorologjik Ushtarak, si dhe ka aftësinë për t'iu përgjigjur këtyre situatave, në kohën më të shkurtër të mundshme.

#### 7.2.6 Komanda e Mbështetjes (KM)

KM-ja, me kapacitetet e saj operationale dhe kapacitetet e vendosura në rajone të ndryshme të vendit, të plotësuara me personel e pajisje të lëvizshme, organizon dhe drejton operationet e kërkim-shpëtimit në hapësirat territoriale tokësore dhe ujërat e brendshme të RSH-së, si dhe është e aftë për t'iu përgjigjur në mënyrë të menjëhershme dhe në fazën fillestare të operacioneve apo krizave të mundshme.

Batalioni i Mbështetjes Rajonale, si struktura kryesore për operationet e kërkim-shpëtimit, kapacitetet e tij kryesore i ka të dislokuara në Tiranë dhe ato të limituara/destinuara për kërkim-shpëtim, në detashmentet rajonale Kukës, Burrel, Korçë dhe Gjirokastrë.

Kapacitetet operationale të batalionit të Mbështetjes Rajonale janë të specializuara për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit ujor, kërkim-shpëtimit në rast tërmetesh, dhe kërkim-shpëtimit në zonat malore.

#### 7.2.7 Strukturat mbështetëse të Forcave të Armatosura

Strukturat mbështetëse të Forcave të Armatosura, si: Policia Ushtarake, batalioni i Xhenios, batalioni i Transportit, batalioni i Furnizimit, Njësia Mjekësore Ushtarake etj., zotërojnë kapacitete ndihmuese e mbështetëse për operationet e kërkim-shpëtimit dhe do të aktivizohen, rast pas rasti, në kushtet e operacioneve masive SAR.

### 7.3 Ministria e Brendshme

Ministria e Brendshme, përveç detyrimeve ligjore dhe nënligjore që ka për shërbimin SAR në RSH, mbështet, me kapacitetet e saj, operationet e

kërkim-shpëtimit dhe bashkërendon veprimet me strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes.

#### 7.3.1 Policia e Shtetit

Bashkëpunon ngushtësisht me QKKSH-në në Ministrinë e Mbrojtjes, duke e informuar atë, në kohën më të shkurtër, për ngjarjet SAR të ndodhura në zonën e përgjegjësisë të RSH-së, si dhe koordinon veprimet me të dhe strukturat e tjera të angazhuara në operationet SAR për shpëtimin e jetëve njerëzore.

Policia e Shtetit informon strukturat operationale të kërkim-shpëtimit të vartësisë, në rastet e aksidenteve ajrore, detare, katastrofave dhe fatkeqësive të ndryshme; siguron ruajtjen e rajonit të aksidentit, siguron qarkullimin rrugor, pa pengesa, të strukturave operationale të kërkim-shpëtimit për në rajonin e kërkimit; identifikon personat që japin informacion të rremë, si dhe kontribuon, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të saj, për identifikimin e viktimeve.

Policia e Shtetit, në rastet e aksidenteve SAR në zonën e përgjegjësisë së RSH-së, ofron bashkëpunim të plotë me strukturat homologe të shteteve të tjera të përfshira në aksident për ruajtjen e vendit të ngjarjes dhe zhvillimin e hetimeve, konform ligjeve, rregullave dhe konventave ndërkombëtare, të ratifikuara nga vendi ynë.

#### 7.3.2 Policia Kufitare dhe e Migracionit

Strukturat e Policisë Kufitare dhe të Migracionit, në përbërje të Policisë së Shtetit, mbështesin, me kapacitetet e tyre, operationet e kërkim-shpëtimit, përshejtojnë procedurat e emigracionit gjatë operationit SAR që përfshin ekuipazhin e huaj/udhëtarët dhe, gjithashtu, ofrojnë ekspertë të gjuhëve të huaja sa herë që kërkohet nga agjencitë e SAR-së.

#### 7.3.3 Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH)

Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH) siguron ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës e pronës në aksidente të ndryshme ajrore e tokësore, ku ka prani të zjarreve ose premisa për rënien e tyre. Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit ka struktura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

### 7.4 Ministria përgjegjëse për punët publike dhe transportin

Ministria përgjegjëse për punët publike dhe transportin, mbështet, me kapacitetet e saj, operationet e kërkim-shpëtimit. Ajo informon



strukturat operationale të kërkim-shpëtimit të vartësisë, për pozicionin, kursin, shpejtësinë dhe sinjalet e thirrjes së avionëve/anijeve në rrezik, brenda rajonit kombëtar të kërkim-shpëtimit; transmeton dhe ndërhyt menjëherë tek avionët/anijet, që ndodhen në afërsi të incidentit, për dhënie ndihme, duke marrë përgjegjësitë e përcaktuara në konventat ndërkombëtare, të pranuar me ligj, si dhe kufizon ose ndalon, përkohësisht, fluturimin dhe lundrimin në të gjithë territorin e vendit ose në një pjesë të tij, kur i kërkohet nga strukturat operationale të kërkim-shpëtimit, gjatë periudhës së emergjencës.

### **7.5 Struktura dhe agjenci në interes të lundrimit ajror**

7.5.1 Organi Kombëtar i Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore (OKIA)

Organi Kombëtar i Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore në Aviacion Civil është përgjegjës për investigimet e incidenteve/aksidenteve ajrore brenda hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë. Ky organ ka për mision të përmirësojë sigurinë në fluturim, duke përcaktuar shkaqet e aksidenteve dhe të incidenteve ajrore dhe duke bërë rekomandime sigurie që kanë për qëllim të parandalojnë ngjarje të njëjta në të ardhmen. Në raste të incidenteve apo të aksidenteve të mjeteve civile ajrore, shërbimet e kërkim-shpëtimit duhet të njoftojnë menjëherë autoritetet e OKIA-së për të asistuar dhe investiguar për incidentin. Marrëdhëniet e njëjta të kërkim-shpëtimit me OKIA-në, për detyrimet reciproke në operacionet e kërkim-shpëtimit, rregullohen me marrëveshje të veçanta e të miratuara nga dy palët.

7.5.2 Autoriteti i Sigurisë së Transportit

Ky autoritet është përgjegjës për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve ku përfshihen shërbimet e transportit. Shërbimi SAR ka për detyrë të njoftojë këtë autoritet për aksidentin ose incidentin e ndodhur. Njëkohësisht, ky autoritet mund të japë informacion për njësitë SAR rreth vendit të përplasjes së një mjeti, i cili mund të përdoret për planifikimin e saktë të operacionit të kërkimit.

Marrëdhëniet e njëjta të kërkim-shpëtimit me Autoritetin e Sigurisë së Transportit për detyrimet reciproke në operacionet e kërkim-shpëtimit rregullohen me marrëveshje të veçanta e të miratuara nga dy palët.

7.5.3 Autoriteti i Aviacionit Civil

AAC-ja është përgjegjëse për zbatimin e Kodit Ajror, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë kod. Fusha e veprimtarisë së Autoritetit të Aviacionit Civil është rregullimi dhe mbikëqyrja e të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë

AAC-ja nëpërmjet Zyrës së Rregullimit të Hapësirës Ajrore, ka përgjegjësinë të deklarojë Zonat e Rrezikshme dhe të Kufizuara, gjatë kryerjes së Operacioneve SAR.

Të gjitha njësitë dhe shërbimet e trafikut ajror (ACC), në funksion të përgjegjësisë të tyre, duhet të shpallin fazën e incidentit SAR për avionët, të klasifikojnë nivelin e emergjencës dhe të njoftojnë QKKSH-në. Gjithashtu, këto autoritete duhet të veprojnë si ndërmjetës midis personave që raportuan kërkesën për ndihmë ndaj mjetit ajror që ndodhet në rrezik dhe Qendrës së Koordinimi Shpëtimit (RCC).

Autoriteti i Aviacionit Civil kontrollon trafikun ajror dhe ofron informata për të ndihmuar në operacionet SAR.

Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të sigurojë një listë të përditësuar të avionëve civilë të regjistruar në Shqipëri, të koordinojë fleksibilizimin e hapësirës ajrore nga trafiku ajror civil dhe ushtarak dhe të lëshojë njoftime për sigurinë ajrore gjatë një operacioni të veçantë SAR.

Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të ndihmojë agjencitë detare të SAR-së, sa herë që kërkohet, për të siguruar listën e pasagjerëve të avionit në gjendje të vështirë në det dhe devijimin e avionëve të tjerë, nëse është e mundur, për të gjetur anije/avionë në vështirësi.

7.5.4 Shoqata Kombëtare e Aeronautikës dhe Hapësirës

Shoqata Kombëtare e Aeronautikës është një strukturë e rëndësishme për mbështetjen e operacioneve SAR në Republikën e Shqipërisë, pasi ajo bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Aeronautikës dhe Hapësirës (NASA).

Agjencia Kombëtare e Aeronautikës dhe Hapësirës (NASA) ka avionë, anije kozmike dhe mbikëqyrje në mbarë botën, rrjete të të dhënave dhe rrjete të komunikimit, të cilat mund të ndihmojnë në operacionet e SAR-së. Përveç kësaj, NASA mbështet objektivat e SAR-së përmes kërkimit dhe zhvillimit ose aplikimit të teknologjisë për kërkimin, shpëtimin, mbijetesën dhe sistemet e



pajisjet e rimëkëmbjes, të tilla si sistemet e përcjelljes së vendndodhjes, transmetuesit, marrësit dhe antenave të afta për gjetjen e avionëve, anijeve, ose individëve në vështirësi të mundshme ose aktuale.

#### 7.5.5 Shërbimi Meteorologjik Ushtarak

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak, në përbërje të Forcës Ajrore, me kapacitetet e veta siguron informacion të nevojshëm të kushteve meteorologjike për mbështetjen e shërbimit SAR, në interes të Forcave të Armatosura dhe të institucioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë.

#### 7.5.6 Albcontrolli (ALBCONTROL)

ALBCONTROL ofron shërbime të lundrimit ajror në hapësirën shqiptare (FIR), në kushtet e parrezikshmërisë, cilësisë, kujdesit ndaj mjedisit dhe i orientuar ndaj klientit.

Njësia e Mbikalimeve Ajrore (ACC) menaxhon të gjithë trafikun që mbikalon në hapësirën shqiptare, me destinacion vende të ndryshme të botës.

Njësia e Afrimit (APP) menaxhon trafikun e avionëve që ulen e ngrihen nga Shqipëria.

Njësia e Kullës së Kontrollit (TWR) është përgjegjëse për menaxhimin e trafikut të lëvizjeve në tokë dhe lartësi jo më të mëdha se 800 metra.

Shërbimi i Informacionit Aeronautik (AIS) merr, nga burime të autorizuara dhe bashkon, përpunon, publikon, ruan dhe shpërndan tek ekuipazhet dhe operatorët aeronautikë, të dhëna dhe informacion aeronautik të standardizuar ndërkombëtar, i nevojshëm për sigurinë, rregullsinë dhe eficiencën e lundrimit ajror në hapësirën ajrore shqiptare (FIR).

#### 7.5.7 Aeroporti ndërkombëtar i Tiranës (TIA)

TIA (*Tirana International Airport*) afron shërbimet kundër zjarrit dhe të dhënies së ndihmës së parë për zonën e aeroportit.

#### 7.5.8 Qendra e Vëzhgimit Ajror

Qendra e Vëzhgimit Ajror, në përbërje të Faj-së, mbështet operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR). Me kapacitetet e veta dhe të NATO-s, realizon dhe integron informacionin e vëzhgimit për krijimin e panoramës ajrore, si dhe mbështet sigurimin e kushteve për kryerjen e funksioneve të QKR (CRC), si pjesë e sistemit NATINADMS, policimit ajror, kryerjen e kontrollit të mjeteve ajrore në vartësi, si dhe menaxhimin e rasteve renegate në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë.

## 7.6 Struktura dhe agjenci në interes të lundrimit detar

### 7.6.1 Drejtoria e Përgjithshme Detare (Autoriteti Portual)

Drejtoria e Përgjithshme Detare siguron navigim dhe siguri të transportit detar, zbatim të konventave ndërkombëtare për kërkim-shpëtimit në det, hartimin dhe zbatimin e programeve parandaluese për anijet tregtare që veprojnë në ujërat tona, mbajtjen e të dhënave të numrit të Shërbimit Detar të Shërbimit Mobile (MMSI) të të gjitha anijeve të regjistruara me to, ofrimin e shërbimeve satelitore për zbulimin dhe gjetjen e personave në rrezik të mundshëm ose aktual, ofrimin e vizatimit detar dhe aeronautik; informacion mbi rrymat jonormale, parashikimet detare mjedisore dhe paralajmërime për det të me dallgë të larta, si dhe ujërat e të dhënat mjedisore që përdoren për planifikimin e kërkimit për operacionet SAR.

### 7.6.2 Kapitenaritë e Porteve

Kapitenaritë e Porteve (Durrës, Shëngjin, Vlorë, Himarë dhe Sarandë) funksionojnë sipas standardeve evropiane dhe ndërkombëtare me personel e efektiv të trajnuar për plotësimin e kërkesave të ligjshmërisë detare kombëtare dhe ndërkombëtare, garantojnë standardin teknik të anijeve, sigurinë e jetës në det dhe mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi, si dhe janë kapacitete të rëndësishme kombëtare për mbështetjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit në det.

Kapitenaritë e porteve ofrojnë asistencë dhe ndihmë për agjencitë e SAR gjatë operacioneve të SAR që ndodhen pranë porteve dhe zonave në det të hapur.

### 7.6.3 Policia Kufitare dhe e Migracionit (PKM)

Policia kufitare bregdetare siguron mjete detare dhe ndihmë për agjencitë koordinuese, kur kërkohet të shtojnë përpjekjet e SAR-së. Në mbështetje të kërkesave të bëra nga oficeri i Shërbimit të Rojës Bregdetare në QNOD, OCT i PKM-së mbështet operacionin SAR me mjete dhe ndihmon për njoftimin e bashkëveprimin me institucionet e tjera në zonën e operacionit. Nën mbështetjen e PKM-së janë, gjithashtu, edhe mjetet detare të *Guardia Di Finanza*-s.

### 7.6.4 Pushteti vendor bregdetar

Pushteti vendor bregdetar siguron asetet, mjetet emergjente mjekësore dhe të tjera që do të





kontribuonin në operacionet efektive të SAR-së, kur kërkohet nga agjencitë koordinuese.

#### 7.6.5 Operatorët e anijeve të lundrimit

Sipas Konventës Ndërkombëtare për Shpëtimin, Londër, 28 prill 1989, neni 10, çdo kapiten ka detyrë t'i japë asistencë çdo personi të rrezikuar për të humbur në det, nëse ai mund ta bëjë këtë pa dëmtuar seriozisht mjetin e tij të lundrimit dhe personat në të.

Anijet lundruese që veprojnë përgjatë brigjeve tona për qëllime tregtare, duhet t'u japin ndihmë agjencive koordinuese, kur kërkohet të shtojnë përpjekjet e SAR-së.

#### 7.6.6 Komuniteti i peshkimit

Komuniteti i peshkimit që përfaqëson peshkatarët dhe vepron rreth brigjeve tona, vë në dispozicion mjetet e veta për agjencitë koordinuese, kur kërkohet të shtojnë përpjekjet e SAR-së.

#### 7.6.7 Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD)

Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD) administrohet nga forca detare/roja bregdetare dhe punon 24 orë. Ai përfshin radarët, AIS-në dhe VHF Detare.

#### 7.6.8 Sistemi i Vëzhgimit të Anijeve (SVA)

Sistemi i Vëzhgimit të Anijeve i referohet sistemit *BluBox* për monitorimin e anijeve të peshkimit të RSH-së. Ky sistem administrohet nga Inspektorati i Peshkimit. Të gjitha anijet e peshkimit me gjatësi më të madhe se 12 m janë të pajisura me aparatin e transmetimit të të dhënave. Anijet më të vogla janë të pajisura vetëm me mjete komunikimi.

#### 7.6.9 Sistemi i radiokomunikimit TETRA

Sistemi i radiokomunikimit TETRA administrohet nga QNOD-ja dhe siguron komunikim të kriptuar që përdoret gjatë të gjitha operacioneve detare.

7.6.10 Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS) dhe Sistemi i Teknologjisë së Informacionit për Menaxhimin e Inteligjencës (MEMEX) janë të vendosur në QNOD e administrohen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit (PKM).

### 7.7 Ministria e Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë siguron kapacitete materiale dhe njerëzore për mbështetjen e operacioneve SAR dhe trajtimin shëndetësor të njerëzve në rrezik për jetën. Kjo ndihmë jepet nga spitalet dhe qendrat shëndetësore shtetërore,

spitalet dhe qendrat shëndetësore private, si dhe njësia e transportit ajror/ambulancë ajrore.

### 7.8 Ministritë përgjegjëse për mjedisin, pyjet dhe administrimin e ujërave

Ministritë dhe institucionet përgjegjëse për mjedisin, pyjet dhe administrimin e ujërave mbështesin me kapacitetet e tyre operacionet e kërkim-shpëtimit, si dhe marrin përgjegjësitë ligjore, që vijnë si rrjedhim i aderimit në konventat ndërkombëtare, kur shkalla e ndotjes për shkak të aksidentit është e lartë dhe rrezikon ndotjen e ujërave ndërkufitare.

Ato informojnë menjëherë strukturat operacionale të kërkim-shpëtimit për pozicionin, kursin, shpejtësinë dhe për sinjalet e thirrjes së anijeve në rrezik, brenda rajonit kombëtar të kërkim-shpëtimit; transmetojnë dhe ndërhyjnë menjëherë tek anijet që ndodhen në afërsi të incidentit, për dhënie ndihme, duke marrë përgjegjësitë e përcaktuara në konventat ndërkombëtare të pranura me ligj; nëpërmjet rrjetit të agjencive rajonale të mjedisit dhe pyjeve, identifikojnë shkallën e ndotjes dhe rezultatet i bëjnë publike, kur incidenti shoqërohet me ndotje të mjedisit (ajrit, ujërave, tokës).

### 7.9 Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, si një njësi kombëtare kërkimore shkencore, realizon kërkime shkencore në fushën e rreziqeve natyrore, si dhe të atyre të krijuara nga aktiviteti i njeriut (rrëshqitje, erozion, përmytje, ndotje e mjedisit etj.).

### 7.10 Drejtoria Rajonale e Ujitjes dhe Kullimit

Drejtoria Rajonale e Ujitjes dhe Kullimit i siguron Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit tregues të vendndodhjes dhe të dhëna për digat dhe hidrovoret në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në vendin e aksidentit.

### 7.11 Kompanitë private detare dhe ajrore të licencuara

Kompanitë private të licencuara për anijet dhe avionët civilë (për ato mjete që përfshihen në regjistrat që menaxhohen nga Drejtoria e Përgjithshme Detare (DPD) dhe Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) kanë detyrim ligjor për ofrimin e ndihmës në rastet e aksidenteve detare dhe ajrore. QKKSH, në rastet e operacioneve SAR, u kërkon, nëpërmjet autoriteteve të DPD-së apo



AAC-së, kufizimin e lundrimit apo të fluturimit në zonën e veprimeve SAR, si dhe vënien në dispozicion të operacionit kapacitetet e tyre SAR etj.

#### **7.12 “Shega Air” sh.p.k.**

“Shega Air” sh.p.k. është pjesë e shoqërisë “Shega Group” në Shqipëri, për shërbimet e transportit dhe logjistikës. “Shega Air” sh.p.k. ofron fluturime për evakuim, fluturime për misione të ndryshme filmike dhe fotografike etj.

Marrëdhëniet e njëjste të kërkim shpëtimit me “Shega Air” sh.p.k., për detyrimet reciproke në operacionet e kërkim-shpëtimit, rregullohen me marrëveshje të veçanta e të miratuara nga dy palët.

#### **7.13 Strukturat e menaxhimit të emergjencave civile në Republikën e Shqipërisë**

7.13.1 Zyra Operacionale e Situatës në Kryeministri

Zyra Operacionale e Situatës (në vijim “ZOS”) është strukturë pranë Kryeministrit për mbledhjen e informacionit për emergjencat civile dhe krizat. ZOS-ja harton raporteve analitike periodike për kryeministrin, Këshillin e Ministrave dhe KMC-në, si dhe mban komunikim të vazhdueshëm me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ZIMEK-së, QKKSJH dhe qendrat operacionale.

7.13.2 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile koordinon, në nivel kombëtar, të gjitha veprimet dhe zbaton politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

#### **7.14 Prefekti, bashkitë, komisionet lokale të MC-së**

Pushteti vendor ka detyrimin kushtetues për planifikimin dhe përballimin e gjendjes së krijuar pas një fatkeqësie natyrore, teknologjike ose emergjence civile, të ndodhura në rajonin e prefekturës apo bashkisë përkatëse.

#### **7.15 Organizatat vullnetare për përballimin e emergjencave civile**

7.15.1 Qendra Vullnetare e Emergjencave Civile (QVEC)

Qendrat Vullnetare të Emergjencave Civile numërojnë mbi 600 vullnetarë, të cilët janë mjekë të kualifikuar të specialiteteve të ndryshme, infermierë, studentë të mjekësisë e infermierisë, pensionistë, të rinj të profesioneve të ndryshme me përvojë në fushën e dhënies së ndihmës në rastet e emergjencave civile dhe operacioneve SAR.

#### **7.16 Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSJH)**

Kryqi i Kuq Shqiptar, me rreth 90 mijë anëtarët dhe rreth 2 500 vullnetarë të trajnuar për operacione në rast fatkeqësish, është organizata më e madhe vullnetare në Shqipëri.

KKSJH-ja ka krijuar kapacitete për të ndihmuar, në rast aksidentesh ajrore dhe detare, duke u fokusuar në dhënien e ndihmës së parë dhe kujdesit shëndetësor. KKSJH-ja është i pajisur me sisteme radiokomunikimi dhe disponon tri qendra trajnimi, në nivel lokal dhe një të tillë, në nivel qendror. OJQ të tjera si Karitas, Organizata “Nënë Tereza” etj., kanë kapacitete për të ndihmuar në rast aksidentesh ajrore dhe detare, duke u fokusuar kryesisht në sigurimin e ndihmave materiale.

#### **7.17 Autoriteti i Komunikimit dhe Medies në Shqipëri**

Autoriteti i Komunikimit dhe Medies në Shqipëri rregullon përdorimin e frekuencave të radiove dhe ndihmon me drejtimin/orientimin e shërbimit të kërkimit dhe shpëtimit për gjetjen/zbulimin e personave të humbur. Ky autoritet, gjithashtu, publikon dhe mban një *database* të licencave të radiove dhe të shenjave të thirrjes detare, ajrore etj. dhe asnjëherë nuk ndërhyr në frekuencat e punës dhe shenjat e thirrjes gjatë operacioneve SAR.

7.17.1 Departamenti i telekomunikacionit nxjerr rregulla dhe rregullore për përdorimin joqeveritar të pajisjeve pa tela dhe radiove për promovimin e sigurisë së jetës dhe pronës dhe bashkëpunimin në operacionet e SAR-së.

7.17.2 Alblekomi dhe kompanitë celulare që operojnë në Republikën e Shqipërisë, në rast aksidentesh detare dhe ajrore ndihmojnë në lokalizimin e sinjaleve të emergjencës, me qëllim orientimin e strukturave operacionale të kërkim-shpëtimit.

7.18 Doganat

Në rast se është drejtuar thirrje për ndihmë ndërkombëtare, shërbimet doganore dhe ato kufitare shqiptare, pas njoftimit, duhet të ofrojnë asistencë të menjëhershme për lehtësimin e procedurave të hyrjes së grupeve të kërkim-shpëtimit, pajisjeve të tyre të shpëtimit dhe qenve të kërkimit, si dhe heqjen e disa tarifave doganore.

#### **7.19 Asetet SAR të vendeve të tjera sipas marrëveshjeve**

7.19.1 Qendrat e koordinim-shpëtimit të vendeve fqinje



Qendrat e koordinim-shpëtimit ose struktura/t të marrëdhënieve me jashtë mund të marrin/dërgojnë kërkesa nga/te qendrat e koordinim-shpëtimit të vendeve të huaja për mbështetje me/të operacione/ve SAR, sipas marrëveshjeve për këtë qëllim.

### 7.20 Qendra e Kontrollit të Misionit Satelitor për dhënien e sinjalit/alertit të fatkeqësisë

Qendra e Kontrollit të Misionit Satelitor (ITMCC), e instaluar në Bari, Itali, i merr e para sinjalet e fatkeqësisë nga pajisjet satelitore që transmetojnë sinjalet e fatkeqësisë që aktivizohen në mjetet ajrore (ELT), detare (EPIRB) apo personale (PLT) që mund të jenë në situatë të tillë dhe të dhënat i transmeton në qendrat e koordinim-shpëtimit të vendeve që mbulohen nga kjo qendër, përfshi edhe FARSH-në. Me marrjen e sinjalit dhe pas vlerësimit të tij, nëse rezulton se ngjarja ka ndodhur brenda zonës sonë të përgjegjësisë, QKKSJ-ja do të marrë përgjegjësinë për kryerjen e operacionit SAR dhe koordinimin e veprimeve në varësi të nivelit të aksidentit. Alarmi i pajisjes së sinjalizimit të fatkeqësisë do të vazhdojë për aq kohë sa kjo pajisje të çaktivizohet.

*Shënim. Organet shtetërore dhe private, të përcaktuara në këtë plan, janë përgjegjëse për të dhënë ndihmë në operacionet e kërkim-shpëtimit.*

Institucionet e tjera shtetërore, si dhe subjektet private që nuk përfshihen në këtë plan, sa herë u kërkohet nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, janë të detyruara të ofrojnë ndihmën e tyre në njerëz dhe mjete.

Çdo mjet ajror/detar, si dhe çdo shtetas shqiptar, në përputhje me mundësitë reale, ka për detyrë të lajmërojë për çdo aksident të vrotuar dhe të kontribuojë në dhënien e ndihmës.

### 8. LIDHJA ME PLANET E TJERA

Plani Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit është një dokument harmonizues, gjithëpërfshirës, i cili mbledh së bashku të gjitha institucionet dhe strukturat kombëtare në përgjigjen ndaj situatave SAR. Ky plan nuk i zëvendëson planet e institucioneve shtetërore e private në fushën e kërkim-shpëtimit, por i harmonizon dhe i sjell ato së bashku në një frymë bashkërendimi.

Plani Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit është hartuar përmes konsultimeve dhe shkëmbimit të informacioneve me institucione të ndryshme dhe, si rrjedhim, përfshin idetë dhe procedurat e planeve specifike, duke i lidhur ato me përgjigjen e

planifikuar të institucioneve, të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Plani Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit reflekton përgjegjësi më të gjera, jo vetëm në përgjigje, por dhe në parandalim, lehtësim, përgatitje, mbrojtje dhe rikthim në normalitet.

### PJESA E DYTË

#### 1. RAJONI I KËRKIM-SHPËTIMIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Rajoni i Kërkim-Shpëtimit (SRR) përcaktohet për të siguruar përdorimin me efektivitet të kapaciteteve më të përshtatshme për komunikimin, trajtimin efikas të sinjaleve të rrezikut dhe koordinimin e duhur për të mbështetur, në mënyrë efektive, shërbimet SAR gjatë operacioneve SAR në tokë.

Krijimi i SRR-së bazohet në mirëkuptimin midis shteteve në lidhje me përgjegjësitë e pranuar për koordinimin apo ofrimin e shërbimeve SAR civile.

Ekzistenca e kufijve SRR nuk duhet të shihet si një bazë për të kufizuar, vonuar apo kufizuar, në çfarëdo mënyre, një veprim të shpejtë dhe efektiv për lehtësimin e situatave emergjente.

SRR-ja vendoset në bashkëpunim me vendet fqinje dhe njihet ndërkombëtarisht përkatësisht nga IMO-ja ose dokumente të ICAO-së.

Zona e përgjegjësisë detare dhe ajrore janë të harmonizuara me njëra-tjetrën për aq sa është e mundur, megjithatë, linjat ndarëse të SRR-së normalisht duhet të miratohen nga qeveritë që kanë SRR fqinje, kur është e mundur. SRR-ja nuk do të lejohet të ndikohet në mënyrë të padrejtë nga kufijtë politikë.

Siç përcaktohet në Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar (aneksi 12) dhe Konventën Ndërkombëtare Detare, një SRR e njohur është e lidhur me një RCC.

#### Rajoni i Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë

Sistemi SAR në RSH bëhet i integruar në sistemin global SAR, duke krijuar SRR të caktuar nga organizmat ndërkombëtarë dhe RCC, të cilat përputhen me standardet ndërkombëtare.

Rajoni i Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë (SRR), mbështetur në Konventën e Çikagos dhe IMO-së, është identik me rajonin përkatës të navigimit ajror e, si i tillë, ai përputhet me kufijtë e Tiranës FIR, si dhe marrëveshjet



ndërkombëtare që janë në fuqi me vendet fqinje. Harta SRR e Shqipërisë është paraqitur në lidhjen nr. 1, shtojca A.

Bazuar në ligjin nr. 821, datë 26.9.2001, “Për ratifikimin e marrëveshjes për shërbimet tranzit ajror ndërkombëtar”, Çikago, 1944, fusha e përgjegjësive SAR e Republikës së Shqipërisë përkon me fushën e përgjegjësive brenda kufijve shtetërorë.

Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të 19 majit 2000 midis Italisë dhe Shqipërisë (*Memorandum of Understanding ALB-ITA Declared by ICAO, SAR. 6/Circ. 43*, 20 janar 2010), hapësira detare e RSH-së ndahet nga hapësira detare e Italisë, për qëllime SAR në vijën me koordinata:  $\varphi$ :  $41^{\circ} 23'30''N$   $\lambda$ :  $18^{\circ}19'30''E$ ;  $\varphi$ :  $40^{\circ} 25' 00''N$ ;  $\lambda$ :  $19^{\circ} 00'00'' E$ .

Deri në nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në fushën e SAR-së me fqinjët detarë dhe tokësorë të RSH-së dhe deklarimit të tyre në ICAO/IMO, si zonë përgjegjësie SAR do të funksionojë Rajoni Informativ i Fluturimit/*Flight Information Region (FIR)*, ku çdo mjet ajror, detar apo tokësor që ndodhet në fatkeqësi brenda kësaj zone, është i detyruar të kërkojë ndihmë tek autoritetet SAR të RSH-së. Nuk përjashtohet dhe nuk neglizhohet edhe dhënia e ndihmës edhe jashtë kufijve të FIR-së, kur kjo kërkohet nga autoritetet SAR të vendeve fqinje dhe miratohet nga autoritetet vendimmarrëse të Republikës së Shqipërisë.

Rajoni Informativ i Fluturimit të Republikës së Shqipërisë përfshin kufirin tokësor dhe kufirin e ujërave detare, sipas vijës që kalon në pikat me koordinata: ( $41^{\circ} 52'N$   $19^{\circ} 21'E$ ;  $41^{\circ} 08'N$   $18^{\circ} 52' E$ ;  $40^{\circ} 45' N$   $19^{\circ} 00'E$ ;  $40^{\circ} 25'N$   $19^{\circ} 00'E$ ) që është zona e përgjegjësive së operacioneve të kërkim-shpëtimit të Republikës së Shqipërisë.

Republika e Shqipërisë, në bazë të legjislacionit shqiptar, marrëveshjeve rajonale dhe konventave ndërkombëtare ku ajo është palë, me burimet njerëzore dhe materiale që disponon për organizimin dhe kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit, përgjigjet për dhënien e ndihmës për çdo mjet ajror, detar apo person që ndodhet në rrezik dhe kërkon ndihmë, brenda hapësirave territoriale tokësore dhe detare të saj.

Udhëzimet dhe standardet përkatëse të IMO-së dhe ICAO-së (aneksi 12) të këtyre RCC-ve janë zhvilluar dhe mund të gjenden në konventat

përkatëse, manualin IAMSAR dhe botime të tjera, të cilat duhet të mbahen dhe të përdoren nga QKKSH-ja/RCC-ja e RSH-së. Koordinatorët SAR, siç përcaktohet në këtë plan, janë përgjegjëse për organizimin e shërbimeve SAR dhe krijimin e RCC-së për SRR-në përkatëse. Kjo RCC duhet të pajiset me personel të trajnuar mbi shërbimin 24-orësh.

## 2. KAPACITETET KOMBËTARE SAR NË RSH

Bazuar në ligjin nr. 10435, datë 23.6.2011, “Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”, kapacitetet SAR ndahen në “parësore” dhe “dytësore”.

### 2.1 Kapacitetet parësore të SAR-së

Kapacitetet parësore të SAR-së janë të gjitha ato kapacitete (forca dhe mjete) që mbahen në gatishmëri të përditshme, për angazhim të menjëhershëm nga QKKSH-ja për operacione SAR. Këto kapacitete janë:

2.1.1 Kapacitet ajrore të bazës ajrore Farkë/forcës ajrore;

2.1.2 Kapacitetet detare të rojës bregdetare/forcës detare;

2.1.3 Kapacitetet e Shërbimit Zjarrfikës në Republikën e Shqipërisë;

2.1.4 Kapacitetet e Shërbimit të Urgjencës Mjekësore në RSH;

2.1.5 Kapacitetet Operacionale të Aeroporteve dhe të Bazave Ajrore në RSH;

2.1.6 Personeli i Ekipeve të Mbrojtjes Civile, i cili është trajnuar për operacionet e SAR-së në juridiksionin e prefekturave dhe bashkive;

2.1.7 Ekipeve speciale të zhytjes me pajisjet speciale të forcës detare, Batalionit të Mbështetjes Rajonale, Batalionit të Forcave Speciale;

2.1.8 Ekipeve të operacioneve speciale (mjete dhe personel) të Forcave të Armatosura dhe të Policisë së Shtetit.

Koha e vënies në gatishmëri e kapaciteteve parësore të SAR është deri në 30 minuta (sipas rajonit), në mënyrë që të jetë në gjendje të përgjigjen menjëherë. Në rast të një incidenti me një numër të madh personash në vështirësi (mbi 30), zbatohet plani kombëtar në lidhje me operacionet masive të shpëtimit.

### 2.2 Kapacitetet dytësore të SAR-së

Kapacitetet dytësore SAR janë të gjitha ato kapacitete (pajisje dhe personel) të shërbimeve që nuk mbahen në gatishmëri për vendosjen e



menjëhershme për qëllime SAR. Ato mund të mobilizohen pas një kërkesë që transmetohet nga QKKSH-ja, që ata të marrin pjesë në një operacion SAR. Këto kapacitete janë:

2.2.1 Helikopterë të tjerë bazës ajrore Farkë/forcës ajrore;

2.2.2 Mjetet ajrore të Policisë së Shtetit;

2.2.3 Mjetet ajrore të Ministrisë së Shëndetësisë;

2.2.4 Mjete e tjera detare të forcës detare/roja bregdetare dhe autoriteteve portuale të Shqipërisë;

2.2.5 Mjetet ajrore të kompanive private (helikopterë civilë);

2.2.6 Forca dhe mjete të autoriteteve vendore (bashki, njësi administrative etj.);

2.2.7 Personel dhe asete të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, spitaleve dhe klinikave private;

2.2.8 Kryqi i Kuq Shqiptar;

2.2.9 Struktura qeveritare qendrore dhe vendore në varësi të incidentit;

2.2.10 Anije shpëtimi dhe varka shpëtimi;

2.2.10 Ekipet vullnetare të shpëtimit;

2.2.11 Grupet e mbrojtjes së shpëtuesve të njësisive administrative.

### 2.3 Stacionet e gatishmërisë dhe të njoftimit

Stacionet e gatishmërisë dhe njoftimit të SAR-së janë të parët që marrin informacionin e çdo anijeje ose avioni në gjendje të vështirë dhe ata e informojnë menjëherë QKKSH-në. Këto stacione paralajmëruese përfshijnë:

1. Qendrën e Kontrollit Ajror Rinas (QKR);

2. Stacionet RADAR të ajrit;

3. Stacionet RADAR të SIVHD-së;

4. JRCC-të e vendeve të tjera;

5. COSPAS-SARSAT MCCs.

6. Çdo stacion, agjenci apo person tjetër, i cili merr njohuri për ekzistencën ose dyshimin e ndonjë personi në rrezik për jetën.

### 3. KONCEPTI I PËRDORIMIT TË ASETEVE SAR

“Koncepti i përdorimit të aseteve SAR” qartëson se kush dhe çfarë bën për ofrimin e shërbimeve gjatë një operacioni, duke përcaktuar mënyrën se si do të përdoren këto asete dhe si do të bëhet koordinimi, sipas niveleve të përcaktuara të operacioneve SAR dhe fazave të vlerësimit të një incidenti.

Koordinimi, menaxhimi, ekzekutimi i incidenteve SAR kalon nëpërmjet fazave të caktuara, të cilat mund të përdoren për të ndihmuar

organizimin e aktiviteteve, në përgjigje të këtij incidenti. Në terma të përgjithshëm, këto faza shqyrtohen më poshtë, por një shqyrtim më i gjerë i tyre mund të gjendet në vëllimin II të IAMSAR-së dhe manualin SAR të FARSH-së.

Këto faza duhet të interpretohen me fleksibilitet, pasi shumë nga veprimet do të kryhen bashkërisht ose në mënyra të ndryshme për t'u përshtatur me kushtet specifike. Një nga pikat kyçe në një operacion kërkim-shpëtimi është koordinimi ndërinstitucional dhe koordinimi me qendrat fqinje, duke u mbështetur në vlerësimin e incidentit dhe nivelet e operacionit.

Qendra e Koordinimit të Shpëtimit (RCC) ka për detyrë të jetë organizimi rregullator për koordinimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të operacioneve SAR, nëpërmjet zbatimit të procedurave të miratuara edhe detyrimeve të këtij plani.

Terminologjia dhe përkufizimet e përdorura në të gjithë komunitetin e SAR-së të RSH-së do të standardizohen e përputhen, sa të jetë e mundur, gjatë përdorimit të tyre, me konventat përkatëse ndërkombëtare dhe manualin IAMSAR.

### Bashkëpunimi e koordinimi ndërinstitucional

Në rastet kur disa autoritete do të kontribuojnë njëkohësisht në aktivitetin SAR, i rëndësishëm mbetet bashkëpunimi e koordinimi ndërinstitucional i njësisive të përfshira në operacion, me qëllim përdorimin e burimeve të duhura, racionalizimin, prioritetin e përdorimit etj., për një rezultat sa më të efektshëm dhe ky koordinim i përgjithshëm kryhet nga QKKSH-ja.

### Parime udhëzuese për bashkëpunimin ndërinstitucional

Pjesëmarrësit në planin kombëtar, bashkëpunimin ndërinstitucional do ta realizojnë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe urdhrat ekzekutivë (operacionalë), të ardhur nga QKKSH-ja, duke organizuar strukturat dhe mjetet e tyre dhe duke i vënë në dispozicion të operacioneve SAR, të koordinuara nga QKKSH-ja.

Në rast të një situatë fatkeqësie (të dukshme ose që mund të krijohet), kërkimi, shpëtimi apo përpjekjet e tjera do të bazohen në supozimin se një situatë fatkeqësie aktualisht ekziston deri sa ajo të vlerësohet ndryshe. Ndiham do të jepet për të gjithë personat në rrezik, pa marrë parasysh kombësinë e tyre, statusin ose rrethanat.



Bashkëpunim i ngushtë do të zbatohet ndërmjet të gjitha shërbimeve, organizatave, institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, miratuese të këtij plani, të cilat mund të mbështesin shërbimin SAR, në fusha të tilla si: operacionet, planifikimi, trajnimi, stërvitjet, komunikimi etj.

Midis QKKSH-së dhe autoriteteve të lundrimit ajror dhe detar duhet të hartohen marrëveshje bashkëpunuese në trajtimin e emergjencave të mjeteve ajrore e detare, përveç rasteve kur këto autoritete mbajnë vetë të gjitha përgjegjësitë. Me institucionet apo organizmat privatë duhen marrëveshje dypalëshe, ku të përcaktohen edhe tarifat e shërbimit e modalitete të tjera.

### **Autoriteti përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm SAR**

Në përgjigje të ngjarjeve të kërkim-shpëtimit, koordinimi i përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga Koordinatori Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit (SHSHP të FARSH-së) dhe realizohet nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.

QKKSH-ja ka përgjegjësinë kryesore për bashkëpunimin dhe koordinimin institucional të operacioneve SAR brenda SRR-së të deklaruar dhe njohur ndërkombehtarisht.

QKKSH-ja/RCC-ja, gjithashtu, identifikon llojin e mbështetjes që autoritetet e ndryshme pritjet të ofrojnë në një operacion SAR.

Kryetari i QKKSH-së mund t'i delegojë kompetencat e tij një njësie tjetër, vetëm për një pjesë të caktuar të operacionit SAR.

Struktura që është e vetëdijshme se një incident SAR po ndodh ose ka ndodhur, është e detyruar të reagojë, derisa koordinimi i përgjithshëm SAR t'i transferohet një njësie/autoriteti tjetër.

Normalisht, njësia SAR më pranë vendngjarjes do të jetë koordinatori i një incidenti SAR në hapat fillestarë, ndërsa më pas, përgjegjësitë dhe funksionet e koordinimit dhe të menaxhimit të incidentit i caktohen një strukture, e cila përzgjidhet nga Qendra e Koordinim-Shpëtimit (RCC), bazuar në llojin e objektit që kërkon ndihmë nga shërbimi SAR, kushtet dhe vendndodhjen e incidentit SAR.

Në rrethana të caktuara, kur bëhet e qartë, pas konsultimeve ndërmjet njërive të përfshira në incident, mundet që një tjetër njësi SAR të jetë më e përshtatshme për të marrë përgjegjësitë. Në këtë rast, me marrëveshje të përbashkët, autoriteti i kalon këtij të fundit për të marrë përgjegjësitë e

plota të koordinimit. Kushtet që përcaktojnë përzgjedhjen mund të përfshijnë komunikimin më të mirë, afërsinë me zonën e kërkimit, aksesin më të mirë për sigurimin e të dhënave, ekspertizën në fusha të specializuara ose mjetet, personelin dhe infrastrukturën e gatshme në dispozicion.

Për të pasur sukses në një operacion SAR nevojiten konsultimet me të gjitha autoritetet pjesëmarrëse në operacionin qysh në fazat e para të incidentit, me qëllim që ato të ofrojnë këshillat dhe sugjerimet e tyre, pasi ato zotërojnë njohuri e aftësi në fusha të veçanta. Ekspertiza dhe veprimet e tyre duhet të merren në konsideratë nga koordinatori SAR i RCC-së/koordinatori i misionit SAR.

### **3.1 Bashkëpunimi e koordinimi rajonal**

QKKSH-ja, në zbatim të ligjit nr. 10435, datë 23.6.2011, neni 7, pika “e”, ka detyrimin që të ushtrojë kompetencat për të bashkëpunuar dhe koordinuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me qendrat homologe të kërkim-shpëtimit të vendeve fqinje, si dhe të marrin pjesë në veprimet SAR që kryhen në zonat detare, jashtë zonës së përgjegjësisë së RSH-së, me kërkesë të RCC-ve fqinje dhe duke vepruar në bazë të marrëveshjeve reciproke.

QKKSH-ja/RCC-ja (kur është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe) përbën pikën e kontaktit për kërkesën për ndihmë të mjeteve SAR të vendeve të tjera në operacionet e koordinuara nga QKKSH-ja në SRR të RSH-së ose për disponueshmërinë dhe asistencën e forcave të Republikës së Shqipërisë në operacionet e SAR-së që ndodhin në SRR-në fqinje, nën koordinimin e çdo JRCC-je/RCC-je tjetër.

Në rastin e aksidenteve që përfshijnë mjete detare që ndodhin jashtë kufijve të rajonit të përgjegjësisë së Republikës së Shqipërisë, QKKSH-ja bashkëpunon me qendrën kompetente të huaj SAR, e cila ka marrë përsipër përgjegjësinë për të mbledhur ose për të ofruar informacionin përkatës, për mbledhjen dhe sigurimin e informacionit përkatës.

Në operacionet SAR në vendet e tjera, ku shtetasit shqiptarë janë në rrezik apo janë gjetur ose shpëtuar (e njëjta praktikë ndiqet me të shtetasit e huaj në SRR të Shqipërisë), informohet Departamenti i Çështjeve Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, i cili më pas, së bashku me Policinë e Shtetit dhe ambasadat përkatëse, kontrollon prenotimet e udhëtimeve dhe informon



të afërmit e viktimës/ave ose personave të shpëtuar.

QKSSH-ja/RCC-ja koordinon incidentet detare SAR jashtë rajonit të saj të përgjegjësive, në rastet kur është marrësi i parë i sinjaleve të alarmit, deri sa përgjegjësia të merret nga RCC-ja përkatëse për menaxhimin të mëtejshëm të incidentit.

Kur kërkohet një mision SAR jashtë SRR-së së Republikës së Shqipërisë, për të përdorur asetet dhe ekipet kombëtare, QKSSH-ja/RCC-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme, ndërmer veprime mbështetur në marrëveshjet ndërkombëtare ekzistuese, të nënshkuara në kuadër të bashkëpunimit të Republikës e Shqipërisë me vendet e tjera, si dhe në zbatim të ligjit nr. 10435, datë 23.6.201, neni 13, pika 1, 2, 3).

Për incidentet në SRR të RSH-së, QKSSH-ja mund të kërkojë ndihmë nga shtetet fqinje, në kuadër të një marrëveshjeje ekzistuese.

Procedurat rajonale të aktivizimit të operacioneve SAR do të aplikohen nga QKSSH-ja, si një organ i përgjithshëm bashkërendues (për RSH-në) dhe reagues ndërrajonal, kur një incident ka ndodhur ose mund të ndodhë; dhe:

- tejkalon aftësinë e reagimit të mundshëm të vendit tonë për të përballuar këtë incident/aksident;

- mund të përbëjë një kërcënim serioz për shëndetin publik, mirëqenien, mjedisin ose për numër të konsiderueshëm të pronave në rajon.

### **3.2 Menaxhimi i operacioneve SAR**

Koordinatorët e kërkim-shpëtimit, të përcaktuar në këtë plan kombëtar, janë menaxherët e operacioneve SAR. Ata duhet të kuptojnë rëndësinë e përfshirjes së kapaciteteve të tjera, në mbështetje të sistemit të SAR-së dhe të kërkojnë të krijojnë një mjedis ku një përfshirje e tillë të jetë efektive. Natyra gati unike, humanitare dhe jopolitike e SAR-së përbën avantazh në nxitjen e bashkëpunimit dhe të përfshirjes së strukturave shtetërore dhe private për një qëllim të përbashkët.

Lloji i sistemit të komandimit të incidentit, i miratuar për përdorim në Republikën e Shqipërisë, është Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Incidentit (SCI). Procedurat koordinuese të këtij plani do të vazhdojnë të përdoren nën SCI-në.

Për të siguruar sukses, palët e përfshira në plan duhet të angazhohen për ofrimin e shërbimeve më të mira të mundshme të SAR-së me burimet e disponueshme. Ky angazhim pasqyrohet,

gjithashtu, në legjislacionin kombëtar që përcakton agjencitë përgjegjëse për SAR-në.

Agjencitë ose personat që mund të caktohen si koordinatorë të SAR-së (SC) apo që kanë përgjegjësi mbikëqyrëse brenda QKSSH-së, do të përfshihen në menaxhimin dhe në mbështetjen e aspekteve të ndryshme të organizimit dhe menaxhimit SAR. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet organizatave të ndryshme civile dhe ushtarake është thelbësor dhe legjislacioni siguron përdorimin e burimeve ushtarake dhe burimeve të tjera publike për të mbështetur SAR-në.

Organizmat shtetërorë, industria dhe burimet e përgjithshme të popullsisë duhet të mbështesin shërbimin SAR, por drejtuesit SAR duhet të marrin iniciativën për të bërë marrëveshje për ta, në funksion të shërbimit që ata drejtojnë.

### **Organizimi i ekipit**

Ekipi i SAR-së përbëhet nga personel që zotëron aftësi të specializuara në operacionet e kërkimit dhe të shpëtimit, aftësi që përfshijnë komandim-kontrollin e incidentit, kërkimin teknik dhe kërkimin me qen, shpëtimin me litarë, shpëtim në hapësira të kufizuara, shpëtimin në struktura të rrëzuara, shpëtimin në ujëra të shpejta (përmbytje), nxjerrjen e automjeteve dhe MCM-në (menaxhimin e viktimave të shumta).

Njësitë SAR kanë një udhëheqës të paracaktuar që do të drejtojë dhe do të menaxhojë të gjithë operacionin SAR. Ato kryejnë misionin e përgjithshëm të kërkimit dhe të shpëtimit, duke përfshirë: mobilizimin, kërkimin dhe shpëtimin teknik dhe/nxjerrjen (çlirimin). Kjo do të bëhet në fazat e përgjithshme SAR, për shembull, në fazën e alarmit/kërkimit, fazën e shpëtimit, rikuperimit dhe fazën e përfundimit. Kjo ndihmon drejtuesin e ekipit të SAR-së me planifikimin afatshkurtër dhe afatgjatë për operacionet e ekipit SAR.

### **Nivelet e menaxhimit**

Ekzistojnë tri nivele të menaxhimit në sistemin SAR:

- menaxhimi i përgjithshëm i aktivitetit nga autoritetet SAR;

- menaxhimi individual i incidenteve SAR nga koordinatorët e misionit SAR;

- menaxhimi nga koordinatorët në vendngjarje, drejtimi i aktiviteve në një incident SAR, të cilët caktohen nga koordinatori i misionit SAR.

Kjo pjesë detajon, në terma të përgjithshëm, menaxhimin dhe koordinimin e veprimeve të



nevojshme, pas marrjes së vendimit për të zbatuar procedurat për të reaguar në një situatë SAR. Sapo të vendoset për të proceduar për një operacion, planet duhet të vihen në zbatim për fillimin e aktivitetit të kërkimit pa asnjë vonesë, sipas shtojcave dhe lidhjeve përkatëse, të miratuara në këtë plan.

### **Personeli i Qendrës së Koordinim-Shpëtimit**

Personeli i Qendrës së Koordinim-Shpëtimit kryen detyra në përgjegje të ngjarjeve të kërkim-shpëtimit. Përveç kësaj, ato kanë përgjegjësi të mbajnë Qendrën e Koordinim-Shpëtimit në gjendje të gatshme, në mënyrë të vazhdueshme. Stafi i Qendrës së Koordinim-Shpëtimit duhet të përbëhet nga personel i trajnuar dhe me përvojë në fushën e kërkim-shpëtimit. Gjatë kohës kur një aktivitet SAR është në vijim dhe është i shkallës së madhe, stafi i zakonshëm mund të mbështetet nga personel shtesë.

### **Njësitë dhe ekuipazhet SAR**

Me njësi SAR kemi parasysh:

Njësi kërkim-shpëtimi ajrore: ASRU (*Air Search and Rescue Unit*). Njësi kërkim-shpëtimi detare: NSRU (*Naval Search and Rescue Unit*).

Njësi kërkim-shpëtimi tokësore: LSRU (*Land Search and Rescue Unit*) etj.

Njësitë SAR kanë përgjegjësi për krijimin, plotësimin me personel, pajisjen dhe menaxhimin e sistemit SAR, duke përfshirë mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare, krijimin e Qendrës së Koordinim-Shpëtimit, sigurimin ose organizimin e asetëve SAR, zhvillimin e politikave të koordinimit dhe trajnimit SAR etj.

Çdo njësi SAR duhet të sigurohet, që:

operacioni SAR do të fillojë dhe ekzekutohet duke përdorur mjetet më të mundshme të efektshme;

operacionet e shpëtimit të jenë kryer ose shanset për sukses nuk kanë asnjë mundësi të logjikshme.

Njësitë SAR duhet të përqendrohen në burimet që do të kryejnë operacionet, koordinimin e të gjitha kapaciteteve pjesëmarrëse në operacionet SAR, vendosjen e bashkëpunimit dhe koordinimit me njësitë e tjera SAR dhe të sigurohen që bashkëpunimi dhe koordinimi reciprok funksionon.

### **Proceset e planifikimit SAR**

Plani Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit është dokument i vetëm që ka të bëjë me SRR-në, RCC-

në dhe RSC-në dhe funksionet lidhur me shërbimin SAR, për të cilat shteti shqiptar është përgjegjës. Parimet e bashkërendimit operacional që mbulohen në këtë plan, duhet të shërbejnë si bazë për akte ligjore e nënlige më të detajuara dhe hartimin e një manuali SAR apo plane të ndryshme veprimi.

Për çdo nivel të operacioneve SAR duhet të hartohen procese e plane specifike, të përshtatshme dhe për çdo nivel operacional, duhet të zhvillohen plane veprimi operationale. Menaxherët e SAR-së duhet të vlerësojnë periodikisht planet e tyre dhe të përditësojnë planet afatgjata. Sugjerohet një rishikim vjetor i këtyre planeve.

Planet e SAR-së përshkruajnë se si shërbimet SAR do të ofrohen, do të organizohen dhe do të mbështeten. Planet e SAR-së duhet të nënshkruhen nga të gjitha agjencitë qeveritare, të cilat mund të ofrojnë ose mbështesin shërbimet SAR. Këto agjenci duhet të përfaqësohen me personel, ata dhe pikë kontakti, të cilat mbikëqyrin këto plane.

Planet SAR mund të mbështeten nga legjislacioni ose rregulloret, nëse është e nevojshme ose mund të ketë një memorandum mirëkuptimi (MOU) ndërmjet agjencive përkatëse. Ratifikimi i një MOU-je, në nivel ministrie, njihet rëndësinë e SAR-së, duke lejuar një proces më të lehtë të rishikimit të tyre se sa marrëveshjet e nivelit të lartë.

### **Menaxhimi i rrezikut**

Menaxhimi i rrezikut është një proces shumë i rëndësishëm për të përcaktuar prioritetet e punës në të ardhmen dhe për të përmirësuar aftësinë për të përmbushur objektivat e sistemit të kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Përmirësimi i procesit të menaxhimit të rrezikut dhe reduktimi i problemeve të sistemit, duke aplikuar metodologji bashkëkohore të menaxhimit të rrezikut, do të shërbejë për të përmirësuar reagimin ndaj situatave SAR dhe rritjen e performancës së sistemit SAR.

QKKSH-ja dhe menaxherët/koordinatorët SAR e kanë shumë të domosdoshme të bashkëpunojnë me menaxherët e emergjencave civile, në mënyrë që paqartësitë që ekzistojnë në situata potencialisht të rrezikshme mund të minimizohen dhe siguria publike të maksimizohet. QKKSH-ja dhe menaxherët/koordinatorët SAR, ashtu si menaxherët e emergjencës, duhet të operojnë me faza për përgjigjen e tyre ndaj fatkeqësive e aksidenteve detare dhe ajrore.





### 3.3 Koordinimi i Operacioneve SAR

QKKSH-ja/RCC-ja është përgjegjëse për vlerësimin e informacionit, njoftimin e njëjësive të SAR-së, koordinimin dhe kryerjen e operacioneve të SAR-së, në lidhje me incidentet aeronautike ose detare, sipas modelit të urdhrave që jepen në këtë dokument.

Kur RCC-ja e sheh të nevojshme për të kryer një operacion SAR mund të përdorë mjetet dytësore, të vëna në dispozicion për këtë qëllim, nga shërbime të ndryshme, të cilat vihen nën kontrollin operacional të QKKSH-së/RCC-së deri në përfundimin e operacionit.

Gjatë një operacioni SAR, për të shmangur mbivendosjen dhe përplasjet, asnjë agjenci nuk lejohet që të kryejë, në mënyrë të pavarur, operacionet SAR, brenda zonës së veprimit dhe të përgjegjësisë së RCC-së.

Nëse konsiderohet e nevojshme, gjatë një operacioni, RCC-ja mund të kërkojë nga shërbimet e përfshira që të caktojnë një koordinator, pikat e kontaktit, për të qenë të pranishëm në RCC.

Me përfundimin/pezullimin e një misioni SAR, RCC-ja mund të mbështesë operatorët e tjerë ose


individët, të cilët dëshirojnë të vazhdojnë operacionet, nëse kërkohet.

Ekipet vullnetare mund të përdoren në misionet SAR, në varësi të zonës dhe të shtrirjes së incidentit. Në këtë rast, ekipet janë nën kontrollin operacional të RCC-së.

Për secilin nga këto incidente, njësitë parësore dhe dytësore do të veprojnë nën kontrollin dhe koordinimin e QKKSH-së/RCC-së, deri në përfundimin e misionit SAR.

Misionet e SAR-së duhet të kryhen sipas dispozitave të planit operacional aktual, në mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit të veprojnë nën mbulimin ligjor dhe të sigurisë, të kryejnë transmetimin e menjëhershëm të informacionit të parë në RCC për hetimin dhe/ose për konfrontimin e ndonjë emergjence, incidentin nga stacionet e alarmit, i cili është një faktor kyç për mobilizimin e njëjësive të përshtatshme të SAR-së dhe personelit të shërbimeve të përfshira në sistemin SAR, duke respektuar dispozitat dhe udhëzimet e nevojshme për arsye ligjore dhe financiare.

Diagrami i përgjithshëm i ngjarjeve, si dhe analiza e incidenteve të mundshme të SAR-së janë paraqitur më poshtë:



Në rast se njësitë që kanë kapacitete SAR marrin një informacion ose zbulojnë një situatë fatkeqësie, detyra e tyre e parë e punës është të informojnë RCC-në për t'u vendosur nën kontrollin e saj operacional, me qëllim që të arrihet koordinimi optimal dhe efektiv i SAR-së, sidomos kur nevojiten ekspertë të ndryshëm apo përfshirja e më shumë njëjësive SAR nga shërbimet e tjera.

Në rast të evakuimit mjekësor (MEDEVAC), shërbimet SAR nuk do të përdorin kapacitetet SAR, pa miratimin paraprak të QKKSH-së/RCC-së.

Në rast të një zjarri në një anije, i cili nuk mund të shuhet duke përdorur mjetet e veta dhe kur ekziston rreziku i jetëve njerëzore dhe/ose i një

mjeti tjetër detar, RCC kërkon përfshirjen e Autoritetit Portual, duke koordinuar ekzekutimin e një operacioni zjarrfikës dhe shpëtimin e njerëzve nga anija në rrezik. Në këtë rast, zjarri shuhet kryesisht nga anijet e Autoritetit të Porteve, në të cilat duhet të hipë personeli i shërbimit zjarrfikës.

Në rast të një thirrjeje ose informacioni me telefon celular që i referohet rrezikut të humbjes së një jete njerëzore, si pasojë e një incidenti ajror ose detar, RCC-ja (në bashkëpunim me operatorët mobilë/të lëvizshëm) kërkon nga Drejtoria e Policisë së Shtetit të hetojë mundësinë për të gjetur vendndodhjen (koordinatat) e transmetimit të telefonit celular, me qëllim shpëtimin e njerëzve në rrezik.



Komandanti i njësisë SAR ose kreu i ekipit mban përgjegjësinë përfundimtare për ekzekutimin e sigurt të operacionit SAR, duke ruajtur sigurinë e personelit dhe mjeteve të tij/saj. Koordinimi i operacioneve

Çdo agjenci përgjegjëse për operacionet e kërkim-shpëtimit, sipas këtij plani:

- do të mbajë në dispozicion informacionin për statusin dhe disponueshmërinë e mjeteve të saj SAR apo burimeve të tjera, të cilat mund të jenë të nevojshme për operacionet;

- do të mbajnë njëri-tjetrin të informuar për operacionet me interes të përbashkët ose, të cilat mund të përfshijnë përdorimin e mjeteve të një pjesëmarrësi tjetër.

Koordinatorët SAR të një niveli më të ulët mund të bëjnë kërkesa te koordinatorët e nivelit më të lartë, për:

- ndihmë nga RSC-të e tjera dhe ato të vendeve fqinje;

- përgjigje të menjëhershme të kërkesave për ndihmë nga RSC-të e tjera, duke përfshirë ato të shteteve të tjera;

- dhënie lejeje për të hyrë në RSH të mjeteve SAR të shteteve të tjera;

- hartimin e marrëveshjeve për të përshpejtuar hyrjen e mjeteve të huaja SAR.

Koordinatorët e SAR-së të një niveli më të lartë mund të delegojnë kompetencat e tyre te koordinatorët e nivelit më të ulët, për:

- ndihmë nga RSC-të e tjera dhe ato të vendeve fqinje;

- përgjigje të menjëhershme të kërkesave për ndihmë nga RSC-të e tjera, duke përfshirë ato të shteteve të tjera;

- dhënie lejeje për të hyrë në RSH të mjeteve SAR të shteteve të tjera;

- nënshkrimin e marrëveshjeve, për të përshpejtuar hyrjen e mjeteve të huaja SAR-së, sipas rastit.

Koordinatori kombëtar SAR mund të autorizojë QKKSH-në/RCC-në për të menaxhuar hyrjen e njësive të shpëtimit të huaja në territorin e RSH-së, nëse bëhet e nevojshme, sipas marrëveshjeve për këtë qëllim.

Hyrjet e njësive të huaja të shpëtimit në territorin e RSH-së mund të përfshijnë fluturimin ose uljen e avionit SAR dhe akomodim në tokë ose ujë të njësive SAR, siç e diktojnë rrethanat. Hyrjet e njësive SAR mund të jenë për qëllime furnizimi,

mjekësore, transportin dhe shpërndarjen e të mbijetuarve, apo mbështetje të tjera të nevojshme. Ato mund të jenë, gjithashtu, në përgjigje të një kërkesë nga një QKKSH/RCC ndaj një shteti tjetër për ndihmë me këto mjete.

Përdorimi i mjeteve SAR të angazhuara për të mbështetur një mision SAR duhet të jenë të koordinuara dhe, sipas rastit, të drejtuara nga QKKSH-ja/RCC-ja apo RSC-ja, në përputhje me kërkesat e këtij plani.

Koordinimi i skenës mund t'i delegohet çdo njësie të përshatshme që merr pjesë në një incident të veçantë, nën dijeninë e koordinatorit të misionit SAR ose komandantit të caktuar të incidentit. Nëse është krijuar një RSC nga ndonjë agjenci, ajo duhet të veprojë nën mbikëqyrjen e një QKKSH/RCC dhe të jetë përgjegjëse për detyra të caktuara apo për pjesë të SRR-së të RCC-së, siç përcaktohet nga agjencia në fjalë.

Koordinatorët SAR do të organizojnë vlerësimin për pranimin e alarmeve të fatkeqësisë me origjinë nga brenda SRR, për të cilat ata janë përgjegjëse dhe të sigurojë që çdo RSC mund të komunikojë me personat në vështirësi, me mjetet SAR dhe me RSC e tjera.

### 3.4 Gatishmëria e njësive SAR

Gatishmëria e njësive SAR të Forcave të Armatosura përcaktohet nga “Rregullorja e Regjimit të Gatishmërisë Luftarake të Ngritjes në Kushtim të FARSH-së”, miratuar nga Presidenti i Republikës, me dekret nr. 10628, datë 15.12.2017. Në këtë dokument janë përcaktuar qartë edhe kohët e reagimit të anijeve dhe helikopterëve, në rast operacioni SAR.

#### Gatishmëria e aseteve/personelit

Të gjitha njësitë parësore SAR, që janë në gatishmëri për mision SAR, duhet të jenë në gjendje të lundrojnë/fluturojnë brenda 30’ nga koha që QKKSH-ja/RCC-ja jep urdhrin përkatës. Kjo sipas manualit IAMSAR, të miratuar bashkërisht nga IMO-ja dhe ICAO-ja.

Për të mbuluar detyrimet ndërkombëtare të Republikës Shqipërisë, në lidhje me shpëtimin e personave, jetët e të cilëve janë në rrezik si pasojë e një aksidenti ajror dhe detar, janë përcaktuar normat e gatishmërisë si më poshtë:

Një RV (*Rescue Vessel*) në sektorët e miratuar ALPHA, BRAVO dhe CHARLIE mbahet gatishmëria 24/7 për të qenë e dislokueshme brenda 30’ pas marrjes së urdhrit/udhëzimit



përkatës. Detyra e tyre fillon në orën 07:00 dhe përfundon në orën 07:00 të orës lokale të ditës tjetër.

Në rast të vështirësive të shkaktuara nga arsye administrative ose operative, detyrat dhe gjendja e gatishmërisë së aseteve mund të ndryshohen nga këndvështrimi/gjykimi i komandës, pas informimit dhe miratimit nga QKKSH-ja/RCC-ja, Tiranë.

#### **Gatishmëria e mjeteve detare**

Një RB (*Rescue boat*) në të gjitha stacionet detare, të gatshme për reagim të menjëhershëm (5' maksimumi) pas marrjes së urdhrimit/udhëzimit përkatës, gjatë tërë ditës.

Të gjitha strukturat që ofrojnë mjete detare duhet të mbajnë koordinimin dhe bashkëpunimin e duhur, si dhe vendosjen e orareve të nevojshme të detyrës për personelin dhe mjetet e tyre, në një mënyrë që të mbulojnë kërkesën kryesore të gatishmërisë 24-orëshe dhe të jenë në gjendje të nisen për 30'.

#### **Gatishmëria e mjeteve ajrore**

Të gjitha mjetet ajrore të jenë në gatishmëri për ngritje në ajër brenda 30', gjatë ditës (nga 07:00 deri në 07:00 të ditës tjetër), menjëherë pas marrjes së urdhrimit nga QKKSH-ja/RCC-ja, Tiranë.

Mjetet fluturuese duhet të jenë në pikën fundore më të largët të rajonit të kërkimit dhe të shpëtimit të Republikës së Shqipërisë, brenda 30' nga koha e ngritjes. Gatishmëria e deklaruar për mjetet SAR mund të ndryshohet vetëm kur lindin arsye serioze dhe gjithmonë pas njoftimit të QKKSH-së/RCC-së dhe pas marrjes së miratimit.

Nga strukturat e mjeteve ajrore kërkohet të sigurojnë bashkëpunim në kohë dhe efektiv mes tyre, si dhe të caktojnë personelin e ekuipazheve të helikopterëve dhe të mirëmbajtjes së tyre, në mënyrë që programi i gatishmërisë të mos ndikohet.

#### **3.5 Koordinatorët SAR**

Shërbimi i kërkim-shpëtimit organizohet në nivel kombëtar.

1. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura caktohet Koordinatori Kombëtar i kërkimit dhe i shpëtimit (KKKSH) në Republikën e Shqipërisë. KKKSH-ja drejton operacionet e kërkim-shpëtimit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.

2. Forca Ajrore e Republikës së Shqipërisë/Komandanti i Forcës Ajrore caktohet Koordinator Kombëtar Ajror i Kërkimit e Shpëtimit

(KKAKSH). KKAKSH-ja drejton operacionet nëpërmjet Qendrës Kombëtare Ajrore të Kërkim-Shpëtimit.

3. Forca Detare/roja bregdetare/komandanti i Forcës Detare caktohet Koordinator Kombëtar Detar i Kërkimit e Shpëtimit (KKDKSH). KKDKSH-ja drejton operacionet nëpërmjet Qendrës Kombëtare Detare të Kërkim-Shpëtimit.

4. Forca tokësore/komandanti i Forcës Tokësore caktohet Koordinator Kombëtar Tokësor i Kërkimit e Shpëtimit (KKTKSH). KKTKSH-ja drejton operacionet nëpërmjet Qendrës Kombëtare Tokësore të Kërkim-Shpëtimit.

Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit është person juridik publik, në varësi të ministrit të Mbrojtjes dhe ka si qëllim planëzimin, organizimin, koordinimin dhe kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.

Organizimi dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, bashkëpunimi me institucionet dhe strukturat e tjera shtetërore, si dhe mënyra dhe procedurat e operimit të sistemit, duke përfshirë edhe linjën e komandimit e kontrollit me koordinatorët kombëtarë të ajrit e detit për ofrimin e shërbimit të kërkimit e shpëtimit, përcaktohen në ligjin nr. 10435, datë 23.6.2011, "Për shërbimin e Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë".

Koordinimi dhe menaxhimi i përgjithshëm i operacioneve të kërkim-shpëtimit kryhet nëpërmjet koordinatorëve të caktuar të kërkim-shpëtimit, mbështetur në bazën ligjore dhe aktet nënligjore të shërbimit SAR.

Në rastet e operacioneve të kërkim-shpëtimit mund të krijohet dhe një strukturë/postë e menaxhimit të incidentit (PMI). Menaxheri i incidentit caktohet nga koordinatori kombëtar/kryetari i QKKSH-së, i cili merr kontrollin dhe organizon komandën (sipas strukturës së miratuar) për të koordinuar dhe menaxhuar incidentin, i cili është dhe pika e kontaktit në vendngjarje e QKKSH-së. Ky menaxher mund të jetë një nga koordinatorët SAR më të mirë dhe me më shumë përvojë të QKKSH-së.



### 3.6 Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorëve SAR

#### Nivelet e koordinatorëve

Në sistemin e kërkim-shpëtimit, koordinatorët organizohen në tri nivele:

- koordinatorët SAR (*SC-SAR Coordinator*)
- koordinatorët e misionit SAR (*SMC-SAR Mission Coordinator*)
- koordinatorët në vendngjarje (*On Scene Coordinator*)

#### Koordinatorët SAR (*SC-SAR Coordinator*)

SC-të kanë përgjegjësinë e përgjithshme për krijimin, pajisjen dhe menaxhimin e sistemit SAR,, duke përfshirë dhënien e ndihmës së duhur ligjore dhe financimit, krijimin e RCC-ve dhe nënqendrave të shpëtimit (RSC), sigurimin ose rregullimin e objekteve SAR dhe zhvillimin e politikave të SAR.

SC-të janë menaxherët e nivelit të lartë të SAR-së. Më shumë informacion mbi përgjegjësitë e menaxhimit të SAR-së mund të gjenden në Manualin e Kërkim-Shpëtimit.

#### Koordinator i misionit SAR (SMC)

Operacionet SAR normalisht kryhen nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e një SMC-je, i cili zakonisht është mbikëqyrës i ekipit të RCC-së ose RSC-së.

Në situata me incidente të shumëfishta, ky koordinator mund të jetë SMC për të gjitha incidentet ose për disa nga ato incidente. Kompetencat e SMC-së mund të delegohen në një anëtar tjetër të kualifikuar të ekipit.

SMC-ja duhet, në të gjitha rastet, të mbështetet nga anëtarët e ekipit të vëzhguesve të RCC-së për të ndërmarrë funksione në procesin e bashkërendimit siç janë komunikimet dhe planifikimi i kërkimit.

Për rastet komplekse ose ato me kohëzgjatje të gjatë, ekipi ndihmës, si dhe SMC-ja duhet të zëvendësohen në intervale të rregullta. SMC-ja duhet të jetë në gjendje që, në mënyrë kompetente, të mbledhë informacion rreth emergjencave, të transformojë informacionet e incidenteve të emergjencës në plane të sakta dhe të realizueshme dhe të dërgojë e koordinojë kapacitetet, të cilat do të kryejnë misionet e SAR-së.

SMC-ja është përgjegjës për një operacion të SAR-së derisa të realizohet shpëtimi ose derisa të bëhet e qartë se përpjekjet e mëtejshme do të ishin

pa dobi ose derisa përgjegjësia të merret nga një tjetër RCC.

SMC-ja duhet të jetë në gjendje të përdorë kapacitetet e disponueshme dhe të kërkojë ato shtesë gjatë operacionit.

SMC -ja planifikon kërkimin dhe bashkërendon operacionin SAR-së në vendngjarje.

SMC-ja duhet të jetë e trajnuar mirë në të gjitha proceset e SAR-së dhe të jetë plotësisht e njohur me planet SAR në fuqi.

SMC-ja duhet të mbledhë informacionin e duhur rreth situatave të vështira, të zhvillojë plane vepruese të sakta e të realizueshme, si dhe të dërgojë e të bashkërendojë njësitë që do të kryejnë misione SAR. Planet e veprimit të mbajtura nga RCC japin informacion për të ndihmuar në këto përpjekje.

Udhëzimet dhe detyrat e SMC përfshijnë:

- marrjen dhe vlerësimin e të gjitha të dhënave për emergjencën/situatën;
- përcaktimin e llojit të pajisjeve emergjente të përdorura nga të zhdukurit ose mjetet në gjendje të keqe;
- informimin për kushtet mbizotëruese mjedisore;
- nëse është e nevojshme, konstatimin e vendndodhjes dhe të lëvizjes së anijeve në zonat e mundshme të kërkimit për shpëtim, vëzhgim (vizual dhe elektronik) dhe/ose të radios në frekuenca të përshtatshme për të lehtësuar komunikimin me objektet e SAR-së;
- harta të orës për të kontrolluar dhe vendosur mbi metodat dhe mjetet që do të përdoren;
- zhvillimin e planit të veprimit të kërkimit (dhe planin e veprimit të shpëtimit, sipas rastit), alokimin e zonave të kërkimit, caktimin e OSC-së, dërgimin e objekteve të SAR-së dhe përcaktimin e frekuencave të komunikimit në vend;
- informimin e shefit të RCC-së me planin e veprimit të kërkimit;
- bashkërendimin e operacionit me RCC-në fqinje, kur është e përshtatshme;
- vlerësimin e të gjitha raporteve nga çdo burim dhe modifikimin e planit të veprimit të kërkimit, nëse është e nevojshme;
- të sigurohet për furnizimin e mjeteve të shpëtimit për kërkim të zgjatur të koordinojë akomodimin e personelit të SAR-së;
- koordinimin e shpërndarjes së furnizimeve për të mbijetuarit;



- ruajtjen e rendit kronologjik të një evidence të saktë dhe të përditësuar në një hartë, sipas nevojës, të të gjitha procedurave;

- nxjerrjen e raporteve të progresit;

- pezullimin e kërkimit dhe kthimin në venddislokim të mjeteve SAR nga ana e shefit të RCC-së, kur asistenca nuk kërkohet më;

- njoftimin e autoriteteve për hetimin e aksidenteve;

- njoftimin e policisë dhe i autoriteteve të tjera qeveritare, kur është e nevojshme;

- nëse është e aplikueshme, njoftimin (AIP) e regjistrat shtetëror të mjetit fluturues ose anijes, në përputhje me marrëveshjet e përcaktuara; dhe

- përgatitjen e një raporti përfundimtar mbi rezultatet e operacionit.

#### **Koordinatori në vendin e ngjarjes (OSC)**

Kur dy ose më shumë njësi SAR punojnë së bashku në të njëjtin mision, SMC-ja emëron një koordinator në vendin e ngjarjes (OSC) për të bashkërenduar aktivitetet e të gjitha njësive pjesëmarrëse, i cili mund të jetë personi përgjegjës për një njësi kërkimi dhe shpëtimi (SRU), anije ose aeroplanë që marrin pjesë në një kërkim ose dikush tjetër në një strukturë aty pranë.

OSC-ja duhet të jetë personi më i aftë në dispozicion, duke marrë parasysh trajnimin e SAR-së, aftësitë e komunikimit dhe kohëzgjatjen që njësia e OSC-së që është në bord, mund të qëndrojë në zonën e kërkimit. Ndryshimet e shpeshta në OSC duhet të shmangen.

Personi përgjegjës i një strukture SAR, me të mbërritur në vendin e ngjarjes, normalisht do të marrë funksionin e OSC-së derisa SMC-ja të marrë drejtimin. Në këtë rast, OSC-ja duhet të marrë përsipër edhe detyrat e SMC-së dhe të planifikojë kërkimin, nëse bëhet i vetëdijshëm, për situatën e shqetësimit dhe kur komunikimi nuk mund të kryhet me RCC-në.

Detyrat që SMC-ja mund t'i caktojë OSC-së, në varësi të nevojave dhe kualifikimeve, janë:

- të bëjë bashkërendimin operacional të të gjitha njësive SAR në skenë;

- të njohë planin e veprimit të kërkimit nga SMC-ja;

- të modifikojë planin e veprimit të kërkimit, në varësi të kushteve mbizotëruese mjedisore dhe të njoftojë SMC-në për çdo ndryshim në plan (të bëjë ndryshime në konsultim me SMC-në, kur është e mundur);

- të sigurojë informacion të saktë për mjetet e tjera të SAR-së;

- të zbatojë planin e veprimit të kërkimit;

- të monitorojë performancën e njësive të tjera pjesëmarrëse në kërkim;

- të bashkërendojë për çështjet e sigurisë së fluturimit për mjetet ajrore SAR;

- të zhvillojë dhe zbatojë planin e veprimit të shpëtimit (kur është e nevojshme); dhe

- të bëjë raporte të konsoliduara (SITREPs) për SMC-në.

#### **3.7 Udhëheqja e operacioneve**

Në zhvillimin e një sistemi SAR, një lider i tillë mund të jetë thelbësor për t'u fokusuar në problemin dhe nevojën për bashkëpunim.

Plani kombëtar bazohet në procedurat ndërkombëtare dhe kombëtare dhe ky plan do të do të ekzekutohet në përputhje me konceptet operacionale dhe parimet e përcaktuara.

Plani, gjithashtu, është hartuar në përputhje me Politikën Kombëtare për Menaxhimin dhe Koordinimin e një Emergjence SAR.

Koordinatori kombëtar SAR do të mbështetet në këto operacione nga pjesëmarrësit në këtë plan, duke vendosur në dispozicion kapacitetet e deklaruara dhe që do të angazhohen, në bazë të procedurave operacionale, të përcaktuara po në këtë plan.

#### **3.8 Ekzekutimi i operacioneve SAR**

Kur mjetet e kërkimit të jenë përcaktuar (SMC ose OSC, ose pilot në komandën e mjetit të SAR-së, sipas rastit), duhet të vendosë për mënyrën e shpëtimit që duhet ndjekur dhe mjetet që duhet të përdoren. Për këtë, merren parasysh faktorët e mëposhtëm:

- veprimet e ndërmarra nga mjetet vëzhguese dhe veprimet SAR që mund të merren nga mjetet e tjera në vendngjarje;

- vendndodhja dhe disponimi i të mbijetuarve;

- gjendja e të mbijetuarve dhe këshillat mjekësore;

- numri i personave që raportohen të jenë në bordin e anijes ku janë imbarkuar dhe numri i përgjithshëm që është gjetur;

- kushtet mjedisore, të vëzhguara dhe të parashikuara;

- mjetet SAR në dispozicion dhe gjendja e tyre e gatishmërisë (për të zvogëluar vonesat);



- mjetet SAR që ka të ngjarë të përdoren, duhet të jenë në gatishmëri derisa kërkimi të jetë në proces;

- efekti i kushteve atmosferike në operacionet e SAR-së;

- koha e ditës (drita e mbetur) dhe faktorë të tjerë që lidhen me dukshmërinë; dhe

- çdo rrezik ndaj personelit të SAR-së, siç janë materialet e rrezikshme.

### Nivelet e operacionit

Shërbimi SAR në Republikën e Shqipërisë është i ndarë në tre/i sektorë/nivele. Çdo sektor ka strukturat dhe njësitë përgjegjëse SAR, si dhe kapacitetet e deklaruara në këtë plan kombëtar.

#### Niveli 1

Një situatë konsiderohet niveli 1 në një situatë emergjence SAR, kur një ose më shumë ekipe SAR nga strukturat dhe njësitë përgjegjëse SAR të sektorit përkatës dërgohen në vendngjarje dhe situata mund të menaxhohet me kapacitetet e vetë sektorit.

Një incident i nivelit të parë për SAR-në do të përfshijë burimet e një sektori deri në kapacitetin e plotë të tij.

Kapaciteti i plotë operacional i një sektori është si vijon:

- ndihma për dy (2) persona të lënduar në mënyrë kritike (persona me dëmtime për kërcënime për jetën); ose

- ndihma për katër (4) persona me lëndime mesatare (persona me dëmtime jokërcënuese për jetën, por serioze); ose

- ndihma për tetë (8) persona me lëndime të lehta (persona me dëmtime joserioze).

*Shënim. Bazuar në situatën (burimet, personelin e trajnuar, kushtet dhe gjendjen), këto standarde mund të ndryshohen.*

#### Niveli 2

Kur një incident apo ngjarje kërkon që ekipet SAR nga një sektor fqinj të ndihmojnë operacionet SAR, atëherë ngjarja kalon në nivelin 2. Pra, kur burimet SAR dhe kapaciteti i një sektori janë shteruar dhe ndihma shtesë kërkohet nga sektori fqinj atëherë incidenti kalon në nivelin 2.

#### Niveli 3

Një nivel 3 konsiderohet, kur të gjitha burimet kombëtare për SAR janë shteruar dhe kërkohet asistencë rajonale ose ndërkombëtare.

Ky nivel kërkon regjistrim të plotë të të gjitha burimeve kombëtare dhe mundësive të përgjigjes

dhe mungesat plotësohen nga burimet rajonale dhe/ose ndërkombëtare.

### Fazat e operacioneve SAR

Suksesi i një misioni SAR varet shpesh nga shpejtësia me të cilën operacioni është planifikuar dhe kryhet.

Marrja e shpejtë e të gjitha informacioneve në dispozicion nga RCC-ja është e nevojshme për vlerësim të plotë të situatës, vendim të menjëhershëm për mënyrën më të mirë të veprimit dhe një aktivizim në kohë të objekteve SAR.

Incidentet e SAR-së zakonisht kalojnë nëpër faza të përcaktuara, të cilat mund të përdoren për të ndihmuar në organizimin e aktiviteteve të reagimit. Këto faza duhet të interpretohen me fleksibilitet, pasi shumë nga veprimet e përshkruara mund të kryhen njëkohësisht ose në një mënyrë tjetër për t'iu përshtatur rrethanave specifike.

#### Faza e vlerësimit

RCC-ja nuk mund t'i përgjigjet një incidenti derisa të bëhet e vetëdijshme se njerëzit ose mjeti kanë nevojë për ndihmë. Autoritetet e SAR-së duhet të sigurohen që njoftimi se një avion është rrëzuar ose se një avion, anije, mjet ose persona të tjerë janë të vonuar ose ndodhen në gjendje të jashtëzakonshme, është i saktë.

Pasi RCC-ja të marrë një raport fillestar për personat ose mjetet në vështirësi, disa veprime të menjëhershme shpesh janë të përshtatshme në pritje të marrjes dhe vlerësimit të informacionit më të plotë. RCC-ja zakonisht ka në planet e saj të operimit një listë kontrolli të hapave për të përmbushur për çdo lloj incidenti, me të cilin RCC-ja pret që të mund të përfshihet.

Pas vlerësimit të të gjitha informacioneve në dispozicion dhe duke marrë parasysh shkallën e emergjencës, koordinatori SAR në detyrë/SMC duhet të deklarojë fazën e duhur të emergjencës dhe menjëherë të informojë të gjitha qendrat, personelin dhe pajisjet përkatëse.

#### Për incidentet ajrore SAR

Njësitë ATS marrin informacion mbi shumicën e fluturimeve komerciale të avionëve dhe janë periodikisht në kontakt me avionin. Prandaj një emergjencë e avionëve ka të ngjarë të vijë në vëmendjen e ATS-së së parë.

RCC-ja zakonisht do të njoftohet nga një njësi ATS, kur një avion është ose mund të jetë në gjendje të jashtëzakonshme. Megjithatë, njoftimi për një emergjencë të avionëve të aviacionit të



përgjithshëm shpesh mund të vijë nga një aeroport vendës, një individ i cili e raporton atë të vonuar apo dëshmitarë, duke parë një avion në vështirësi ose përplasje. Kur natyra e emergjencës është e tillë që pajisjet lokale të shpëtimit mund të përballojnë emergjencën, p.sh., kur një incident ndodh në ose pranë një aerodromi, RCC-ja nuk do të jetë gjithmonë e informuar.

### **Për incidentet detare SAR**

Në disa zona, një radiostacion bregdetar (CRS) siguron lidhjen kryesore për komunikimet anije-breg dhe breg-anije dhe në këtë situatë, mund të ndodhë që CRS-ja zakonisht merr informacionin e parë që një anije apo mjete të tjera në ujë janë në fatkeqësi.

CRS-ja, ashtu siç kërkohet nga rregulloret ndërkombëtare, duhet ta transmetojë këtë informacion tek autoritetet e SAR-së.

RCC-ja shpesh merr njoftimin e parë se një anije ose mjete të tjera ndodhen në vështirësi nga CRS-ja me të cilin është lidhur ose nëpërmjet mjeteve të veta të komunikimit. RCC-ja ka aftësi të komunikimit me radio ose merr sinjale satelitore që u mundëson atyre të njoftohen drejtpërsëdrejti.

RCC-ja bën një regjistrim të plotë të informacionit që merr dhe vlerësimin e fazave, në të cilën ndodhet incidenti. Veçanërisht, për mjetet e vonuara, vlerësimi është një funksion i rëndësishëm që SMC-ja kryen gjatë një incidenti SAR.

Të gjitha raportet e pranuar para dhe gjatë një operacioni SAR duhet të vlerësohen me kujdes për të përcaktuar vlefshmërinë e tyre, urgjencën për veprim dhe shkallën e përgjigjes së kërkuar.

Nëse vlerësimi i raporteve mund të jetë i vështirë dhe kërkon kohë, duhet të merren vendime dhe të ndërmerren veprime, sa më shpejt që të jetë e mundur. Nëse informatat e pasigurta nuk mund të konfirmohen, SMC-ja duhet të veprojë edhe me një mesazh të dyshimtë, bazuar në përvojën që ka dhe jo të presë për verifikim.

### **Klasifikimi i incidenteve SAR**

Kemi tre faza emergjente për klasifikimin e incidenteve dhe për të ndihmuar në përcaktimin e veprimeve që duhet të ndërmerren për çdo incident.

Këto janë:

- faza e pasigurisë;
- faza e alarmit;
- faza e rrezikut.

### **Veprimet e reagimit**

Faza e operimit të SAR-së përfshin të gjitha aktivitetet, si: kërkimin e personave ose mjeteve në vështirësi, dhënien e ndihmës dhe dërgimin e tyre në një vend siguritë.

Në këtë fazë, SMC-ja merr një rol monitorues dhe udhëzues, duke siguruar që plani i kërkimit të merret, kuptohet dhe ndiqet nga njësitë SAR. Ata, gjithashtu, mund të vazhdojnë të mbledhin ose të marrin më shumë informacion dhe ta vlerësojnë këtë për të parë nëse ai ndikon apo ndryshon ndonjë nga planet e bëra më parë.

RCC-ja mund të jetë, gjithashtu, pikë qendrore për komunikim me njësitë e tjera të aktivizuara në operacion. Staf i RCC-së zakonisht do të kalojë pjesën më të madhe të kësaj faze, duke planifikuar kërkimet e mëvonshme, bazuar në informacionin e përditësuar dhe supozimin se kërkimi aktual do të jetë i pasuksesshëm.

Sapo të fillojë operacioni, drejtuesi i njësisë SAR në operacion duhet t'i sigurojë raportin e situatës së incidentit koordinatorit SAR në detyrë të QKKSH-së/RCC-së, me qëllim informimin e koordinatorit kombëtar, për t'i mundësuar atij vendimmarrjen. Raporti i situatës duhet të paraqesë qartë nivelin e incidentit dhe të këshillojë nëse ekziston mundësia që incidenti të ngrihet në nivele më të larta.

Me mbërritjen në vendin e incidentit, një menaxher i incidentit merr kontrollin dhe organizon komandën (sipas strukturës së miratuar) për të koordinuar dhe menaxhuar incidentin.

Menaxheri i incidentit raporton te QKKSH/RCC (nëse aktivizohet) dhe këshillon për hapësirën e incidentit dhe nevojën për burime shtesë. QKKSH-ja siguron mbështetjen e kërkuar për operacionet SAR.

Kur burimet nuk janë nën kontrollin direkt të Strukturës (Posta) së Menaxhimit të Incidentit (PMI), QKKSH-së/RCC-së i kërkohet që të koordinojë dhe të sigurojë burimet nga agjencitë e tjera mbështetëse.

Menaxherët e incidenteve mbajnë komandën dhe kontrollin në vendngjarje dhe raportojnë drejtpërdrejt në QKKSH/RCC. Pika e kontaktit në vendngjarje e QKKSH-së është menaxheri i incidentit/SMC.

### **Përcaktimi i RSC-së përgjegjës për fillimin e veprimit SAR**

Sipas rastit, RCC-ja do të marrë një sinjal alarmi, njëkohësisht dhe përgjegjësinë për operacionet



SAR për atë incident. Megjithatë, mund të ketë raste kur RCC-ja nuk është e para për të marrë alarmin e rrezikut dhe nuk do të jetë përgjegjëse për fillimin e operacionit SAR, siç është rasti kur sinjali i përket një RSC-je. Kur RSC-ja pranon informacione që tregojnë një sinjal alarmi jashtë SRS-së, ajo duhet menjëherë të njoftojë RCC dhe të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të bashkërenduar përgjigjen derisa RCC-ja ose RSC-ja përkatëse të kenë marrë përgjegjësinë.

### **Transferimi i përgjegjësive nga RCC-ja te RSC-ja**

Kur transferohet bashkërendimi i një operacioni SAR në një RSC, transferimi duhet të dokumentohet në regjistrat e punës së RCC-së dhe RSC-së.

QKKSJ-ja/RCC-ja, si organizatore, mund të ftojë një nga RSC-ja që të marrin përsipër përgjegjësinë ose një nga RSC-të të mund të ofrohet për të marrë përsipër përgjegjësinë. Përgjegjësia ruhet nga RCC-ja derisa RSC-ja marrëse pranon formalisht përgjegjësinë e operacionit SAR.

Procedurat për të transferuar përgjegjësinë duhet të përfshijnë:

- diskutimin personal midis RCC-së dhe SRC-ve në fjalë;

- shkëmbimin e të dhënave duke përdorur formularin SITREP e duke përfshirë detajet e plota të veprimeve të ndërmarra.

### **3.9 Pezullimi/përfundimi i operacioneve SAR**

#### **E drejta për pezullimin e operacioneve SAR**

Pasi zbatohen të gjitha procedurat në fazën e ekzekutimit të operacioneve, vendimi për pezullimin dhe ndërprerjen e një operacioni SAR i takon kryetarit të QKKSJ-së, pasi është këshilluar me SMC-në/OSC-nës.

Përveç kësaj, një operacion SAR mund të pezullohet/të përfundojë me vendimin e ministrit të Mbrojtjes, pas një rekomandimi nga kryetari i QKKSJ, me kusht që shkaqet e ndërprerjes të jenë të arsyetuara.

#### **Përfundimi i operacionit**

Operacionet SAR hyjnë në fazën e përfundimit, kur:

- nga informacioni i grumbulluar, rezulton se mjeti dhe personat e tjerë, të përfshirë në incidentin SAR, nuk janë më subjekt i gjendjes fatkeqësisë;

- avionët, anijet dhe personat janë gjetur dhe të mbijetuarit janë shpëtuar nga njësitë dhe kapacitetet SAR kanë kryer operacionin;

- gjatë fazës së fatkeqësisë, koordinatori i misionit SAR përcakton se kërkimi i mëtejshëm nuk do të jetë i vlefshëm, sepse nuk ekziston asnjë arsye logjike që përpjekjet shpesh mund të rrisin probabilitetin për gjetjen e suksesshme të ndonjë të mbijetuarit nga incidenti i fatkeqësisë.

Kur operacionet SAR janë mbyllur, duhet të njoftohen menjëherë të gjitha autoritetet, infrastruktura, kapacitetet dhe shërbimet që kanë qenë aktivizuar.

Në rast se reagimi fillestar për gjetjen e mjetit ose të të mbijetuarve dështon, lind nevoja për planifikimin dhe ekzekutimin e një kërkimi më të zgjeruar.

Kur operacionet SAR përfundojnë, të gjitha autoritetet, mjetet dhe shërbimet që janë aktivizuar duhet të njoftohen menjëherë dhe të kalojnë në gjendje gatishmërie të zakonshme.

### **4. KOMUNIKIMI**

Salla e Operacioneve të QKKSJ-së ka strukturën dhe aftësitë e nevojshme të komunikimit, me qëllim që të mbulojë nevojat operacionale të mëposhtme, të cilat janë të një rëndësie të veçantë për përmbushjen e misionit të qendrës:

- aftësia për të marrë njoftime direkt;

- aftësia për të marrë informacionin e shqetësimeve nga sistemet e alarmit;

- aftësia për të njoftuar menjëherë strukturat dhe personelin e SAR-së;

- aftësia për të komunikuar me mjetet e SAR-së në vendin e aksidentit;

- aftësia për të hetuar alarme ose informacione për fatkeqësi.

Të gjitha rrjetet e disponueshme - qarqet - sistemet e komunikimit, frekuencat e përdorura gjatë një operacioni SAR, të gjitha frekuencat SAR të përdorura ndërkombëtarisht dhe frekuencat dëgjimore 24-orëshe nga RCC-ja, si dhe shenjat e thirrjes që përdoren në ushtrimet në operacionet e SAR-së janë paraqitur në shtojcën D.

### **5. MBËSHTEJTA LOGJISTIKE E OPERACIONEVE SAR**

Çdo agjenci e përfshirë do të ketë përgjegjësinë për të siguruar që mjetet dhe personeli i saj të jenë në gatishmëri në përputhje me këtë plan, me shpenzimet e tyre. Asnjë çështje e dëmshpërblimit





financiar nuk duhet të vonojë përgjigjen për të ofruar asistencë në çdo lloj rrethane. Njësitë e SAR-së do të sigurojnë, nëpërmjet administratave të tyre dhe në bashkëpunim me QKKSJH-në, lejet diplomatike dhe përballimin e kostove, në rast se mjeteve të SAR-së u kërkohet të udhëtojnë në një shtet të huaj për një operacion SAR.

Ministria e Brendshme dhe ministria përgjegjëse për mjedisin, pyjet dhe administrimin e ujërave parashikojnë, në buxhetet e tyre, përballimin e shpenzimeve për shërbimin e kërkim-shpëtimit, sipas kompetencave përkatëse.

Përcaktimi i fondeve bëhet sipas nenit 34, të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.

Ministria e Mbrojtjes mbulon, nëse është e nevojshme, shpenzimet operative të njësisë të SAR-së dhe të kompanive të shteteve të huaja që marrin pjesë në operacionet e SAR-së ose stërvitjet në territorin e RSH-së, me kërkesë të QKKSJH-së (si shpenzimet e karburantit, hotelin etj.).

Në muajin shkurt të çdo viti, shërbimet që sigurojnë kapacitetet e SAR-së duhet të dorëzojnë në ministrinë përkatëse nevojat e nevojshme për SAR-në për t’u përfshirë në një artikull të veçantë të buxhetit të ministrisë për vitin pasardhës. Artikulli që përfshin shërbimin SAR të përdoret për të mbuluar shpenzimet e gatishmërisë, përmirësimit dhe kryerjen e operacioneve të SAR-së, të ekzekutuara nga mjetet SAR për çdo shërbim, të ofruar sipas ligjit.

QKKSJH-ja do të sigurohet që personat e shpëtuar gjatë një operacioni të SAR-së dhe që kërkojnë kujdes mjekësor, të transferohen në spitalet shtetërore ose në klinikat e spitalet private, nëse nuk ka një organ shtetëror përkatës në rajon, pas koordinimit me Ministrinë e Shëndetësisë.

## 6. STËRVITJA DHE TRAJNIMI - NDËRTIMI I PROFESIONALIZMIT

Një program i mirë trajnimi prodhon profesionistë të vërtetë, personel i cili mund të veprojë si duhet që herën e parë në një situatë.

Qëllimi i trajnimit është përmbushja e objektivave të sistemit SAR, duke zhvilluar specialistë të SAR-së.

Për të menaxhuar dhe trajtuar situata tipike SAR, nevojitet përvojë dhe gjykim i konsiderueshëm, aftësi të nevojshme, të cilat kërkojnë kohë të konsiderueshme për t’u zotëruar. Trajnimi mund të ketë kosto të lartë. Një trajnim i

dobët ka kosto edhe më të lartë dhe mund të sjellë një rezultat të dobët operacional, i cili mund të rezultojë në humbjen e jetës së personelit të SAR-së, jetës së atyre që janë në rrezik dhe humbjes së objekteve apo të materialeve me vlerë. Cilësia e performancës do të përputhet me cilësinë e trajnimit.

Përpjekjet për të siguruar profesionalizëm mund të shtrihen madje edhe në procesin e zhvillimit të karrierës para se personeli të emërohet në detyrat e SAR-së dhe duke siguruar qëndrimin në detyrat e SAR-së të mjaftueshëm për të zhvilluar ekspertizën dhe duke përfituar nga përvoja SAR në detyrat e mëvonshme.

### Trajnimi

Trajnimi është kritik për performancën dhe sigurinë. Sistemi i SAR-së duhet të shpëtojë personat në vështirësi, sa herë që mundet dhe, gjithashtu, të përdorë trajnimin për të zvogëluar rreziqet ndaj personelit dhe pajisjeve të vlefshme të tij. Personeli trajnues në bërjen e vlerësimeve të sakta të rrezikut, do të ndihmojë për të siguruar që këta profesionistë të trajnuar dhe pajisje të vlefshme të mbeten në dispozicion për operacionet e ardhshme.

### Kualifikimi

Qëllimi i kualifikimit është të vlerësojë aftësinë e individit për të kryer detyra të caktuara. Duhet të ketë një nivel minimal të njohurive dhe aftësive, të cilat duhet të kërkohen për t’u demonstruar në mënyrë korrekte. Ky proces vlerësimi mund të bëhet për një pozicion specifik, duke përdorur pajisje specifike ose të kryhet si anëtar i ekipit, brenda një njësie. Kualifikimi nuk është i disenjuar si një program trajnimi, por mund të kërkojë trajnim. Procedurat e kualifikimit demonstronjë aftësinë për të kryer detyra specifike. Një program kualifikimi mbulon njohuritë themelore të nevojshme për detyrat e atij pozicioni dhe testimin e individëve në sistemet që ata do të kërkohet të operojnë ose mbajnë.

### Certifikimi

Qëllimi i certifikimit është të autorizojë një individ për të shërbyer në një kapacitet të deklaruar. Certifikata mund t’u lëshohet kandidatëve që plotësojnë kërkesat për shërbimin, moshën, kondicionin fizik, trajnimin, kualifikimin etj. Certifikimi duhet të bëhet me shkrim, para se personi të emërohet në detyrë si koordinator SAR.



Trajnimi mund të ofrojë vetëm njohuri dhe aftësi themelore. Proceset e kualifikimit dhe certifikimit përdoren për të fituar përvojë të mjaftueshme, pjekuri dhe gjykim. Gjatë një procesi kualifikimi, individi duhet, duke demonstruar aftësitë, të tregojë aftësi mendore dhe fizike për të vepruar si pjesë të një ekipi. Certifikimi është njohja zyrtare nga organizata që i beson individit të përdorë ato aftësi. Kërkesat e detajuara të kualifikimit ndryshojnë për secilin lloj të vendit të punës (një anije, avion ose RCC). Personit që trajnohet mund t'i caktohet një bashkëpunëtor që e vëzhgon dhe mund të dëshmojë aftësitë e tij për të kryer çdo detyrë të veçantë. Duhet, gjithashtu, të demonstron njohuri e plotë e zonës gjeografike të veprimit. Disa detyra mund të kërkojnë ricertifikim periodik.

Personi përgjegjës, përpara lëshimit të një certifikate, duhet të besojë se një person i kualifikuar ka pjekurinë, udhëheqjen dhe integritetin për të kryer detyrën si anëtar i ekipit dhe ky është hapi përfundimtar që çon në marrjen përsipër të detyrave. Personat që kanë kaluar nëpër procesin e kualifikimit janë burimi më i mirë i ideve për përmirësimin e tij. Trajnimi dhe kualifikimi përmirësojnë efektivitetin operacional, krijojnë një ndjenjë të ndershmërisë, zvogëlojnë aksidentet dhe ankesat kundër organizatës.

RCC-ja dhe RSC-ja kanë detyra veçanërisht të rëndësishme. Pas përfundimit të trajnimit, koordinatori i ardhshëm i RCC-së duhet t'u nënshtrohet procedurave të kualifikimit. Staf i RCC-së duhet të jetë plotësisht i kualifikuar në analizën e incidenteve SAR, planifikimin e kërkimit dhe menaxhimin e operacioneve SAR.

Shënim: Termi “certifikim” përdoret gjerësisht nga IMO, ICAO dhe organizata të tjera, brenda kontekstit të autorizimit të personelit apo pajisjeve për të kryer funksione të caktuara. Këtu, “certifikimi” përdoret, në mënyrë të ngjashme, për të autorizuar që një person i trajnuar dhe i kualifikuar të kryejë detyra të caktuara.

#### 7. GRUPET VULLNETARE

Grupet vullnetare mund të kontribuojnë në një operacion SAR pas një kërkesë përkatëse nga QKKSH-ja. Përveç kësaj, QKKSH-ja i angazhon grupet vullnetare në operacion SAR edhe me kërkesën e tyre dhe pas miratimit nga kryetari i QKKSH-së. Grupet vullnetare, ashtu si dhe operatorët e tjerë, nuk do të lejohen të kryejnë

operacione autonome brenda zonës së operacionit SAR, të përcaktuar nga QKKSH-ja.

Një grup vullnetar, që duhet të përfshihet në sistemin e SAR-së, duhet të mbështetet nga QKKSH-ja, brenda mundësive të buxhetit vjetor, me qëllim që të ketë mundësinë për të marrë pjesë në operacionet e koordinuara SAR.

QKKSH-ja vlerëson grupet vullnetare, sidomos aftësitë e tyre për kujdesin parësor të anëtarëve dhe, nëse ata janë mbajtës të diplomave zyrtare për dhënien e ndihmës së parë, shpëtim jetësh, zhytje dhe ecje, në varësi të ndihmës që ata synojnë të ofrojnë në operacionet e SAR-së. Për më tepër, grupi vullnetar duhet t'i përkasë një shoqate të njohur nga shteti ose nga Mbrojtja Civile, Policia ose Shërbimi Zjarrfikës.

#### 8. MARRËDHËNIET ME MEDIEN

Zyra e shtypit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe QKKSH-ja janë pikat e kontaktit me medien për çështjet që kanë të bëjnë me SAR-në, në publikimin e njoftimeve për shtyp dhe njoftimet dhe/ose deklaratat në mediet elektronike.

Njoftimet për shtyp që kanë të bëjnë me operacionet e SAR-së përgatiten menjëherë pas përfundimit të operacionit dhe dërgohen në mediet e shkruara dhe elektronike, përmes Këshilltarit për Medien ose personit të autorizuar nga ana e ministrit të Mbrojtjes.

Komunikimi me publikun, në rastet e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile, ku kemi operacione SAR masive, kryhet i përqendruar nën drejtimin e zyrës së Kryeministrit, sipas VKM-së nr. 965, publikuar në datën 2.12.2015.

#### 9. DISPOZITA TË FUNDIT

Në qoftë se është e domosdoshme, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, disa nga kërkesat ose plani në tërësi mund të pezullohen për një periudhë të caktuar kohore.

Në rastet kur në RSH është shpallur emergjencë kombëtare apo rajonale, për shkak të një fatkeqësie natyrore apo katastrofe humanitare, operacionet SAR dhe angazhimi i strukturave të FA-së në këto operacione do të bëhet nga QKKSH-ja, me miratimin e ministrit të Mbrojtjes.

Çdo plan apo dokument tjetër që ka të bëjë me operacionet e SAR-së shfuqizohet me fillimin e planit aktual ose do të ndryshohet, në mënyrë që të jetë në përputhje me dispozitat e këtij plani.

Plani Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit nënshkruhet nga kryetari i QKKSH-së, si person



përgjegjës, ministri i Mbrojtjes, si person përgjegjës për administrimin e përgjithshëm të shërbimit të kërkim-shpëtimit dhe për zbatimin e politikave në këtë fushë dhe me pëlqimin e përgjegjësve të përcaktuar me ligj për mbështetjen e operacioneve SAR në Republikën e Shqipërisë.

Plani aktual është në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

## SHTOJCA A

### RAJONI I KËRKIM-SHPËTIMIT TË RSH-së

#### Hyrje

Krijimi i rajoneve të përgjegjësive për kërkim-shpëtimin, si dhe sektorëve të kërkim-shpëtimit është një detyrim ligjor për çdo shtet anëtar i konventave ndërkombëtare të kërkim-shpëtimit, e cila përcakton qartë kufijtë e përgjegjësive e veprimit të çdo shteti, por që nuk kanë të bëjnë dhe nuk duhen ngatërruar me kufijtë politikë.

Rajoni i Kërkim-Shpëtimit të RSH-së është i përcaktuar dhe i njohur ndërkombëtarisht nga ICAO-ja dhe IMO-ja, por, gjithashtu, është i shprehur edhe në Publikimet e Informacionit Aeronautik të Republikës së Shqipërisë. Në zbatim të konventave të ICAO-së dhe IMO-së, si dhe të legjislacionit kombëtar është ngritur dhe funksionon QKKSH/RCC përgjegjëse për Rajonin e Kërkim-Shpëtimit në RSH (lidhja nr. 1).

Për arsye të zhvillimit sa më efikas të operacioneve të kërkim-shpëtimit, ndërhyrjes sa më të shpejtë dhe produktive, si dhe aktivizimin e forcave dhe mjeteve SAR më të përshtatshme bëhet nënndarja e Rajonit të Kërkim-Shpëtimit në sektorë të kërkim-shpëtimit sipas parimit një nënqendër e kërkim-shpëtimit përgjegjëse për një sektor kërkim-shpëtimi (lidhja nr. 2).

Rajoni i Kërkim-Shpëtimit kombëtar (SRR - Search Rescue Region) përfshin territorin dhe ujerat territoriale, nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, të kufizuar nga segmentet koordinative gjeografike:

kufiri gjeografik;


rajoni informativ i fluturimit (hapësirë e sipërme) FIR/UIR: 402500N 190000E; 403554N 190000E; (GOKEL); 404500N 190000E; 405330N 185706E; (PAPIZ); 410800N 185200E; 412748N 190600E; (RODON); 413448N 191036E (GLIDA); 415000N 192200E; 420600N 192400E; 421300N 192036E (RETRA); 422900N 195100E (ALELU); - 415300N 203500E; 414012N 203148E (MAVAR); 405300N 205900E; 403700N 210300E (GENSU); 402851N 205731E (PINDO); 400353N 203007E (SKERD); 395854N 202330E (VJOSA); 395400N 195042E (PITAS); 402500N 190000E.



SHTOJCA A  
Lidhja nr. 1

TIRANA FIR

Rajoni Informativ i Fluturimit (TIRANA FIR) dhe vija delimituese për SAR në detin Adriatik me Republikën e Italisë





TIRANA FIR





RAJONI I KËRKIM-SHPËTIMIT NË DET





## SHTOJCA A Lidhja nr. 2

### SEKTORËT (ZONAT) E OPERACIONEVE SAR

#### Nënqendrat e shpëtimit (SRC)

Mund të ketë situata kur RCC-ja nuk është në gjendje të ushtrijë kontroll të drejtpërdrejtë dhe efektiv mbi objektet e SAR-së në një zonë brenda SRR-së së saj. Shembuj të situatave të tilla mund të jenë kur pajisjet e komunikimit në një pjesë të SRR-së nuk janë të disponueshme për bashkërendim ndërmjet RCC-së dhe mjeteve SAR ose kur kontrolli i operacioneve SAR nga RCC nuk është shumë efektiv.

Në këto raste, ngritja e një RSC-je me SRS-në e saj mund të jetë më e përshtatshme dhe RCC-së mund t'ia delegojë një pjesë ose të gjithë përgjegjësinë e saj një RSC-je, duke përfshirë komunikimin, planifikimin e kërkimit dhe rregullimet për mjetet e SAR-së.

Sa më i vështirë të jetë koordinimi apo sa më i dobët të jetë komunikacioni, aq më i madh është autoriteti që duhet të delegohet në RSC. RSC-të, zakonisht, kanë më pak përgjegjësi dhe aftësi sesa RCC-ja e tyre eprore dhe kërkesat e tyre për personel, pajisje dhe strehim, në përgjithësi, janë më të vogla.

Një RSC ajrore (ARSC) mund të krijohet për incidentet ajrore të SAR; një RSC detare, (MRSC) për incidentet detare të SAR dhe një RSC tokësore (LRSC).

Shënim: Termi RSC do të përdoret brenda këtij plani, ndërsa kur përdoret vetëm për aeronautikën ose detin, atëherë do të përdoren ARSC-të ose MRSC-të.

#### Sektorët e operimit/Search and Rescue Sub-Region (SRS)

Për shkak të shtrirjes së SRS-së së Republikës së Shqipërisë dhe në mënyrë që të ketë një koordinim të plotë e përhapje efektive të aseteve të SAR-së, si dhe për të arritur më të mirën e rezultateve të mundshme, SRS-ja ndahet në katër sektorë operimi.

Është e qartë se sektorët e operimit ngrihen për të siguruar më të mirën e mundshme në menaxhimin e aseteve të SAR-së. Në rastin e një

incidenti serioz, në cilëndo nga katër sektorët e operimit, do të kërkohet përdorimi i aseteve SAR, nga sektorët e tjerë.

Për shkak të kontrollit operacional që QKKSH/RCC ka në të gjitha aktivitetet e gatishmërisë së SAR-së, ajo udhëzon çdo aset SAR për të marrë një mision në çdo sektor operimi që e konsideron të nevojshme.

Koordinatat e pikave që përbëjnë secilin prej katër sektorëve të operimit, si dhe bazat kryesore të njësive SAR, janë përcaktuar në variantin e dhënë si më poshtë:

Spektori i Kërkim-Shpëtimit (SRS, ALPHA) për incidentet ajrore, detare, tokësore, i cili përputhet me kufijtë e FIR-së, Tiranë, e njohur nga IMO-ja dhe dokumente të ICAO-së sipas lidhjes me nr. X. Përgjegjëse për zhvillimin e operacioneve SAR, në këtë sektor, është Nënqendra Ajrore e Kërkim-Shpëtimit (ARSC).

Spektori i Kërkim-Shpëtimit (SRS, BRAVO), për incidentet ajrore, detare, që ndodhin në hapësirën detare të RSH-së përfshin hapësirën detare të kufizuar nga vija bregdetare e RSH-së, si dhe kufirin detar të RSH-së, duke përfshirë dhe hapësirën detare, sipas Memorandumit të Mirëkuptimit të 19 majit 2000 midis Italisë dhe Shqipërisë (Memorandum of Understanding ALB-ITA Declared by ICAO, SAR.6/Circ.43), 20 janar 2010, nëpërmjet të cilit hapësira detare e RSH-së ndahet nga hapësira detare e Italisë, për qëllime SAR-ja në vijën me koordinata:  $\varphi: 41^{\circ} 23,5' N$ ,  $\lambda: 018^{\circ} 19,5' E$ ;  $\varphi: 40^{\circ} 25,0' N$ ,  $\lambda: 19^{\circ} 00,0' E$ .


Përgjegjëse për zhvillimin e operacioneve SAR në këtë sektor është Nënqendra Detare e Kërkim-Shpëtimit (MRSC).

Spektori i Kërkim-Shpëtimit (SRS, CHARLIE) për incidentet ajrore, tokësore, që ndodhin në hapësirën tokësore të RSH-së përfshin hapësirën tokësore dhe ujërat e brendshme të kufizuara nga vija kufitare tokësore e RSH-së dhe në përfundim të RSH-së, nga vija bregdetare. Përgjegjëse për zhvillimin e operacioneve SAR në këtë sektor është Nënqendra Tokësore e Kërkim-Shpëtimit (LRSC).

RSC tokësore (MRSC, CHARLIE)



Sektori i Kërkim-Shpëtimit (SRS), (ALPHA)








Sektori i Kërkim-Shpëtim (SRS), (BRAVO)





Sektori i Kërkim-Shpëtimit (SRS), (CHARLIE)





## SHTOJCA B KATEGORIZIMI I ASETVEVE SAR

Kategorizimi i aseteve SAR është bërë në përputhje me manualet ndërkombëtare IAMSAR. Ai është një tregues dhe nuk lidh detyrimisht përdorimin e një njësie SAR në një operacion SAR sipas parametrave që përshkruhen në kategoritë më poshtë, nëse diçka e tillë kërkohet nga situata aktuale taktike apo nuk shkel rregullat e saj të sigurisë.

Kategorizimi i mjeteve SAR është si më poshtë:

### 1. Asetet detare:

#### 1.1 Asete detare parësore

Asetet detare përbëhen nga anijet e shpëtimit të cilat veprojnë larg në det të hapur dhe kanë shpejtësi të mjaftueshme për të arritur në zonën e incidentit, si dhe varkat e shpëtimit që veprojnë pranë brigjeve me shpejtësi të lartë (tabela 1 “Kapacitetet detare”).

#### 1.2 Asete detare dytësore

##### Shënim:

Anijet klasi “ILIRIA” janë të pajisura me gomone që përdoren për operacionet SAR dhe ato të bordingut, si dhe me sistemin e fikjes së zjarrit në distancë.

Anijet: ARCHANGLE, BORA P-116, SHIROKA P-117, Brizap P-118, SKËNDERBEU P-112, SHQYPNIA P-110, ILIRIA P-131, ORIKU P-132, LISSUS P-133, BUTRINTI P-

134, për komunikim kanë radio speciale HF dhe radio TETRA HF.

Gjendja teknike dhe operacionale e anijeve është e ndryshme, në vartësi të problemeve që ato kanë dhe periudhës së shërbimit që u bëhet në kantier.

### 2. Asetet ajrore:

#### 2.1 Asete ajrore parësore

TABELA 2 – Kapacitetet operacionale të teknikës ajrore

TABELA 3 – Kapacitetet për fluturim operacional të helikopterëve të forcës ajrore

#### 2.2 Asete ajrore dytësore

##### Shënim.

Që një mjet ajror (helikopter) të plotësojë standardet dhe karakteristikat për zhvillimin në/me siguri të misioneve të kërkim-shpëtimit, ai duhet të ketë të instaluar dhe funksionale pajisjet e mëposhtme:

Sistemin e kontrollit automatik të fluturimit (AFCS).

Sistemin e menaxhimit të fluturimit (FMS) me Doppler dhe GPS. Radar kërkimi dhe kohe (meteorologjik).

FLIR (opsional).

1 vinç shpëtimi (elektrik ose hidraulik). Vend ankorimi për ngarkesat.

Gomone për pluskim në ujë, në rast avarie.

Rripat dhe ganxhat për fiksimin e barelave për të plagosurit. Instalimet mjekësore bazë.

Transmetuesi i pozicionit të emergjencës (ELT) ose radiolokator emergjence për personelin (PLB).

Dysheme e papërshkueshme nga uji.

Të dhënat e mësipërme mund të ndryshojnë gjatë një operacioni dhe nuk duhet të konsiderohen si absolute. Çdo veprim duhet të planifikohet duke marrë parasysh disa fakte, si: distancën nga baza, kohën e nevojshme për të fluturuar në zonën e operimit, peshën maksimale në ngritje etj.

Në rastin e kushteve ekstreme të motit ose vështirësive të tjera që ndikojnë në ekzekutimin e një operacioni, vendimi përfundimtar për nisjen e një anijeje/helikopteri, si dhe vazhdimin e operacionit, merret nga kapiteni i anijes/piloti i helikopterit, duke marrë si konsideratë parësore, sigurinë e personelit dhe pajisjet e anijes/helikopterit.

### 3. Asetet tokësore

#### 3.1 Asetet tokësore parësore

#### 3.2 Asetet tokësore dytësore

### PËRSHTATJA E ASETVEVE SAR

Procedurat për kryerjen e operacioneve të SAR-it, pajisjen e strukturave SAR, si dhe trajnimin e personelit bëhet sipas kërkesave të manualit IAMSAR, Vol. 3, i cili është produkt i përbashkët i organizatave ndërkombëtare ICAO & IMO dhe Manualit të Kërkim-Shpëtimit në FARSH (Joint Search and Rescue Manual) MP 3-3-2-1.

Njësitë detare e të aviacionit që kanë asete SAR duhet të integrojnë asetet përkatëse në programin e tyre të trajnimit.



SHTOJCA C  
KAPACITETET PËR KËRKIM-SHPËTIM

SHTOJCA C  
**Lidhja 1**

QENDRA E BASHKUAR OPERACIONALE E FORCAVE TË ARMATOSURA

Qendra e Bashkuar Operacionale e Forcave të Armatosura, kur autorizohet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, angazhon në interes të QKKSH-së kapacitetet e saj dhe kapacitetet e strukturave të FA-ve të deleguara për angazhim prej saj.

Përgjegjësi i Grupit të Drejtimit në QBO vihet në dijeni për çdo aktivitet në lidhje me kërkim-shpëtimin, si dhe për rastet që kërkojnë zhvillimin e operacioneve SAR në zonën e përgjegjësisë të RSH-së.

PGD-ja jep ndihmën e tij në këshillimin dhe marrjen e një vendimi sa më të volitshëm në rastet e një alarmi SAR brenda zonës sonë të përgjegjësisë dhe duhet të jetë i informuar për çdo hap të kryer nga specialisti koordinator SAR në detyrë.

QBO-ja, gjatë situatave emergjente SAR (sipas fazave), vendos në dispozicion të QKKSH/RCC

për zgjidhjen e situatës jo vetëm mjetet e sallës operacionale të QBO-së, por edhe personelin përgjegjës për forcën tokësore, forcën detare, forcën ajrore, komandën e mbështetjes dhe të forcave të tjera, për aktivizimin e mjeteve dhe forcave të deklaruara në një operacion SAR, në varësi të natyrës së tij.

Në rastet kur RCC-të fqinje kërkojnë leje për hyrje në territorin e RSH-së, për të kryer operacione kërkim-shpëtimi brenda zonës sonë të përgjegjësisë, të mjeteve ajrore, detare dhe tokësore, specialisti koordinator i SAR-së, së bashku me specialistët e sektorit të vendit pritës në QBO, si dhe specialistit të forcës ajrore dhe forcës detare kryejnë procedurat përkatëse për dhënien e këtyre lejeve dhe dërgimin për miratim te ministri i Mbrojtjes.

Drejtimi i operacioneve më tej bëhet nga personeli i QKKSH-së

PGD-ja, pas propozimit të specialistit koordinator SAR të QKKSH-së për mbarimin e operacionit SAR/Ndërhyrjes për Kërkim-Shpëtim, njofton Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA/koordinatorin kombëtar të kërkim-shpëtimin për përfundimin e operacionit dhe, me urdhrin e tij, deklaron përfundimin e operacionit të strukturat e FA-së të angazhuara në operacion, duke urdhëruar kalimin e tyre në dislokimin e përhershëm.

**Kapacitetet e QBO-së**

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Personeli i shërbimit në detyrë	persona	4/5
4	Mjetet e komunikimit (telefon, fax, kompjuter)		
5	Salla operacionale, mjediset e punës		

2. Kapacitetet e deleguara për angazhim nga QBO-ja<sup>1</sup>

INSTITUCIONI	SPECIALITETI	KAPACITETI
KM (bMR, bxh)	Për K-SH, në rast tërmetesh për K-SH, në rast përmbytjesh për K-SH, në rast zjarresh Për K-SH, në terrene malor Për hapjen e rrugëve nga bora dhe rrëshqitjet e dherave	- Deri 30 vetë nga Kompania e KSH (Land Rescue Coordination Center), Tiranë. - Deri 30 ushtarë nga bxh për EC, 2 ekskavator, 1 fadromë, 2 zjarrfikëse, motopompa dhe një vinç. - DMR Kukës - DMR Korçë - DMR Gjirokastër - DMR Burrel
Njësia e Helikopterëve, Farkë	Shërbim i KSH-së, për transportin ajror dhe shuarjen e zjarreve.	6 helikopterë të tipave: - 1 BO-105 me nga 1 person - 2 AB-205, kapacitet 14 vetë - 2 EC-145, kapacitet 12 vetë - 2 COUGAR, kapacitet 20 vetë
Batalioni i Poshnjës	Për kërkim-shpëtim në rast aksidentesh detare, ajrore dhe tokësore Për hapjen e rrugëve nga bora dhe rrëshqitjet e dherave, shuarjen e zjarreve etj.	Deri 30 ushtarë 2 mjete transporti
Batalioni i Shkodrës	Për kërkim-shpëtim në rast aksidentesh detare, ajrore dhe tokësore Për hapjen e rrugëve nga bora dhe rrëshqitjet e dherave, shuarjen e zjarreve etj.	Deri 30 ushtarë 2 mjete transporti

## SHTOJCA C

## Lidhja 2

## KAPACITETET E FORCËS TOKËSORE

Nr.	Lloji i operacionit	Forca	Mjete	Venddislokimi	Koha e vënies në gatishmëri	
1	Për kërkim-shpëtim në rast aksidentesh ajrore në tokë	12	3	Batalioni i Forcave Speciale, Zall-Herr		
		12	3	Batalioni Komando, Zall-Herr		
2	Për kërkim-shpëtim në rast aksidentesh ajrore në ujërat e brendshëm	12	3	Batalioni i Forcave Speciale, Zall-Herr		
4	Për kërkim-shpëtim në rast aksidentesh sportive e turistike në terren malor	12	3	Batalioni i Forcave Speciale, Zall-Herr		
5	Për kërkim-shpëtim në rast aksidentesh sportive e turistike në ujërat e brendshëm	12	3	Batalioni i Forcave Speciale, Zall-Herr		
6	Kërkim jo i specializuar në tokë	200				

<sup>1</sup>Lidhja 1 e urdhrit të ministrit të Mbrojtjes nr. 12, datë 8.1.2016 “Për delegim të autoritetit të komandimit e kontrollit në rastet e emergjencave civile dhe krizave”.



7	Mbështetje shëndetësore e operacioneve të kërkim – shpëtimit në tokë	2	1	Kompania e mbështetjes, Zall-Herr		
		6	1	Batalioni i 2-të i Këmbësoresë, Zall- Herr		
		1		Batalioni Komando, Zall-Herr		
		2	1	Batalioni i 1-rë i Këmbësoresë, Shkodër		
		3	1	Batalioni i 3-të i Këmbësoresë, Berat		
8	Zbulim të agjentëve kimikë, radioaktivë dhe bërthamorë, si dhe marrjen e mostrave	10	3	Batalioni i Mbështetjes së luftimit, Zall-Herr		

## SHTOJCA C

## Lidhja 3

## KAPACITETET E FORCËS AJRORE

Nr.	Lloji i operacionit	Forca	Mjete	Venddislokimi	Koha e vënies në gatishmëri	
					Vija e parë	Me thirrje
1	Kërkim-shpëtimi në rast aksidenti ajror në tokë		1 helikopter “Cougar”	Farkë	30’	2 orë
			1 helikopter EC 145	Farkë	30’	2 orë
2	Kërkim-shpëtimi në rast aksidenti ajror në ujërat e brendshëm		1 helikopter “Cougar”	Farkë	30’	2 orë
			1 helikopter EC 145	Farkë	30’	2 orë
3	Kërkim-shpëtimi në rast aksidenti ajror në ujërat e detarë		1 helikopter “Cougar”	Farkë	30’	2 orë
			1 helikopter EC 145	Farkë	30’	2 orë
4	Kërkim-shpëtimi në rast aksidenti detar		1 helikopter “Cougar”	Farkë	30’	2 orë
			1 helikopter EC 145	Farkë	30’	2 orë
5	Kërkim-shpëtim në rast aksidentesh në aktivitete alpinistike, sportive e turistike në terren malor		1 helikopter “Cougar”	Farkë	30’	2 orë
			1 helikopter EC 145	Farkë	30’	2 orë



6	Kërkim-shpëtim në rast aksidentesh në aktivitete alpinistike, sportive e turistike në ujërat e brendshme dhe detare		1 helikopter “Cougar”	Farkë	30’	2 orë
			1 helikopter EC 145	Farkë	30’	2 orë
7	Mbështetje shëndetësore e operacioneve të kërkim-shpëtimit		Helikopterët “MEDEVAC”	Farkë	30’	2 orë

### Sqarim 1.

1. Forca Ajrore ka të konfiguruar për operacione “SAR 2”, helikopterë (1 EC- 145 dhe 1 Cougar).
2. Për operacionet SAR detare, në raste të veçanta, përveç helikopterëve të pikës 1, aktivizohet edhe 1helikopter “Cougar”.
3. Për operacionet SAR në terren tokësor dhe ujërat e brendshëm, përveç helikopterëve të pikës 1, aktivizohen të gjithë helikopterët në gatishmëri.
4. Në të gjitha operacionet SAR, përveç helikopterëve të sipërpërmendur të Faj, vë në dispozicion helikopterët “MEDEVAC”.

SHTOJCA C

#### Lidhja 4

### KAPACITETET E FORCËS DETARE/ROJËS BREGDETARE

Forca Detare/Roja Bregdetare zotëron vendbazime, qendra operacionale, njësi, sisteme dhe pika vrojtimi, së bashku me personelin e tyre për realizimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit në det. Kapacitet e Forcës Detare për kërkim-shpëtimit në det janë si më poshtë:

1. Njësitë detare të klasit: “Iliria” (4 anije), “Era” (3 anije), “25 Dhjetori” (2 anije) dhe “Drini” (5 anije). Forca Detare ushtron një regjim gatishmërie me 3 deri 5 anije (në varësi të sezonit), të gatshme 24 orë për operacionet e kërkim-shpëtimit në det.

2. Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare, i pajisur me radar që shërben për gjetjen e vendndodhjes së mjeteve në fatkeqësi, me programin e kërkim-shpëtimit (Sarex) që ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e operacionit, si dhe me radiomarrës-radiodhënësit (VHF), të cilët bëjnë të mundur komunikimin në kanalet ndërkombëtare të emergjencave detare.

3. Qendrat e zhytjes me zhytës të specializuar, të cilët marrin pjesë në operacionet e kërkim-shpëtimit në det.

4. Qendrat operacionale të Durrësit dhe të Vlorës.

5. Pikat radioteknike janë të vendosura në Ksamil, Palermo, Sazan, Llogara, Guri i Gomares (Lushnjë), Durrës, Shëngjin. Ato monitorojnë gjatë gjithë kohës trafikun detar në hapësirën detare të përcaktuar. Radiokomunikimi me këto sigurohet në orare dhe intervale të caktuara kohore dhe për raste të vrojtimit apo të transmetimit të një emergjence detare, ato mund të transmetojnë direkt të dhënat në Qendrën e Koordinim-Shpëtimit për mjetin detar apo personat në bord që janë në rrezik.

Venddislokimi për anijet e FD.:

- 4 anije të klasit “Iliria”, 2 në Pashaliman dhe 2 në Portin e Durrësit;

- 5 anije të klasit “Drini”, 3 në Pashaliman dhe 2 në Kepin e Palit;

- 3 anije të klasit “Era, 2” në Pashaliman dhe 1 në Kepin e Palit;

- 2 anije të klasit “25 Dhjetori”, 1 në Pashaliman dhe 1 në Kepin e Palit.

Shënim. Të shtohet se numri i emergjencës për fatkeqësi detare, është numri 125 pa pagesë.



SHTOJCA C  
Lidhja 4/1  
**KAPACITETET E FORCËS DETARE/ROJËS BREGDETARE**

Nr.	Lloji i operacionit	Forca	Mjete	Venddislokimi	Koha e vënies në gatishmëri	
1	Për kërkim-shpëtim në det (aksidente ajrore dhe detare)		3 Anije të klasit "Iliria"			
			5 Anije të klasit "Drini"			
			3 Anije të klasit "Era"			
			2 Anije të klasit "25 Dhjetori"			
2	Mbështetja me transport		Flotilja Detare	Pashaliman, Vlorë		
3	Mbështetja me ndërlidhje		Radio dore SX-200 VHF			
<b>Qendra e zhytjes</b>						
1	Oficer drejtues zhytje për	1				
2	Ndihmësmjek fiziolog	1				
3	Palombarë	5				
<b>Pajisje palombare</b>						
1	Barelë transporti		2 copë			
2	Çantë mjekësore e kompletuar		1			
3	Oksimetër		1			
4	Aerosteril fushor		1			
5	Krevat vizite		1			
6	Dyshek sfungjeri		1			
7	Mbajtës aparati serumi		1			

SHTOJCA C  
Lidhja 4/2  
**SISTEMI I INTEGRUAR I VËZHGIMIT TË HAPËSIRËS DETARE (SIVHD)**

- PRT-11, Ksamil
- PRT13, Porto-Palermo
- PRT-14, Llogora
- PRT-17, Sazan; PRT-19 Lushnjë
- PRT-20, Durrës
- PRT -22, Shëngjin





SHTOJCA C  
Lidhja 5  
Sasia e faqeve...	Ref.: Ligji nr. 10435, datë 23.06.2011 "Për SAR", VKM nr. 742, datë 16. 10.2012 "Për QKKSH-në; VKM-në nr. 965, datë 16.12.2015; Urdhri operacional nr. _____, datë ___/___/2016	Kolonel: _____ Kryetari i QKKSH-së	



Koha e marrjes së mesazhit		Koha e transmetimit të mesazhit		Gjeneralmajor _____ Koordinatori kombëtar i kërkim-shpëtimit në RSH
Data	Koha	Data	Koha	
		.....	.....	

SHTOJCA F  
Lidhja nr. 5  
**PËRMBLEDHJA PËRFUNDIMTARE E AKTIVITETIT SAR**

- REF: ORDER No. Date \_\_\_\_\_ 2016  
 Data / /2016/ enti/personi kërkues  
 Qëllimi i misionit SAR \_\_\_\_\_  
 Njësitë e angazhuara \_\_\_\_\_  
 Mjetet e përdorura \_\_\_\_\_  
 Ora e kërkesës/lajm:: Zulu / ora e fillimit operacionit: \_\_\_\_\_  
 fillimi: Zulu/ përfundimi i misionit: Zulu  
 Gjithsej orë fluturimi/lundrimi/marshimi \_\_\_\_\_ orë \_\_\_\_\_ min/dalja \_\_\_\_\_  
 Persona të shpëtuar \_\_\_\_\_  
 Të dhëna personale \_\_\_\_\_/mosha: \_\_\_\_\_/kombësia \_\_\_\_\_  
 Diagnoza / organi \_\_\_\_\_  
 10. Shoqëruesit / ndihmësit / ekipi mjekësor \_\_\_\_\_  
 Njësia e sipërfaqes së përdorur \_\_\_\_\_  
 11. Baza e ngritjes e mjetit të përdorur ad. \_\_\_\_\_  
 12. Vendi i ngarkimit (shoq. – ndihmuesit – ekipi mjekësor) \_\_\_\_\_  
 13. Vendi i ngarkimit (lagjes) (pacientit, të sëmurit, traumatizuarit) \_\_\_\_\_  
 14. Vendi/gjendja/ zona e ndërhyrjes \_\_\_\_\_  
 15. Vendi i zbarkimit (shoqërues, ndihmues, ekip mjekësor) \_\_\_\_\_  
 16. Vendi i zbarkimit (pacientit, të sëmurit, traumatizuarit) \_\_\_\_\_  
 17. Vendi i shtrimit: \_\_\_\_\_  
 18. Baza e uljes së mjetit të përdorur ad: \_\_\_\_\_  
 19. Kushtet e motit në zonën e veprimeve \_\_\_\_\_  
 20. Përfundimi i misionit: pozitiv / negativ \_\_\_\_\_  
 21. Vështirësi / ndryshme \_\_\_\_\_  
 22. Probleme dhe rekomandime për të ardhmen e ops SAR \_\_\_\_\_

**KRYETARI I QKKSH-së/RCC**  
**GRADA EMRI MBIEMRI**  
**FIRMA/VULA**



## SHTOJCA G UDHËZIME KOORDINUESE

1. Kjo shtojcë përshkruan udhëzimet koordinuese në lidhje me organizimin e njërive, mjetet dhe personelin e SAR-it, që do të jepen për të marrë pjesë në një mision SAR, sipas rastit.

2. Këto udhëzime përcaktojnë rolin e çdo shërbimi për konfrontimin e incidenteve SAR që mund të lindin në zonën e përgjegjësive së Republikës së Shqipërisë (toka, ajri dhe deti). Shërbimet, që do të thirren për të marrë pjesë në incident, kërkohet të njihen me veprimet që do të ndërmerren nga shërbimet e tjera të përfshira, në mënyrë që të shmangen ndërhyrjet e ndërsjella dhe lëvizjet e panevojshme, si dhe të arrihet koordinimi më i shpejtë. Është theksuar se QKKSH-ja mund të ndryshojë shërbimet që marrin pjesë dhe mënyrën e ekzekutimit të veprimit nëse konsiderohet e nevojshme.

3. Theksohet se:

a) në rast të një incidenti brenda zonës së aeroportit, koordinimi dhe kontrolli operacional i incidentit ndërmerren nga autoritetet e aeroportit, të cilat mund të kërkojnë ndihmën e QKKSH-së, nëse konsiderohet e nevojshme;

b) në rast të një incidenti jashtë zonës së aeroportit deri në një distancë prej 5 km nga qendra e pistës, koordinimi dhe kontrolli operacional i incidentit kryhet nga QKKSH-ja, ndërsa autoritetet e aeroportit mund të kontribuojnë për të mbështetur me personat e tyre të vënë në dispozicion;

c) në rast të një incidenti brenda aeroporteve dhe objekteve ushtarake, koordinimi dhe kontrolli operacional i incidentit kryhet nga QKAKSH-ja. Në të gjitha fushat e tjera të koordinimi dhe kontrolli operacional ndërmerret nga QKKSH-ja.

4. Incidentet e mundshme kryesore të SAR-së në mjedisin operativ të Republikës së Shqipërisë kryesisht kanë të bëjnë me rastet e mëposhtme:

## SHTOJCA G Lidhja nr. 1 INCIDENTE NË DET TË HAPUR

1. Kjo ka të bëjë me çdo incident aeronautik ose detar, si dhe çdo incident që ndodh në çdo platformë artificiale të shpimit ose instalimet e minierave të hidrokarbureve që ndodh në një

distancë më të madhe se 6 (gjashtë) milje detare nga bregu.

2. Në këtë rast, për shkak të rëndësisë së kohës së reagimit, reagimi i parë vjen nga mjetet fluturuese, si dhe mjetet parësore detare të Rojës Bregdetare.

3. Ministria e Shëndetësisë siguron kujdesin ndaj të dëmtuarve në spitalet shtetërore.

4. Në varësi të shtrirjes së incidentit, mjetet dytësore mund të përdoren për të mbështetur operacionin.

5. Në rast se incidenti përfshin shpëtimin e Refugjatëve dhe/ose Migrantëve Ekonomikë, atëherë operacioni karakterizohet si “Operacion i Kombinuar i SAR” në të cilin do të ekzekutohen:

a) para akomodimit të personave në ankth në mjetet e shpëtimit bëhet një kontroll i plotë i trupit nga ekipet e trajnuara për këtë qëllim;

b) udhëzimet e koordinimit shpallen (në anglisht dhe arabisht) nga altoparlantët për koordinim dhe për të shmangur çdo sjellje paniku dhe rrezikun e përmbysjes së anijes;

c) kontrolli i vazhdueshëm i varkës në vështirësi nga ana e oficerëve të sigurisë për të ruajtur rendin dhe për të siguruar prioritetet e akomodimit, nëse kushtet e lejojnë këtë.

6. Shërbimet/operatorët e përfshirë duhet të përgatisin një memorandum të detajuar të aktiviteteve, në mënyrë që të ketë përgatitjen dhe standardizimin e nevojshëm gjatë kryerjes së një operacioni SAR.

### Incidente SAR në afërsi të vijës bregdetare

1. Këto janë incidente aeronautike ose detare që ndodhin në një distancë deri në 6 (gjashtë) milje detare nga bregu.

2. Reagimi i parë ndaj këtyre incidenteve vjen nga mjetet me shpejtësi të madhe të Policisë Kufitare. Sipas progresit të incidentit dhe shtrirjes së operacionit SAR do të përfshihen dhe anijet e Rojës Bregdetare dhe helikopterët SAR.

3. Në veçanti, gjatë muajve të verës duhet të merren të gjitha masat për të gjetur personat e humbur gjatë notimit nga ekipet e shpëtimit dhe policia në zonë.

4. Nëse incidenti ka të bëjë me shpëtimin e Refugjatëve dhe/ose Migrantëve Ekonomikë, atëherë operacioni karakterizohet si “Operacion i Kombinuar i SAR” në të cilin do të ekzekutohen:





a) para akomodimit të personave në ankth në mjetet e shpëtimit bëhet një kontroll i plotë i trupit nga ekipet e trajnuara;

b) udhëzimet e koordinimit shpallen (në anglisht dhe shqip) nga altoparlantët për koordinim dhe për të shmangur çdo sjellje paniku – rrezikun e përmbysjes së anijes.

#### SHTOJCA G

##### Lidhja nr. 2

### INCIDENTI AERONAUTIK NË AFËRSI TË AEROPORTIT

1. Çdo aksident avioni që ndodh brenda një rrezeje prej 5 km nga qendra e pistës. Ajo ka të bëjë edhe me Aeroportin e Rinasit, e Kukësit dhe të Vlorës.

2. Në këtë kategori përfshihen:

a) incidentet brenda zonës së rrethuar të aeroportit;

b) incidentet jashtë zonës së rrethuar, por brenda km nga qendra e pistës.

3. Incidentet e lartpërmendura mund të ndodhin në tokë, në det ose në ujërat e brendshme, ku nevojitet një operacion i SAR-it, personeli i trajnuar dhe pajisjet, si dhe procedurat e specializuara. Theksohet se mjedisi në ujërat e brendshme është krejtësisht i ndryshëm në periudhën e dimrit në krahasim me verën.

4. Lidhur me kategorinë (a), të paragrafit 2, që ka të bëjë me operacionet brenda zonës së rrethuar të aeroportit, përgjegjësia për koordinimin dhe menaxhimin e operacioneve të shpëtimit bie tek autoritetet e aeroportit të çdo aeroporti, që kërkon ndihmën e QKKSH-së, nëse konsiderohet e nevojshme.

5. Lidhur me kategorinë (b), në paragrafin 2, në distancë deri në 5 km nga qendra e pistës së uljes, autoriteti përgjegjës për koordinimin është QKKSH-ja, ndërsa aeroporti kontribuon me personelin e tij dhe mjetet e tij në dispozicion. Në çdo incident, përfaqësuesit e shërbimeve të përfshira duhet të jenë të pranishëm në të dy qendrat (QKKSH / Dhoma e Operacionit dhe Qendra e Krizave në aeroport) pasi të informohen, varësisht nga natyra e incidentit.

#### SHTOJCA G

##### Lidhja nr. 3

### AKSIDENTET AJRORE NË UJËRAT E BRENDSHME (LIQENET DHE DIGAT)

1. Përfshin çdo aksident (ajror ose detar) që ndodh në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

2. QKKSH-ja është përgjegjëse në rast të aksidenteve të aviacionit, ndërsa në të gjitha incidentet e tjera që ndodhin në ujërat e brendshme QKKSH-ja merr përsipër vetëm një rol mbështetës, ndërsa koordinimi i operacionit supozohet, rast pas rasti, nga Shërbimi Policor dhe Zjarrfikës.

3. Përgjigjja e parë në incidente të tilla do të jetë nga helikopterët e Faj, Njësitë Speciale të Reagimit ndaj Fatkeqësive, ekipet e shpëtimit të Njësisë së Trajtimit të Katastrofave. Ekipet e shpëtimit të mbrojtjes civile mund të marrin pjesë në një operacion kërkimi dhe shpëtimi në brigjet e digës së ujit, në bashkëpunim me forcat e mësipërme, si njësi e dytë.

#### SHTOJCA G

##### Lidhja nr. 4

### OPERACIONET SAR NË ZONAT MALORE

1. Kjo ka të bëjë me çdo aksident të aviacionit që ndodh në një zonë tokësore, e cila nuk mund të arrihet lehtësisht për shkak të veçorive të mjedisit natyror dhe morfologjisë së tokës. Pra, të gjitha shërbimet e përfshira kërkohet të planifikojnë një mision të detajuar, në mënyrë që të arrihet një koordinim optimal.

2. QKKSH-ja është përgjegjëse për aksidentet e aviacionit, ndërsa në të gjitha incidentet e tjera që ndodhin në zonat e paarrtshme, QKKSH-ja merr përsipër vetëm një rol ndihmës, në interes të forcave operacionale që angazhohen.

3. Përgjigjja e parë ndaj incidenteve të tilla do të jetë nga helikopterët e Faj, ekipet e shpëtimit të Njësisë për Trajtimin e Katastrofave të Veçanta dhe Mbrojtjes Civile, të cilat duhet të sigurojnë asetet parësore si personelin e tyre.



## SHTOJCA H OPERACIONET MASIVE TË SHPËTIMIT

Një operacion i shpëtimit masiv (MRO) nënkupton nevojën për ndihmë të menjëhershme për një numër të madh personash në vështirësi dhe që mundësitë në dispozicion të autoriteteve të SAR-së janë të pamjaftueshme.

MRO-ja ndodhin më rrallë se operacionet e zakonshme të shpëtimit por kanë pasoja të mëdha. Përmbytja, tërmetet, terrorizmi, avionët e mëdhenj të pasagjerëve ose fatkeqësitë e anijeve janë shembuj të skenarëve, që mund të përfshijnë nevojën për MRO-në. Burimet dhe përgatitjet serioze janë të domosdoshme për të kryer me sukses MRO-të.

Incidente të tilla mund të përfshijnë qindra ose mijëra njerëz në gjendje të vështirë në mjedise të largëta dhe të vështira. Për shembull, përplasja e një anijeje të madhe me pasagjerë mund të kërkonte shpëtimin e mijëra pasagjerëve dhe ekuipazhit në kushte të këqija të motit dhe detit, ku shumë nga të mbijetuarit do kishin pak aftësi për të ndihmuar veten. Përgatitja për të realizuar një përgjigje të madhe dhe të shpejtë do të ishte kritike për të parandaluar humbjen në shkallë të gjerë të jetës.

Planet dhe stërvitjet e MRO-së janë sfiduese dhe relativisht komplekse. Marrëveshjet efektive për përdorimin e burimeve kombëtare dhe shpesh ndërkombëtare jashtë atyre që zakonisht përdoren për SAR-në janë thelbësore. Përgatitjet kërkojnë angazhime dhe partneritete thelbësore midis autoriteteve të SAR-it, autoriteteve mbështetëse të SAR-së, kompanive të transportit, burimeve ushtarake dhe komerciale etj.

MRO-të shpesh duhet të kryhen dhe të koordinohen brenda një konteksti të reagimit ndaj emergjencave, të cilat mund të përfshijnë zvogëlimin e rreziqeve, kontrollin e dëmeve dhe operacionet e rikuperimit, kontrollin e ndotjes, menaxhimin kompleks të trafikut, logjistikën në shkallë të gjerë, funksionet mjekësore, vëmendje të madhe publike dhe politike etj. Përpjekjet shpesh duhet të fillojnë menjëherë në një nivel intensiv dhe të jenë të vazhdueshme për ditë ose javë.

Autoritetet e SAR-së duhet të bashkërendojnë planet e MRO-së me kompanitë që operojnë avionë dhe anije të dizajnuara për të transportuar një numër të madh personash. Kompanitë e tilla duhet të marrin pjesë në përgatitjet për të

parandaluar MRO-të dhe për të ndihmuar në arritjen e suksesit nëse ato angazhohen.

Raportet e medias mund të kenë më shumë rëndësi sesa shërbimet e SAR-it për ndërgjegjësimin e opinionit publik për MRO-të. Nuk duhet të ketë vonesa të pajustificuara në dhënie të informacionit në media. Informacioni duhet të jetë në dispozicion dhe të shkëmbehet lirisht midis ofruesve të shërbimeve të emergjencave dhe transportit, kompanisë ajrore ose kompanive të tjera primare të përfshira.

Meqenëse mundësitë për të trajtuar incidentet që përfshijnë shpëtime masive janë të rralla dhe sfiduese, ushtrimi për planëzimin e MRO-ve është veçanërisht i rëndësishëm.

## SHTOJCA I KOMANDIM-KONTROLLI

### Funksionimi i linjës së komandimit dhe kontrollit

Në zbatim të ligjit nr. 10435, datë 23.6.2011 “Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë, kreu II, “Organizimi, struktura, përgjegjësitë dhe detyrat kryesore të shërbimit të kërkim-shpëtimit”, neni 4, “Organizimi i shërbimit të kërkim-shpëtimit”, përcaktohet qartë linja e komandim-kontrollit për operacionet e kërkim-shpëtimit në nivel kombëtar dhe konkretisht:

1. Shërbimi i kërkim-shpëtimit organizohet në nivel kombëtar.

2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura caktohet Koordinatori Kombëtar i Kërkimit dhe Shpëtimit (KKKSH) në Republikën e Shqipërisë. KKKSH-ja drejton operacionet e kërkim-shpëtimit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim-shpëtimit.

Linja e komandimit dhe e kontrollit në Shërbimin e Kërkim-Shpëtimit sipas VKM-së nr.742, datë 16.10.2017 “Për organizimin edhe funksionimin e QKKSH-së”, kreu IV, përcaktohet si më poshtë.

1. QKKSH-ja koordinon në nivelin më të lartë kombëtar operacionet e kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore, detare e në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

2. QKKSH-ja e ushtron aktivitetin e saj operacional nëpërmjet këtyre strukturave vartëse:

a) Qendrës Kombëtare Ajrore të Kërkim-Shpëtimit (QKAKSH);



b) Qendrës Kombëtare Detare të Kërkim-Shpëtimit (QKDKSH);

c) strukturave të tjera të vendosura në vartësi operacionale sipas Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit.

3. QKDKSH-ja për nevoja të punës së saj, kur autorizohet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, shfrytëzon edhe kapacitetet e Qendrës së Bashkuar Operacionale.

Sistemi i Komandimit të Incidentit (ICS) është mjete i menaxhimit të përdorur ndërkombëtarisht për menaxhimin e çdo ngjarjeje urgjente SAR. Ai përbëhet nga procedurat për organizimin e personelit, objekteve, pajisjeve dhe komunikimit në vendin e emergjencës. ICS është një koncept shumë fleksibël për menaxhimin e ngjarjeve emergjente që përfshijnë juridiksione të shumëfishta dhe agjenci të shumëfishta, që kanë detyrime legjislativë por dhe detyrime në këtë plan kombëtar SAR.

**Sistemi i Menaxhimit të Incidentit është mekanizëm i komandimit dhe kontrollit në shërbimin SAR, mbështetur në parimet e Sistemit të Komandës së Incidentit**

Zyrtari më i lartë i shërbimit, koordinatori SAR, në detyrë pas marrjes së informacionit mbi një incident SAR, do të zbatojë planin SAR (gjithashtu, zbatohen procedurat e lajmërimit të strukturave sipas linjës së komandim-kontrollit). Pas aktivizimit të operacioneve SAR, koordinatori i misionit SAR/menaxheri i incidentit SAR mban përgjegjësi për mbikëqyrjen dhe koordinimin e operacioneve SAR në vendin e incidentit.

Menaxheri i incidentit do të kryesojë Postën e Menaxhimit të Incidentit (PMI). Menaxheri i incidentit e menaxhon ngjarjen në përputhje me parimet e komandim-kontrollit dhe përcjell informacionin mbi statusin e ngjarjes dhe nevojat në përgjigje të incidentit SAR të QKDKSH/RCC.

Udhëheqësi i caktuar i ekipit të SAR-së mbikëqyr punën e ekipit SAR në terren dhe i raporton menaxherit të incidentit.

**Komandim-kontrolli dhe përgjegjësitë e planëzimit të kërkim-shpëtimit**

Sipas dispozitave të ICAO-së, aneksi 12, përgjegjësia për një avion në rrezik brenda një FIR qëndron mbi autoritetin kombëtar përgjegjës për rajonin. Këto përgjegjësi kombëtare kalojnë përmes ARCC-së përkatëse. QKDKSH/RCC, këto

përgjegjësi kombëtare, i shkarkon tek ARCC-ja ajrore, e cila do të fillojë veprimin SAR-ja sipas nevojës për të gjitha kërkesat për ndihmë rreziku aeronautik.

Sipas dispozitave të IMO-së, përgjegjësia për një SRR detare qëndron në autoritetin kombëtar përgjegjës për rajonin. Këto përgjegjësi kombëtare shkarkohen me anë të RCC-së së duhur të MRCC-ja detare. RCC-ja detare në fjalë do të fillojë veprimin SAR sipas nevojës, për të gjitha kërkesat për ndihmë në rast fatkeqësish detare.

Çdo komandë apo institucion, që ka dijeni për transmetimin e një mesazhi fatkeqësie nga një prej njësive të saj, nëse është apo jo një mesazh i vërtetë, duhet të informojë menjëherë QKDKSH-ja/RCC-ja për ta mbajtur atë të informuar për zhvillimet, në mënyrë që të parandalojë një operacion të parakohshëm SAR.

Të gjitha njësitë SAR do të veprojnë sipas udhëzimeve të RCC-së ose komanda merret në përputhje me planin e operacionit të zhvilluar nga RCC-ja e të drejtuar nga OSC-ja.

#### **Kontrolli operacional**

##### **Kontrolli i njësive**

Kontrolli operacional i të gjitha njësive të angazhuara për operacionet SAR do të ushtrohet nga QKDKSH/RCC, drejtpërdrejt ose me anë të delegimit. RCC-ja, OSC-ja ose komandantët e forcave/njësive të tjera, në mënyrë që të kryejnë detyrën, duhet:

a) të kenë njohuri të plotë të të gjitha mjeteve në dispozicion të tyre;

b) të marrin raporte të menjëhershme në lidhje me incidentin;

c) të përcaktojnë llojet e pajisjeve për të punësuar;

d) të mbahen të informuar për progresin e të gjitha përpjekjeve të shpëtimit.

Kontrolli operacional i një force jo të integruar do të mbetet me komandantin e forcës jo të integruar, nëse nuk transferohet formalisht në RCC ose OSC.

Atje ku është e mundur koordinimi duhet të bëhet nëpërmjet oficerëve ndërlidhës.

##### **Komandanti në skenën e operacionit (OSC)**

Zakonisht, një OSC përcaktohet nga QKDKSH-ja/RCC-ja në rolin e tij si koordinator misioni SAR (SMC), i cili administron operacionet SAR në vendin e ngjarjes. OSC-ja zakonisht është personi



më i mirë i kualifikuar ose njësia më e aftë në mesin e atyre në dispozicion për misionin SAR.

OSC-ja dhe ACO-ja kanë autoritetin e plotë operacional nga SMC-ja dhe së bashku të koordinojnë të gjitha shërbimet SAR në skenë. Agjencia e prapë ruan kontrollin operacional të një mjeti gjatë rrugës për në/dhe nga skena e operacionit. Në qoftë se një agjenci tërheq një strukturë nga një mision, ajo duhet të këshillojë SMC-në sa më shpejt të jetë e mundur, për të lejuar zëvendësime të përshtatshme, për t'u dërguar e kështu për të ruajtur burimet e duhura në skenë.

a) ICS-ja mundëson:

- standardizimin e sistemeve të menaxhimit ndërmjet agjencive dhe organizatave;
- menaxhimin në situatat emergjente të thjeshta dhe komplekse;
- burimet hyrëse për t'u përshtatur në sistemin e përgjithshëm të reagimit ndaj emergjencave;
- një hapësirë e kontrollueshme të menaxhueshme; dhe
- linja të qarta të autoritetit.

b) SAR-ja është shpesh një komponent i përgjigjes emergjente. Kur zbatohet ICS-ja, objektet e SAR-së mund të kryejnë operacione të njëkohshme nën menaxhimin e ICS.

ICS-ja nuk merr kontrollin ose autoritetin larg shërbimit SAR. Përkundrazi, SMC, OSC ose dikush i caktuar nga SMC-ja shërben si “përfaqësues i agjencisë” për të bashkërenduar përgjigjen e SAR-it me një “komandant të incidentit”, i cili është i njohur nga një plan i zbatueshëm i reagimit emergjent si përgjegjësi e përgjithshme për veprimet në skenë.

c) RCC-ja dhe RSC-ja duhet të jenë të vetëdijshëm për konceptet e përgjithshme të ICS-së ku zbatohet. Përgjigja emergjente e shtetit, reagimi ndaj katastrofave ose agjenci të tjera të ngjashme që përdorin ICS-në janë burime të mundshme të udhëzimit.

Informacion shtesë mbi menaxhimin e incidenteve në ICS është dhënë në kreun 6 në lidhje me operacionet e shpëtimit masiv.

## **PËRKUFIZIMET E KOMANDIMIT DHE KONTROLLIT**

Në mënyrë që të gjitha shërbimet pjesëmarrëse të jenë të njohura në çdo moment, me kë, kur dhe në çfarë mënyre ata kanë komandën për vendimmarrje dhe lëshimin e urdhrave për tërë operacionin dhe/ose incidentet individuale që

rezultojnë gjatë zbatimit të Planit Kombëtar SAR, është e domosdoshme që të ekzistojë një koncept i vetëm i komandimit dhe kontrollit.

### **Vartësia**

Kjo vendos marrëdhënien komanduese / drejtuese ndërmjet një strukture vartëse/vartësi dhe strukture eprorë/epronit të tij, qoftë i përhershëm ose i përkohshëm ose midis dy strukturave. Vartësia urdhërohet nga një strukturë superiore (e lartë), e cila ka të drejtë të krijojë një marrëdhënie të tillë. Termi duhet të përcaktohet gjithmonë nga një formë marrëdhënieje siç përcaktohet më poshtë:

### **Komanda e përgjithshme**

Autoriteti dhe përgjegjësia e një shefi/komandanti për të nxjerrë urdhra, për të caktuar projekte dhe për të operuar, koordinuar dhe inspektuar njësitë vartëse në përgjithësi. Ajo mbulon çdo aspekt të operacioneve, administratës dhe logjistikës, brenda fushës së misionit të komandantit që ushtron komandën e përgjithshme.

### **Komanda operacionale**

Është pushteti i një shefi/komandanti për të urdhëruar misione dhe projekte për shërbimet e tij vartëse/ ekzistuese, për të caktuar forcat dhe për të ruajtur ose caktuar/transferuar kontrollin operacional, komandën taktike ose kontrollin e këtyre forcave të tjerët. Ajo nuk përfshin autoritetin dhe përgjegjësinë për të trajtuar çështjet administrative, të cilat mbeten me komandantin, i cili ushtron komandën administrative.

### **Kontroll operacional (Opcon)**

Është autoriteti i transferuar një shefi/komandanti për të operuar forcat që janë vënë në dispozicion të tij për përmbushjen e misioneve ose detyrave të caktuara, të cilat zakonisht janë të kufizuara në lidhje me kohën, vendin dhe operacionin, si dhe për të dislokuar këto forca e për të ruajtur, caktuar ose transferuar Komandën Taktike ose Kontrollin. Nuk përfshin fuqinë për të caktuar detyra të reja për forcat jashtë misionit të caktuar dhe nuk përfshin pushtetin e kontrollit administrativ ose mbështetjen logjistike.

### **Komanda Administrative**

Është autoriteti i një shefi/komandanti mbi njësitë vartëse/ekzistuese për çështje administrative, siç janë çështjet e personelit, trajnimi, mbështetja e logjistikës, përgatitja për operacione dhe gatishmëria. Kjo është forma e përhershme e komandimit në strukturën administrative dhe vazhdon të jetë në fuqi edhe nëse disa njësi janë



integruar në një strukturë operacionale specifike për të përmbushur një mision tjetër.

#### **Kontrolli administrativ**

Është autoriteti i transferuar një shefi/komandanti për të ushtruar disa detyra administrative ose mbështetje specifike logjistike. Në thelb kjo është një formë e kufizuar e Komandës Administrative. Një formë e zakonshme e saj është mbështetja e personelit të një njësie të vendosur së bashku me një tjetër në lidhje me instalimin, sigurimin, akomodimin, pagat dhe çështje të tjera të një natyre administrative.

#### **Komanda Taktike**

Është autoriteti i caktuar një Shefi/Komandanti për të caktuar detyra ose projekte individuale për forcat nën të, për të përfunduar misionin që i është caktuar atij. Ai përfshin përgjegjësinë për kryerjen e operacioneve, në mënyrë që të përmbushë misionin e caktuar dhe aftësinë për të mbajtur ose transferuar kontrollin taktik të forcave të përfshira.

#### **Kontrolli taktik (Tacon)**

Është autoriteti i transferuar një shefi/komandanti, në mënyrë që të ushtrojë komandën dhe kontrollin e detajuar dhe zakonisht lokal të lëvizjeve dhe manovrave të njësisë ose forcave që i janë caktuar atij dhe që janë të nevojshme për të përmbushur misionet ose projektet që i janë caktuar atij brenda një hapësire dhe kohe të caktuar.

## SHTOJCA J

### SPECIFIKAT E TRAJNIMIT DHE USHTRIMET STËRVITORE

#### **1. SPECIFIKAT E TRAJNIMIT**

##### **Kush duhet të trajnohet?**

Të gjithë specialistët e SAR-së kanë nevojë për trajnim, në veçanti, SC-ja, SMCs-ja dhe OSCs-ja.

Elementet operacionale, të cilat kanë nevojë për trajnim, përfshijnë:

- RCC-në dhe RSC-në;
- njësitë ajrore;
- njësitë detare;
- njësitë tokësore;
- njësitë të specializuara (ndihma e parë mjekësore, shpëtim malor, ekipet SAR urbane që vendosen në fatkeqësi), zhytësit etj.;
- njësitë, depot e furnizimit.

Trajnimi mund të zhvillohet me një individ, një grup ose grupe të bashkuara. Çdo person duhet të

ketë kryer trajnime të mëparshme, për të kryer detyra individuale. Kur individët integrohen në ekipe, kërkohet trajnimi i ekipit, në mënyrë që individët të mund të mbështesin përpjekjet e ekipit. Kur ekipet integrohen, trajnimi i përbashkët i ekipeve është i nevojshëm për të mbështetur përpjekjet e përgjithshme. Një shembull i trajnimit të shumëfishit të ekipeve është trajnimi i njësisë të kërkim-shpëtimit (SRU) së bashku.

Komunitetet e aviacionit dhe detare kërkojnë trajnim në menaxhimin e vështirësive, fatkeqësive dhe rrezikut, procedurat e shpëtimit, teknikat e mbijetesës, si të vendosen dhe veprimet që duhen ndërmarrë për të ndihmuar në shpëtimin e vetes. Ky trajnim mund të përqendrohet në individë ose grupe.

Koordinatorët SAR në RCC dhe në RSC kanë nevojë për formimin formal SAR. Nëse nuk mund të marrin pjesë menjëherë në trajnimin formal, ata duhet të marrin një periudhë trajnimi në vendin e punës dhe një kualifikim dhe certifikim të përkohshëm.

#### **Çfarë duhet të përfshijë trajnimi?**

Trajnimi i një individi duhet të bazohet në analizën e nevojave. Kjo analizë krahason performancën dhe sjelljen aktuale me performancën dhe sjelljen e kërkuar në një pozicion të mbajtur aktualisht. Bazuar në këtë analizë, mund të identifikohen nevojat e trajnimit dhe metodat për kapërcimin e mangësive.

Njohuritë për gjuhën angleze duhet të merren në konsideratë. RCC-ja duhet të jenë në gjendje të komunikojnë me RCC-të e tjera.

Trajnimi i personelit të shërbimit SAR mund të përfshijë:

- studimin e zbatimit të procedurave, teknikave dhe pajisjeve SAR përmes leksioneve, demonstrimeve, filmimeve, manualeve dhe revistave SAR;
- asistimin në/ose vëzhgimin e operacioneve aktuale; dhe
- ushtrime në të cilat personeli është trajnuar për të bashkërenduar procedurat dhe teknikat individuale në një operacion të simuluar.

#### **Temat e trajnimit**

Trajnimi i RCC-së dhe RSC-së SAR duhet të përfshijë të paktën temat e mëposhtme. Nëse përvoja e fituar nga trajnimet formale nuk përdoret rregullisht për operacione ose ushtrime, normalisht



nevojitet trajnim periodik për rifreskimin e njohurive. Kategoritë e përgjithshme përfshijnë:

AFN

AFIN

Alokimi i burimeve (fonde, pajisje, njerëzore etj.)

Aspekte ndërkombëtare

Baza e regjistrimit e të dhënave

Çështje ligjore COSPAS–

SARSAT

Detyrat e koordinatorit në vendin e ngjarjes

Dokumentimi i incidenteve

Evakuim mjekësor

Faktorët e lodhjes

Faktorët e mjedisit

Fazat, etapat dhe komponentët e SAR

Grafikë, skica, harta

Informimi/pyetje për njësitë SAR

INMARSAT

Kapacitetet e burimeve SAR

Këshillim mjekësor

Komunikimi SAR

Koordinimi i misionit SAR

Kujdesi mjekësor

Manovrat e hipjes në anije (boarding)

Marrëdhëniet me familjet e dëmtuara

Marrëdhëniet me publikun dhe mediat e lajmeve

Marrëveshjet SAR

Marrja dhe vlerësimi i të dhënave

Menaxhimi i stresit

Mënyrat e kërkimit

Mundësitë dhe kufizimet e vëzhgimit

Njohuri mbi aeronautikën

Organizimi i sistemit të SAR

Pajisjet e mbijetesës

Përcaktimi i kursit të mjeteve ajrore/detare

Përcaktimi i të dhënave

Përfundimi i operacioneve SAR

Përzgjedhja e ekipeve SAR (SRU)

Përzgjedhja e frekuencave

Planëzimi i SAR

Planëzimi i SAR-it bregdetar

Procedurat e shpëtimit

Programe kompjuteri (SAR)

Punë me harta

Rrymat ujore/detare

Sistemet e gjurmimit së anijeve (AIS, LRIT, VMS)

Sistemet e raportimit të anijes për SAR

Skenarët e shpëtimit dhe planifikimi

Studimi i rasteve

Të dhënat/sinjalet nga bovat lundruese

Teknikat e marrjes së informacionit

Teknikat e vrojtimit

Teknologjia SAR

Trajnim për hedhje me parashutë

Vlerësimi i rrezikut

Vlerësimi i sinjaleve me dritë

Menaxherët e SAR-it që kryejnë funksione administrative mund të përfitojnë nga kurset për:

- planëzimin operacional;

- organizimin;

- menaxhim personeli;

- buxhetimin, vlerësimin e performancës dhe kontabilitetin.

Drejtimi i një mjeti ajror/detar/tokësor, në një situatë SAR, siç është moti i stuhishëm, mund të jetë një aftësi e veçantë që nuk mësohet nga trajnimi i përgjithshëm, por mund të përfitohet nga trajnime të specializuara.

#### **Koha e kryerjes së trajnimit**

Trajnimi është më i dobishëm kur realizohet përpara se një specialist të caktohet në detyrat që kërkojnë trajnimin përkatës. Trajnimi përputhet me detyrat që duhen kryer dhe përgjithësisht jepet në tri nivele:

- niveli fillestar kryhet për specialistët që hyjnë në shërbimin SAR;

- niveli i mesëm kryhet për specialistët, që duhet të qëndrojnë në një nivel të caktuar aftësie për të vazhduar detyrën në pozicionin e tyre aktual. Kjo, gjithashtu, përfshin çdo përditësim për shkak të përmirësimeve teknike dhe të pajisjeve;

- nivel i avancuar kryhet për specialistët që kanë shfaqur performancë në kryerjen e detyrave në pozicionin e tyre dhe kanë dëshirë apo nevojë për të përparuar.

Trajnimi mund të përqendrohet në ndërgjegjësimin dhe njohuritë për nivelin e menaxherit të SAR-it; njohuritë dhe performancën në nivelin e menaxhimit të mesëm (drejtues/koordinator RCC); dhe performancën në nivelin e menaxhimit operacional (duke përfshirë trajnimin e ekipeve SRU). Ekzistojnë modele të ndryshme të menaxhimit të trajnimeve, të cilat kërkojnë të identifikojnë kërkesat specifike të trajnimit dhe të përputhen me procesin e duhur të trajnimit.



### Vendi i kryerjes së trajnimit

Trajnimi mund të realizohet në një sërë vendndodhjesh, duke filluar nga vendi i punës deri në një qendër specifike trajnimit. Trajnuesi mund të trajnohet aty ku realizohet normalisht puna ose mund të transferohet në një vend tjetër për trajnime në vendin e punës. Trajnimi formal mund të bëhet në një institucion të dedikuarose pranë vendit të punës. Vendndodhja përcaktohet duke vlerësuar përdorimin sa më efektiv të kostos së trajnimit, objekteve në dispozicion dhe personelit trajnues ose ekspertëve. Ndonjëherë, trajnimi i marrë nga organizata të tjera me reputacion në fushën përkatëse, madje edhe në shtetet e tjera, mund t'i plotësojë nevojat e kërkuara. Normalisht, është më mirë që procesi i trajnimit të mos varet tërësisht nga pajisjet e trajnimit ose ekipet e ardhura nga shtetet e tjera, sepse një trajnimi tillë mund të jetë i kufizuar, i paparashikueshëm, i shtrenjtë dhe vetëm pjesërisht i rëndësishëm. Ndonjëherë, dallimet gjuhësore mund të zvogëlojnë efektivitetin e trajnimit të ofruar nga shtetet e tjera.

### Mënyra e kryerjes së trajnimit

Ka tri mënyra për të trajnuar:

- *Trajnimi i bazuar në performancë* ndihmon specialistët dhe ekipet e SAR-së për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive. Koordinatori kombëtar i SAR-së ka përgjegjësinë për të siguruar që programi i përgjithshëm i trajnimit është efektiv. Kryetari i QKSSH-së dhe të tjerët duhet të sigurojnë që i gjithë personeli i shërbimit të SAR-së të arrijë dhe të mbajë nivelin e kërkuar të kompetencës.

- *Trajnimi i bazuar në njohuritë dhe përvojë* siguron informacionin e nevojshëm për ekspertët dhe studentët e SAR-së për të kryer detyrat e tyre. Një metodë tjetër është trajnimi për mënyrën e analizimit të rasteve SAR të vendit tonë apo vendeve të tjera. Kjo analizë mund të përdoret për të rishikuar politikën, përditësuar procedurat standarde dhe për të përmirësuar trajnimet dhe proceset e tjera.

- *Trajnimi për ndërgjegjësimin* mbi kërkesat e shërbimit SAR kërkohet për ata persona të përfshirë rrallë në SAR, siç janë drejtuesit e nivelit të lartë, autoritetet buxhetore, operatorët e transportit të përgjithshëm dhe autoritetet kombëtare të transportit.

Theksi duhet të vendoset në rezultatet e trajnimit, jo në aktivitetet e trajnimit.

*Trajnimi në vendin e punës.* Personat që trajnohen mësojnë dhe në të njëjtën kohë kontribuojnë në qëllimet e organizatës. Kjo qasje ekonomike kërkon specialistë kompetentë, të cilët mund të mësojnë të tjerët, si dhe drejtues (trajnues) të trajnuar.

*Pyetje kontrolli (Checklists).* Specialistët, që trajnojnë, zhvillojnë listat kontrolluese të detyrave të punës, aftësive, detyrave dhe procedurave që duhet të mësohen përmes trajnimit në vendin e punës. Kjo siguron që të gjithë të trajnuarit të marrin të njëjtin informacion. Çështjet në listën e kontrollit mund të përgatiten në mënyra të ndryshme.

*Planifikimi i progresit.* Kjo teknikë i jep specialistëve të SAR-it një ide të qartë të synimit përfundimtar të trajnimit. Specialisti i njeh kërkesat për avancim dhe mjetet për ta arritur atë. Planifikimi i progresit është një qasje hap pas hapi, e cila kërkon që detyra të kryhet mirë në çdo nivel, para se të kalohet në nivelin e ardhshëm.

*Rotacioni i detyrave.* Kjo zgjeron njohuritë e specialistëve. Rotacioni në punë të ndryshme i lejon specialistit të kuptojë aspektet më të gjera të organizatës.

*Instruktimi.* Kjo është përgjegjësi e çdo specialisti në një pozitë drejtuese. Instrukuesit efektivë zhvillojnë pikat e forta dhe potencialin e vartësve dhe i ndihmojnë ata të kapërcejnë dobësitë e tyre. Instruktimi kursen kohë, para dhe gabime të kushtueshme nga vartësit.

*Biblioteka.* Një bibliotekë trajnimi është e dobishme për personelin për të rritur nivelin e tyre të njohurive. Bibliotekat mund të përfshijnë materiale të ndryshme, të tilla si: video, plane mësimi, libra referimi, revista dhe libra audio. Filmime mësimore mund të bëhen thjesht duke regjistruar një sesion trajnimi të mirë në klasë. Një video mësimore, prodhuar në mënyrë profesionale, mund të jetë edhe më efektive.

*Trajnime formale në klasë.* Shumë vende kryejnë kurse, seminare trajnimi, konferenca dhe të tjera programe për trajnimin e specialistëve të SAR-së. Për personat që do të shërbejnë si drejtues të SAR-së ose do të shërbejnë si administratorë detarë me detyrat e menaxhimit të SAR-së, Universiteti Botëror Detar i IMO-s zhvillon kurse mbi organizimin dhe operacionet e SAR-së. Materialet model për kursin janë në dispozicion nga IMO-ja. Universiteti në Malmö, Suedi, mund të kontaktohet për informacion mbi kurset. Nga IMO-ja dhe



ICAO-ja, gjithashtu, mund të kërkohej të dhëna në lidhje me mundësitë për trajnim formal SAR, në dispozicion për studentët e huaj në shtetet që ofrojnë këtë trajnim. Në disa raste, mbështetja financiare për studentët e huaj mund të jenë: IMO-ja, ICAO-ja ose burime të tjera ndërkombëtare dhe shtetërore.

*Trajno trajnuesin.* Kur një person duhet të udhëtojë jashtë vendit për të marrë formimin e SAR-it, mund të jetë më efektive nëse bëhen marrëveshje që personi të vëzhgojë përdorimin e procedurave në operacionet reale, duke u aftësuar për të mësuar të tjerët. Më pas, institucionet mund të përdorin maksimumin e njohurive të këtij personi, pasi të kthehet për të kryer trajnime të mirëplanifikuara dhe të organizuara brenda vendit ose institucionit. Një pjesë e strategjisë së trajnimit për SAR duhet të jetë për të trajnuar individët në mënyrë të tillë që ata të mund të ndihmojnë trajnimin e të tjerëve në vendet e tyre punës. Kjo ul nevojat për mbështetje nga qendrat e trajnimit brenda apo jashtë vendit dhe zvogëlon koston e shpenzimeve të trajnimit.

*Ngritja e një qendre trajnimi.* Një qendër profesionale e trajnimit brenda vendit ndihmon në ruajtjen e profesionalizmit dhe standardizimit. Dërgimi në distanca të gjata të studentëve për trajnime është i kushtueshëm dhe joefikas dhe kurset mund të përfshijnë tema të parëndësishme. Trajnimet formale nga vendet e tjera kanë kryesisht përfitime afatshkurtra dhe rrallë kanë një bazë të qëndrueshme e të besueshme. Trajnuesit vendas kuptojnë më mirë nevojat e vendit, mund të sigurojnë një program të vazhdueshëm dhe nuk kanë pengesën e gjuhës e cila mund të jetë një problem.

*Shtesa në kurrikulat mësimore.* Mënyra më ekonomike dhe efektive për të ofruar trajnime të specializuara SAR është shtesa për SAR në programin mësimor të një qendre ekzistuese trajnimi. Personeli trajnues mund të sigurohet bashkërisht nga organizatat që u nevojitet trajnim për personelin e tyre të SAR, duke siguruar ekspozim të mirë ndërinstitucional për instruktorët dhe studentët. Për SAR ajror, është veçanërisht e dobishme që të ketë ekspertizë të personelit trajnues për SAR detar sepse operacionet SAR mund të kryhen brenda të dy mjediseve.

Konferencat. Trajnimet e rregullta duhet të plotësohen për të përmirësuar profesionalizmin e

SAR. Përmes vizitave dhe konferencave reciproke ndërmjet njësive operuese, individët mësojnë nga përvojat e jetës reale të të tjerëve dhe marrin informacion rreth një teme të caktuar interesi.

## 2. USHTRIMET STËRVITORE

Ushtrimet testojnë dhe përmirësojnë planet operacionale, sigurojnë përvojë mësimore dhe përmirësojnë aftësitë koordinuese dhe bashkërenduese. Ushtrimet, të kryera sa më realiste, ndihmojnë për të demonstruar dhe vlerësuar efektivitetin e vërtetë të trajnimit, efikasitetin operacional dhe kompetencën e shërbimit SAR. Ushtrimet do të zbulojnë mangësitë që mund të ekzistojnë në planet e SAR-it dhe u mundësojnë atyre të përmirësohen. Është më e sigurt të zbulohen të meta nga ushtrimet stërvitore dhe jo në operacionet reale.

### Llojet e ushtrimeve stërvitore

Ushtrimet mund dhe duhet të zhvillohen në tri nivele.

Lloji më i thjeshtë i ushtrimit stërvitor, një *stërvitje komunikimi*, kërkon planifikimin më të vogël. Ai konsiston në përdorimin periodik e të gjitha mjeteve të komunikimit ndërmjet të gjithë përdoruesve të mundshëm për të siguruar aftësinë për komunikim për situata reale SAR.

Një *stërvitje koordinimi*, përfshin një përgjigje të simuluar ndaj një krize të bazuar në një seri skenarësh. Të gjitha nivelet e shërbimit SAR do të përfshihen por nuk vendosen në terren. Ky lloj ushtrimi kërkon planifikim të konsiderueshëm dhe zakonisht një deri në tri ditë për të ekzekutuar. Ky ushtrim mund të zhvillohet në qendrën e Simulimit, KDS, MM.

Lloji i tretë, një *ushtrim stërvitor i shkallës së plotë* ose një ushtrim në terren, ndryshon nga llojet e mëparshme në atë që pajisjet në përdorim të SAR veprojnë në terren. Kjo rrit mundësinë e testimit të shërbimit SAR dhe i afrohet situatës reale për shkak të kohës që vlerësohet në nisjen, lëvizjen dhe aktivitetet e SRU-ve.

### Konsiderata të tjera

Stërvitjet e përbashkëta midis shteteve fqinje ose palëve në marrëveshjet e SAR-it gjithashtu do të jenë të vlefshme. Është e nevojshme të caktohet personel përgjegjës për planëzimin dhe vlerësimin e stërvitjeve. Suksesi i një ushtrimi stërvitor matet me:

- sa probleme janë zbuluar;
- sa është mësuar;





- sa plane operacionale janë përmirësuar; dhe
- sa pak gabime përsëriten gjatë stërvitjes së radhës.

### Elementet e stërvitjes

Ushtrimet e suksesshme kërkojnë planëzim, ekzekutim dhe vlerësim. Ushtrimet stërvitore zhvillohen për të trajnuar personelin, për të vlerësuar planet dhe procedurat e përcaktuara dhe për të testuar koncepte të reja. Ushtrimet, gjithashtu, ofrojnë përvojë në menaxhimin e rreziqeve dhe sigurisë për operacionet e SAR-së.

*Planëzimi.* Planëzimi i zakonshëm i stërvitjes përfshin: zhvillimin e konceptit (qëllimet dhe objektivat e stërvitjes) të asaj që duhet ushtruar; përzgjedhjen e pjesëmarrësve (personeli, pajisjet dhe terreni); planëzimin hollësisht për mënyrën se si do të kryhet stërvitja; kryerjen e ushtrimit dhe vlerësimin për të përcaktuar mësimet e nxjerra e për të zhvilluar rekomandime për përmirësim. Është thelbësore që të kemi një kuptim të qartë se për cilat plane dhe procedura po kryhet stërvitja. Bazuar në to mund të zhvillohen skenarë që përfshijnë situata specifike në të cilat personeli do të reagojë dhe do të përgjigjet. Përgjigja ose mungesa e saj, sipas standardeve dhe udhëzimeve të dhëna apo nevoja për përshtatje të procedurave të veprimit, vlerësohet.

*Ekzekutimi.* Ata që planëzojnë stërvitjen nuk duhet të jenë të njëjtët që stërviten. Kjo shmang mbulimin e dobësive të njohura dhe zbulon se çfarë do të ndodhte në një situatë reale SAR.

*Skenarët duhet të jenë sa më realistë.* Vendimi, se sa pranë realitetit she sa e madhe do të jetë stërvitja, do të varet nga shtrirja e shërbimit SAR, detyrimet që ka SAR-ja dhe mbështetja financiare. Stërvitjet duhet të përfshijnë sa më shumë njësi dhe mjedise të mundshme trajnimi, duke siguruar kështu mjete dhe mbështetje të kënaqshme për zbatimin e programeve të trajnimit. Në rastet kur kapacitetet mbështetëse private do të përfshihen në stërvitje SAR, periudha e stërvitjes duhet të planëzohet në mënyrë që të minimizohet ndërprerja e aktiviteteve normale.

Stërvitjet duhet të kryhen në intervale të rregullta dhe të rregulluara, në mënyrë që të përfshihet i gjithë personeli SAR duke i kombinuar ato me aktivitetin normal të punës.

Trajnimi i kryer më vete, pa përfshirë gjithë sistemin apo pajisjet SAR në përdorim nuk do të jetë aq efektiv sa stërvitjet e kombinuara të të gjitha

kapaciteteve por ato mund të sigurojnë që shërbimi i SAR të funksionojë në rast urgjence.

Të gjitha kapacitetet, duke përfshirë kapacitetet ajrore dhe detare, duhet të ushtrohen sa të jetë e mundur. Komunikimi midis SRU-ve është një jetik për bashkërendimin e operacioneve.

Kurdoherë që është e mundur, personeli i të gjitha institucioneve që kanë detyrime të drejtpërdrejta ose mbështetëse për SAR-në duhet të ftohet të marrë pjesë në ushtrimet stërvitore ose t'i vëzhgojë ato. Ata duhet të pajisen me dokumente, botime apo literatura të tjera që përshkruajnë politikën dhe procedurat SAR të përdorura nga shërbimi SAR, duke i njohur me rolet e detyrimet e organizatave pjesëmarrëse në operacionet e SAR-së.

Në mënyrë periodike ushtrimet stërvitore SAR duhet të planëzohen dhe kryhen së bashku me RCC-të e vendeve fqinje, për të zhvilluar dhe mbajtur një bashkëpunim efikas dhe bashkërendim ndërmjet shërbimeve SAR. Këto ushtrime nuk duhet gjithmonë të jenë në shkallë të gjerë, por të paktën ato njësi SAR që kanë gjasa të veprojnë së bashku, duhet të angazhohen periodikisht në ushtrime bashkërenduese. Kjo mund të realizohet edhe duke shkëmbyer informacion mbi metodat e trajnimit (p.sh.: programet, literatura dhe filmimet e operacioneve), si dhe vizitat reciproke midis RCC.

Kërkesat e sigurisë mund të imponojnë kufizime të rëndësishme në kryerjen e ushtrimeve SAR. Autoritetet koordinuese të SAR-së dhe planëzuesit e stërvitjeve duhet të sigurohen që rregulla dhe kufizime specifike të sigurisë të nxirren për përdorim gjatë planëzimit dhe kryerjes së ushtrimeve stërvitore SAR.

*Vlerësimi.* Procesi i vlerësimit është vendimtar. Të dhënat e vlerësimit duhet të vijnë nga një ekip i ekspertëve të vlerësimit që vëzhgojnë stërvitjen dhe nga njerëzit që marrin pjesë fizikisht në skenarët e ushtrimit stërvitor. Ata që vëzhgojnë dhe vlerësojnë stërvitjen duhet të kenë njohuri dhe përvojë në fushat që po vlerësojnë dhe të kuptojnë qartë se çfarë po vlerësohet. Vlerësuesit duhet të dinë situatat që paraqiten dhe pastaj të regjistrojnë përgjigjen e pjesëmarrësit në objektivat e ushtrimit. Hapi përfundimtar është identifikimi i dobësive dhe zhvillimi i rekomandimeve për përmirësim. Ushtrimet e mëvonshme duhet të reflektojnë ndryshimet e rekomanduara, si dhe shqetësimet të tjera.



### Raportet

Një raport i detajuar i ushtrimit stërvitor, duke adresuar çdo element, është i nevojshëm për të shpërndarë informacion të vlefshëm dhe për të ruajtur një skedar historik për studimet e rasteve të mëvonshme, analizat dhe përmirësimet e sistemit. Rekomandohet një sistem i regjistrimit dhe depozitimit të raporteve për ripërdorim të mëvonshëm.

### PJESA E TRETË

#### 1. PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E SHËRBIMIT TË KËRKIM-SHPËTIMIT

Treguesit e mëposhtëm duhet të përdoren për të vlerësuar nivelin e shërbimeve të kërkim-shpëtimit (SAR) të një shteti, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga kërkesat e aneksit 12

(ose dispozita të tjera përkatëse ICAO/IMO), sipas procedurave të kërkim-shpëtimit (SARPs):

A. Nuk zbatohen.

B. Kanë filluar të zbatohen.

C. Pëmbushin në disa fusha kërkesat e aneksit 12 (ose dispozita të tjera përkatëse ICAO/IMO).

D. Pëmbushin në shumicën e fushave.

E. Pëmbushin plotësisht kërkesat e aneksit 12 (ose dispozita të tjera përkatëse ICAO/IMO).

Për këto çështje përgjigjet duhet të jenë thjeshtë Po/Jo.

Përgjigja “**nuk vlerësohet**” nuk nënkupton domosdoshmërisht ekzistencën e një mangësie dhe përgjigja “**e paaplikueshme**” nuk nënkupton mbulimin e mangësive. Për qartësim, mund të përfshihen komente e nevojshme.



Kodi	Referenca	Çështje për vlerësim	Zbatimi	Komente
<b>1. ORGANIZIMI</b>				
<b>1.1. Akte legjislative që drejtojnë veprimtaritë kombëtare të shërbimeve SAR</b>				
Org.act.1	Annex 12 Chap. 2 Doc 8733 Doc 9731 Vol I Chap 1 and 5	A ka akte legjislative që rregullojnë aktivitetet e SAR-it?	<input type="checkbox"/> A, <input type="checkbox"/> B, <input type="checkbox"/> C, <input type="checkbox"/> D, <input type="checkbox"/> E <input type="checkbox"/> Jo e zbatueshme <input type="checkbox"/> Nuk vlerësohet	
Org.act.2	Annex 12 Chap 2 Doc 8733 Doc 9731 Vol I Chap 1 and 5	Nëse ka akte legjislative që rregullojnë veprimtaritë e SAR-it, a janë ato të përditësuara?	<input type="checkbox"/> A, <input type="checkbox"/> B, <input type="checkbox"/> C, <input type="checkbox"/> D, <input type="checkbox"/> E <input type="checkbox"/> Jo e zbatueshme <input type="checkbox"/> Nuk vlerësohet	
Org.act.3	Annex 12 Chap 2 Doc 8733 Doc 9731 Vol I Chap 1 and 5	A e organizojnë aktet e mësipërme shërbimin e SAR-it në mënyrë të tillë që detyrat dhe përgjegjësitë të shpërndahen në mënyrë të përpiktë dhe efikase?	<input type="checkbox"/> A, <input type="checkbox"/> B, <input type="checkbox"/> C, <input type="checkbox"/> D, <input type="checkbox"/> E <input type="checkbox"/> Jo e zbatueshme <input type="checkbox"/> Nuk vlerësohet	
<b>1.2. Plani Kombëtar i SAR-it - Njësitë Administrative të SAR-it</b>				
